2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga erërat e forta në banesën e shtetasit **Z. Zyber Harun Shuli,** e cila është në **35 312** (tridhjetë e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **70 624 x 50% = 35 312** lekë.
3. Shuma në fjalë prej **35 312** (tridhjetë e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, ti kalojë Agjensisë së Shërbimeve Publike Bashki nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018, për riparimin e dëmit në banesën e **Z. Zyber Harun Shuli.**
4. A.Sh.P. brënda 15 ditësh nga konfirmimi i V.K.Bashkiak duhet të riparojë dëmin e krijuar.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, A.Sh.P. Bashki dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

1351

30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.8312 **Prot.** **Elbasan më,** 30.9 **.2019**

V E N D I M

Nr.137 **Datë:**23 **.09.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Ndriçim Mustafa Mazhi, banor në Lagjjen "Brigada 17 Sulmuse", Rr. "Xhaferr Hakani" të Lagjjes Nr. 2 si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.09.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z.Ndriçim Mustafa Mazhi,** banor në Lagjjen "Brigada 17 Sulmuse", Rr. "Xhaferr Hakani" të Lagjjes Nr. 2 si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Ndriçim Mustafa Mazhi** është në **420 183** (katërqind e njëzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **380 367 x 50% = 190 183 lekë + 230 000 lekë = 420 183 lekë.**
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetë mijë) lekë, për familjen e **Z. Ndriçim Mustafa Mazhi.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës

së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Ndriçim Mustafa Mazhi** prej 3**9**0183 (treqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

1352
30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5211/1 **Prot.** **Elbasan më,** 30.9 **.2019**

VENDIM

Nr. 138 **Datë:** 23 **.09.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Kasem Hazis Preçi, banor në Fshatin Shinavlash, Njësia Administrative Tregan si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.09.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Kasem Hazis Preçi,** banor në Fshatin Shinavlash, Njësia Administrative Tregan si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Kasem Hazis Preçi,** e cila është në **825 426** (tetëqind e njëzet e pasë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **917 853 x 50% = 458 926 lekë + 366 500 lekë = 825 426 lekë.**
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetë mijë) lekë, për familjen e **Z. Kasem Hazis Preçi.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Kasem Hazis Preçi** prej **775 426** (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë, si diferencë e vlerës

financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ju faleminderit!

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

1353
30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

Nr.8304/prot **Elbasan , më 30.09.2019**

VENDIM

Nr.139 date 23 09.2019

PER MIRATIMIN E "RREGULLORE PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NE FSHAT BASHKIA ELBASAN"

Në mbështetje të ligjit Nr .139/2015 dt.17.12.2015" Për vetëqeverisjen vendore" , të ligjit Nr.44/2015 "Kodi i proçedurave administrative në Republikën e Shqipërisë ",ligjit Nr.115/2014 "Per ndarjen administrativo-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise".dhe me propozim te administrates e Kryetarit te Bashkise Këshilli Bashkiak,

Vendosi:

1. Miratimin e "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare në fshat bashkia Elbasan" bashkangjitur këtij vendimi .
2. V.K.B.Nr.106.dt 26.09.2016. " Për miratimin e rregullores brëndshme për funksionet dhe detyrat e kryetarëve dhe kryesive të fshatrave,që përshihen në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan shfuqizohet.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkise, kryesia dhe kryetari fshatit, Njësia Administrative dhe Drejtoria Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari

Klajd Gripshi

Kryetari

Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot. **Elbasan, më ___.___.2019**

RREGULLORE

"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE TË FSHATIT, BASHKIA ELBASAN"

(Kryetar / Kryesi Fshati)

Kreu I

Kjo rregullore është hartuar në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54/k, 70, 7I); të ligiit nr.44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" si dhe të ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), duke patur si qëllim rregullimin e veprimtarisë së strukturave komunitare (nëndarjeve) në fshat, për ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave.

Neni 1
Nënndarja e njësisë administrative (fshati)

a. Fshati është pjesë e njësisë administrative përkatëse të bashkisë. Numri i strukturave komunitare (nënndarje administrative) paraqitet në listën nr.1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, si pjesë përbërëse e saj.
b. Shtrirja territoriale, kufijtë dhe emri i fshatit përcaktohet me ligj.
c. Fshati i ri krijohet me propozim të Këshillit Bashkiak dhe miratohet me ligj.
d. Kufijtë ndarës administrativo - territoriale të fshatit dhe harta e përditësuar miratohen nga Këshilli Bashkiak, sipas standarteve të përcaktuara gjeohapsinore.
e. Fshati përbëhet nga lagjet dhe numri i tyre, për çdo fshat, miratohet nga Këshilli Bashkiak. Numri i lagjeve paraqitet në listën nr.2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Lagja ka vijueshmëri gjeografike dhe territoriale.
   - Fshatrat deri në 500 banorë përbëhen nga 3 lagje;
   - Fshatrat nga 501 - 1500 banorë përbëhen nga 5 lagje;
   - Fshatrat me mbi 1500 banorë përbëhen nga 7 lagje;

Neni 2
Struktura komunitare në fshat

Fshati drejtohet nga kryesia e fshatit dhe kryetari i fshatit.

Kryesia është organ këshillimor i kryetarit të fshatit.

Neni 3

Organizimi dhe proçesi i zgiedhjes së strukturave komunitare

Administratorët e njësive administrative marrin të gjitha masat për organizimin e proçedurave për zgjedhjen e strukturave komunitare (Kryetar dhe Kryesi Fshati). Këshilli Bashkiak ndjek proçedurat për zgjedhjen e strukturave komunitare.
Njësia administrative, në bashkëpunim me kryetarin e fshatit, informon të gjithë shtetasit të cilët kanë të drejtë vote për organizimin e proçedurës së zgjedhjeve të strukturës administrative, me anë të njoftimeve publike, i cili përmban datën, orën si dhe vendin e organizimit të mbledhjes.

Neni 4

Zgjedhja e kryesisë së fshatit

Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhjen e fshatit, me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me të drejtë vote, në mbledhje. Në rastet kur fshati përbëhet nga disa lagje, secila nga lagjet zgjedh një anëtar kryesie. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga Këshilli Bashkiak. Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e kryesisë së fshatit, paraqitet dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatëve.

a. Zgjidhet një komision votimi, si rregull me 3 (tre) anëtarë.
b. Komisioni i votimit drejton të gjitha proçedurat, plotëson fletëvotimet dhe përcakton rregullat e votimit.
c. Votimi bëhet i fshehtë dhe pas votimit hartohet proçesverbali nga komisioni dhe shpallet përbërja e kryesisë së fshatit.

Zgjedhja e kryesisë së fshatit bëhet një herë në katër vjet pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë duhet të merret parasysh kriteri arsimor, reputacioni dhe aftësia drejtuese.

Neni 5

Kryetari i fshatit

Kryetari i fshatit zgjidhet nga radhët e kryesisë së fshatit me votim të fshehtë me jo më pak se 2 (dy) kandidatura. Zgjedhjet e kryetarit të fshatit bëhen një herë në 4 (katër) vjet, pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të ketij afati, deri në zgiedhjen e kryesisë së fshatit, Kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit.
Proçesi i zgjedhjes së kryetarit të fshatit organizohet nga njësia administrative, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e kryetarit të fshatit fillimisht paraqitet dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatit të propozuar.
Komisioni i votimit i zgjedhur për këtë qëllim, përbëhet nga 3 anëtar nga komuniteti.
Komisioni i votimit drejton të gjitha proçedurat deri në shpalljen e kryetarit të fshatit, plotëson fletëvotimet dhe përcakton rregullat e votimit.
Votimi bëhet i fshehtë. Pas votimit hartohet proçesverbali nga komisioni, i cili firmoset edhe nga anëtarët e kryesisë, i deleguari i Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesi i njësisë administrative, e më pas shpallet kryetari i zgjedhur.

Neni 6

Përfundimi i mandatit të anëtarit dhe kryetarit të kryesisë së fshatit

Mandati i anëtarit dhe kryetarit të kryesisë së fshatit përfundon përpara afatit në rastet kur:

a. jep dorëheqjen;
b. nuk është më banor i përhershëm i fshatit;
c. humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
d. shkarkohet nga funksioni, për moszbatim të detyrave të ngarkuara nga ligji, nga Kryetari i Bashkisë, nga Këshilli Bashkiak apo nga kjo rregullore, ose për shkelje ligjore;

Anëtari dhe kryetari i kryesisë së fshatit në rastet e dorëheqjes, e depoziton kërkesën pranë njësisë administrative.

a. Për ndjekjen e proçedurave të nevojshme, administratori i njësisë administrative, njofton brenda 3 (tre) ditëve Kryetarin e Bashkisë për aktin e dorëheqjes;
b. Me përfundimin para kohe të mandatit të Kryetarit të kryesisë së fshatit, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen një anëtar i kryesisë së fshatit propozuar nga kjo e fundit;
c. Nëse rastin kur qytetarët e konsiderojnë që kryetari ose anëtarët e kryesisë së fshatit nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore, ata mund të shkarkohen me shumicën e votave të banorëve të fshatit;
d. Kjo proçedurë do të zbatohet në rastin e paraqitjes së një mocioni mosbesimi, i cili duhet të përmbajë nënshkrimet e më shumë se gjysmës së numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur kryesia e Fshatit;
e. Kryetari i fshatit në çdo rast nëse largohet nga detyra, duhet të bëjë paraprakisht të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e vulës dhe dokumentacionit tek administratori i njësisë administrative;
f. Në rastet e krijimit të vendit vakant për kryetarin e fshatit ose për anëtar të kryesisë zhvillohen proçedurat e zgjedhjes për vendin vakant, sipas përcaktimit të bërë në nenet 4 dhe 5. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.

Kreu II

Neni 7

Roli dhe përgjegjësitë

Mbështetur në aktet ligjore / nënligjore si dhe në rregulloren e funksionimit të strukturave të nënndarjeve të bashkisë, Kryetari dhe antarët e kryesisë së fshatit kanë përgjegjësi për të vepruar dhe për të punuar në bazë të parimeve të profesionalizmit, paanësisë politike, transparencës, dhe korrektësisë në zbatimin e detyrave.

a. Kryetari i fshatit nënshkruan të gjitha aktet e kryesisë së fshatit, si dhe proçesverbalet e mbledhjeve të kryesisë.
b. Kryetari i fshatit siguron zbatimin e vendimeve të kryesisë së fshatit, Këshillit të Bashkisë dhe të akteve administrative të Kryetarit të Bashkisë.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e Kryetarit dhe të Kryesisë së Fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet qeverisëse të Bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, për përdorimin e burimeve të

përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.

2. Bazuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, kryetari ose kryesia e fshatit mund të kryejnë edhe detyrat e meposhtme:
   a) Kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm, në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ujërave të zeza, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara si dhe të rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;
   b) Kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve, ndriçimit, lulishteve dhe sheshet publike të fshatit;
   c) Kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të fshatit;
   d) Kujdeset për ruajtjen e pyjeve, të kullotave dhe të burimeve natyrore;
   e) Kujdeset për ruajtjen e ambjentit, grumbullimin dhe largimin e mbeturinave;
   f) Kujdeset për mbarëvajtjen e ujitjes së tokave në fshat;
   g) Kujdeset për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në fshat;
3. Kryetari i Fshatit krijon një grup pune të përhershëm, me përfaqësues të kryesisë dhe komunitetit të fshatit, për rastet e emergjencave civile, dhe e organizon grupin për ti ardhur në ndihmë komunitetit. Ky grup trajnohet, në mënyrë periodike, nga Drejtoria e Emergjencave Civile në bashki.
4. Merr pjesë në grupet e punës për verifikime të ndryshme në fshat dhe grumbullim të dhënash me punonjësit e njësisë administrative dhe të bashkisë.
5. Bën njoftime të ndryshme për banorët e fshatit, si:
   - njofton banorët për mobilizime në raste të emergjencave civile si fatkeqësish natyrore, për ndihmë e kontribute dhe evakuime sipas rastit;
   - shpërndan njoftimet për detyrimet tatimore të familjeve në fshat;
   - njofton banorët për mbledhje të fshatit, etj.;
6. Kryetari i fshatit jep mendime për prioritetet e investimeve dhe shërbimeve në fshat.
7. Kujdeset për mbarëvajtjen e arsimit dhe shëndetësisë në fshat.
8. Kujdeset për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike në fshat, të monumenteve të kulturës, të veprave të artit, lapidarëve, etj.
9. Kujdeset për organizimin e veprimtarive të ndryshme sportive, kulturore, artistike, etj., në fshat.
10. Afishon, për publikim, pranë qendrave të votimit në fshat, listat e zgjedhjeve.
11. Bashkëpunon me shoqata të ndryshme, që operojnë në territorin e fshatit.
12. Bashkëpunon në hartimin e listave dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, në raste fatkeqësish;
13. Përcjell informacione të ndryshme në bashki e njësinë administrative, për probleme të fshatit, jo më pak se 1 herë në 3 muaj dhe sa herë kërkohet nga to.
14. Merr pjesë, për aq sa lejon ligji, në zgjidhjen e konflikteve mes banorëve për probleme pronësie, civile, familjare, etj.
15. Ka të drejtë dhe përgjigjet për kontrollin e territorit të fshatit.
16. Njofton në kohë bashkinë për rastet e emergjencave civile në fshat si përmbytje, zjarre, tërmete, rrëshqitje toke, etj. dhe ndërhyn e mobilizon komunitetin.
17. Kujdeset për respektimin e harmonisë fetare në fshat.
18. Vendimet, urdhërat apo urdhëresat e organeve të zgjedhura të bashkisë, janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.
19. Merr pjesë në mbledhjet e këshillit të prindërve në shkollë dhe njihet me problemet e arsimit në fshat.
20. Ndihmon dhe bashkëpunon me specialistët e njësisë administrative dhe të bashkisë për

regjistrime të ndryshme statistikore në fshat, bazuar në akte ligjore.

21. Harton, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, listën e nevojave vjetore për dru zjarri të familjeve.
22. Ndjek zbatimin e orareve të lokaleve në fshat, sipas urdhëresës së miratuar nga Këshilli Bashkiak.
23. Kujdeset për problemet e rendit dhe qetësisë publike në fshat, duke bashkëpunuar me inspektorët e policisë së rendit dhe ata të policisë bashkiake.
24. Kontrollon dhe informon organet e bashkisë dhe policisë për kultivimin e bimëve narkotike në territorin e fshatit dhe merr masa për parandalimin e tyre;
25. Detyrat e tjera të parashikuara në rregulloret dhe urdhëresat e Këshillit Bashkiak.

Neni 9

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1. Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij, pa të drejtë vote.
2. Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin e tij.

Neni 10

Aktet Administrative

Aktet administrative (vendime, urdhëra, shkresa) janë ato akte që nxirren në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të nënndarjes.

a. Çdo akt i miratuar nga kryetari, kryesia e fshatit duhet të përmbajë, arsyetimin për nxjerrjen e aktit, shpjegimin e kuptimit të aktit, bazueshmërinë ligjore të tij, faturën financiare nëse ka, personin, institucionin / organtzatën të cilës i drejtohet, personat apo strukturat e ngarkuara për zbatimin e aktit, momentin e hyrjes në fuqi të aktit etj.;
b. Urdhëresat, vendimet dhe urdhërat e organeve të zgjedhura të bashkisë, janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

Neni 11

Përdorimi i vulës

Kryetari i fshatit pajiset me vulë zyrtare nga bashkia, e cila e identifikon në aktet administrative të nxjerra prei tij. Ai mban përgjegjësi për përdorimin e vulës, sipas akteve ligjore e nënligjore.
Vula zyrtare përdoret vetëm për dokumente që kanë datë, numër protokolli dhe janë të firmosura nga kryetari i fshatit.
Në rastet e humbjes së vulës, njoftohet menjëherë Bashkia Elbasan dhe Komisariati i Policisë, si dhe merren të gjitha masat për zëvendësimin e saj, sipas proçedurës ligjore.

Neni 12

Llojet e dokumentacionit që lëshon dhe firmos kryetari i fshatit

1. Kryetari i fshatit ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin. Shërbimet janë si më poshtë:

a) vërtetim që është banor i fshatit;
b) vërtetim që banori thirret me dy emra në fshat;
c) vërtetim që banori ka mbjellë kultura bujqësore, dru frutore, etj.;
d) vërtetim që banori përdor tokën bujqësore;
e) vërtetim për sjellje e qëndrim shoqëror në fshat për banorët dhe familjet e fshatit;
f) vërtetim që banori ka prodhuar dru zjarri për nevojat e tij, nga krasitja dhe prerja e kulturave drufrutore;

2. Kryetari përpilon dhe firmos edhe këto proçesverbale, në bashkëpunim me grupet e punës së bashkisë:
   a) proçesverbal konstatimi për dëmtime në fshat nga tërmeti, përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet e fatkeqësi të tjera natyrore etj.;
   b) proçesverbal të mbjelljeve të reja të kulturave drufrutore për efekte të përjashtimit të taksës së tokës;
   c) proçesverbal të saktësimit të sipërfaqeve të ndërtesës dhe të truallit kur mungon regjistrimi nga A.SH.K.;
   d) proçesverbale të tjera konstatimesh;
3. Proçesverbalet e mbledhjeve të kryesisë së fshatit kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato nënshkruhen nga mbajtësi i tij dhe kryetari i fshatit.

Neni 13
Dokumentacioni i kryetarit të fshatit

Kryetari i fshatit krijon dhe mban dokumentacionin për të gjithë aktivitetin e tij dhe të kryesisë, si më poshtë:

1. Proçesverbalet e kufijve dhe të shtrirjes së fshatit dhe hartën e fshatit;
2. Dokumentacionin e zgjedhjes së kryetarit dhe kryesisë së fshatit;
3. Libër protokolli për mbledhjet e kryesisë së fshatit;
4. Vendimet e marra dhe propozimet e rekomanduara nga kryesia e fshatit dhe kryetari i fshatit;
5. Vendimet e Kryetarit të Bashkisë, të Këshillit Bashkiak në lidhje me fshatin e tij;
6. Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare të fshatit, Bashkia Elbasan";
7. Urdhërat dhe urdhëresat e Këshillit Bashkiak në lidhje me fshatin;
8. Proçesverbalin e vulës zyrtare, përdorimin dhe ruajtjen e saj sipas akteve ligjore;
9. Korespondencë me njësinë administrative, bashkinë dhe institucione të tjera shtetërore;
10. Listën e lajmërimit dhe të skuadrës së MKZ së fshatit;
11. Mban të dhëna statistikore për fshatin si:
    a) nr. i popullsisë, i familjeve dhe treguesve të tjerë demografike;
    b) sipërfaqja e përgjithshme e fshatit dhe e ndarë në tokë pyll, kullotë, livadhe, toka të abandonuara, sipërfaqje ujore, burime natyrore dhe tokë arë; nga kjo sipërfaqje sa është e ndarë dhe sa e pandarë;
    c) kulturat e mbjella në fshat, sipërfaqja dhe prodhimi;
    d) nr. i krerëve të bagëtive për të gjitha llojet dhe prodhimi;
    e) nr. i të vetëpunësuarve në fermën private, në shtet dhe aktivitet privat;
    f) nr. i automjeteve sipas llojeve dhe mjeteve bujqësore;
    g) nr. i familjeve me ndihmë ekonomike, në nevojë dhe nr. i personave me aftësi të kufizuar;
    h) nr. i bizneseve në fshat etj.;

Kryetari i fshatit në fund të çdo viti, në bazë të regjistrit të korespondencës, bën dorëzimin e dokumentacionit shkresor origjinal (të krijuar / të ardhur) në njësinë administrative.

Neni 14
Shpërblimi i kryetarit të fshatit

Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimit të Këshillit Bashkiak.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Elbasan.

KRYETARI

Hektor Ciftja

Konceptoi:

Drejtoria e Koord. të Nj.Adm. dhe Lagjeve: *D. Dafina* *E. Mezini* *Sh. Bullari*

Pranoi:

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Miratoi:

Drejtori i Përgjth. i ShO: *B. Çabiri*

SHTOJCA NR.1

Numri i Strukturave Komunitare (nëndarjeve administrative)

Nr.	*Njësi të qeverisjes vendore*			*Qendra e Bashkisë*	*Njësitë Adm. përbërëse*	*Fshatrat në përbërje të tyre*
	Qarku	*Qendra e Qarkut*	*Bashkia*			
1	Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	Qyteti Elbasan	**Labinot - Fushë**	Labinot - Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtëm, Xibrakë, Mengel;
2					**Labinot - Mal**	Labinot - Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë. Lugaxhi, Qafë Qerret, Shmil, Dritas;
3					**Gjinar**	Gjinar, Lleshan, Valësh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat;
4					**Shushicë**	Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush - Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Valë, Vreshtaj;
5					**Gjergjan**	Gjergjan, Bujaras, Gjonme, Kështjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë;
6					**Funar**	Branesh, Bixëlle, Preç e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Preç e Poshtme, Stafaj;
7					**Shirgjan**	Shirgjan, Bathës, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës;
8					**Tregan**	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Çikallesh, Gurisht, Kaçivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbater, Trepsenisht, Tudan;
9					**Gracen**	Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj;
10					**Bradashesh**	Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulën, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhill, Shijon, Reçan, Gurabardhë;
11					**Zavalinë**	Zavalinë, Seltë, Kamiçan, Joronishtë, Nezhan, Burrishtë;
12					**Papër**	Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhutë, Papër - Sallak, Vidhas - Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj;

Lista Nr. 2 e fshatrave me lagje dhe numrat e anëtareve të kryesisë për çdo fshat në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan

Nr.	I. Njësia Adm.	Nr.i fshatrave	Emrat e fshatrave	Nr. Lagjeve	Nr. Antareve
1	Bradashesh	1	Bradashesh	7	7
2		2	Balëz-Lart	5	5
3		3	Balëz-Poshtë	5	5
4		4	Kusarth	5	5
5		5	Kozan	3	3
6		6	Karakullak	3	3
7		7	Letan	3	3
8		8	Rrilë	3	3
9		9	Shtemaj	3	3
10		10	Ulën	3	3
11		11	Katund i Ri	7	7
12		12	Fikas	3	3
13		13	Petresh	3	3
14		14	Shëmhill	3	3
15		15	Shijon	3	3
16		16	Reçan	3	3
17		17	Gurabardh	3	3
18	II. Njësia Adm. Shushicë	1	Shushicë	7	7
19		2	Shelcan	7	7
20		3	Mlizë	5	5
21		4	Hajdaran	5	5
22		5	Fush-Bull	5	5
23		6	Vasjan	3	3
24		7	Polis i Vogël	5	5
25		8	Polis Vale	3	3
26		9	Vreshtaj	7	7
27	III. Njësia Adm. Papër	1	Balldre	5	5
28		2	Bizhutë	3	3
29		3	Broshkë	5	5
30		4	Jatesh	3	3
31		5	Lugaj	5	5
32		6	Murras	5	5
33		7	Pajun	3	3
34		8	Papër	5	5
35		9	Papër-Sallak	3	3
36		10	Ullishtaj	5	5
37		11	Valas	5	5
38		12	Vidhas	5	5
39		13	Vidhas-Hasgjel	3	3
40	IV. Njësia Adm. Shirgjan	1	Shirgjan	7	7
41		2	Bathes	5	5
42		3	Bujqës	7	7
43		4	Jagodinë	5	5

44		5	Kuqan	7	7
45		6	Kryezjart	5	5
46		7	Mjekës	5	5
47	V. Njësia Adm. Labinot-Fushë	1	Labinot-Fushë	5	5
48		2	Griqan i Sipërm	3	3
49		3	Griqan i Poshtëm	5	5
50		4	Godolesh	5	5
51		5	Xibrakë	5	5
52		6	Mengel	5	5
53	VI. Njësia Adm. Labinot-Mal	1	Labinot-Mal	7	7
54		2	Gur i Zi	5	5
55		3	Sericë	5	5
56		4	Lamollë	3	3
57		5	Benë	7	7
58		6	Lugaxhi	5	5
59		7	Qafë	5	5
60		8	Qerret	5	5
61		9	Shmil	3	3
62		10	Dritas	3	3
63	VII. Njësia Adm. Gjergjan	1	Gjergjan	5	5
64		2	Bujaras	5	5
65		3	Gjonmë	5	5
66		4	Keshtjellë	5	5
67		5	Kodër Bujaras	5	5
68		6	Muriqan	5	5
69		7	Thanë	5	5
70	VIII. Njësia Adm. Gjinar	1	Gjinar	5	5
71		2	Lleshan	5	5
72		3	Valesh	3	3
73		4	Pashtresh	5	5
74		5	Derstilë	3	3
75		6	Lukan	3	3
76		7	Sterstan	3	3
77		8	Xibresh	3	3
78		9	Maskarth	3	3
79		10	Kaferr	3	3
80		11	Pobrat	5	5
81	IX. Njësia Adm. Tregan	1	Tregan	5	5
82		2	Blerimas	3	3
83		3	Bizhdan	3	3
84		4	Cikallesh	5	5
85		5	Gurisht	3	3
86		6	Kacivel	5	5
87		7	Kyçyk	5	5
88		8	Muçan	7	7
89		9	Shinavlash	7	7
90		10	Shilbater	5	5
91		11	Trepsenisht	5	5

92		12	Tudan	5	5
93	X. Njësia Adm.	1	Branesh	3	3
94	Funar	2	Bixëlle	3	3
95		3	Prec e Sipërme	3	3
96		4	Cerujë	3	3
97		5	Korrë	3	3
98		6	Mollagjesh	5	5
99		7	Krrabë e Vogël	3	3
100		8	Prec e Poshtme	3	3
101		9	Stafaj	3	3
102	XI. Njësia Adm.	1	Gracen	3	3
103	Gracen	2	Plangaricë	3	3
104		3	Tërbaç	4	4
105		4	Bodin	3	3
106		5	Shingjin	3	3
107		6	Gjorm	3	3
108		7	Pajengë	3	3
109		8	Mamel	5	5
110		9	Dopaj	3	3
111	XII. Njësia Adm.	1	Zavalinë	3	3
112	Zavalinë	2	Seltë	3	3
113		3	Kamiçan	3	3
114		4	Jeronishtë	3	3
115		5	Nezhan	3	3
116		6	Burishtë	3	3
*	Shuma Totale	116	Fshatra	495	495

1354

30.9.2019

7/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3299/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 30.09.**2019**

VENDIM

Nr. 140 **datë** 23/09/**2019**

"Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në Bashkinë Elbasan *"Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan"*, mbështetur në nenin 70 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrative - territoriale të qeverisjes vendore në R.Sh." (i ndryshuar), si dhe në VKB përkatëse "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të strukturave komunitare të Bashkisë Elbasan";

VENDOSI:

1) Të miratojë numrin e anëtarëve të kryesive të fshatrave, sipas tabelës bashkëlidhur.
2) Të miratojë kalendarin e mbledhjeve të kryesive të fshatrave, sipas tabelës bashkëlidhur.
3) Të miratojë listën e të deleguarve të Këshillit Bashkiak, për çdo fshat, që do të marrin pjesë në komisionet e votimit për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive të fshatrave, sipas tabelës bashkëlidhur.
4) Të organizojë zgjedhjet, për këto struktura komunitare, gjatë periudhës 01 - 31.10.2019.
5) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në bashki.
6) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Çiftja

Konceptoi:
Drejtoria e Koord. të Nj.Adm. dhe Lagjeve: *D. Dafina* *E. Mezini* *Sh. Bullari*
Pranoi:
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Miratoi:
Drejtori i Përgjth. i ShO: *B. Çabiri*
Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

Lista e fshatrave, numrat e lagjeve, numrat e anëtareve të kryesisë për çdo fshat në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan, të deleguarit e K. Bashkiak Elbasan dhe grafiku i mbledhjeve.

Nr.	I. Njësia Adm.	Nr.i fsh	Emrat e fshatrave	Nr. Lgj.	Nr. Ant.	I/e deleguari/a K. Bashkiak	Grafiku mbledh.
1	Bradashesh	1	Bradashesh	7	7		1/10/2019
2		2	Balëz-Lart	5	5		1/10/2019
3		3	Balëz-Poshtë	5	5		1/10/2019
4		4	Kusarth	5	5		2/10/2019
5		5	Kozan	3	3		2/10/2019
6		6	Karakullak	3	3		2/10/2019
7		7	Letan	3	3		3/10/2019
8		8	Rrile	3	3		3/10/2019
9		9	Shtemaj	3	3		3/10/2019
10		10	Ulen	3	3		3/10/2019
11		11	Katund i Ri	7	7		4/10/2019
12		12	Fikas	3	3		7/10/2019
13		13	Patresh	3	3		7/10/2019
14		14	Shenmehill	3	3		7/10/2019
15		15	Shijon	3	3		8/10/2019
16		16	Reçan	3	3		8/10/2019
17		17	Gurabardhë	3	3		8/10/2019
18	II. Njësia Adm. Shushicë	1	Shushicë	7	7		1/10/2019
19		2	Shelcan	7	7		2/10/2019
20		3	Mlizë	5	5		2/10/2019
21		4	Hajdaran	5	5		2/10/2019
22		5	Fush-Bull	5	5		3/10/2019
23		6	Vasjan	3	3		3/10/2019
24		7	Polis i Vogël	5	5		5/10/2019
25		8	Polis Vale	3	3		5/10/2019
26		9	Vreshtaj	7	7		2/10/2019
27	III. Njësia Adm. Papër	1	Balldreu	5	5		4/10/2019
28		2	Bizhuta	3	3		5/10/2019
29		3	Broshka	5	5		3/10/2019
30		4	Jateshi	3	3		4/10/2019
31		5	Lugaj	5	5		7/10/2019
32		6	Murrasi	5	5		3/10/2019
33		7	Pajuni	3	3		5/10/2019
34		8	Papëri	5	5		5/10/2019
35		9	Papër-Sallaku	3	3		5/10/2019
36		10	Ullishta	5	5		3/5/2019
37		11	Valasi	5	5		7/10/2019
38		12	Vidhasi	5	5		10/10/2019
39		13	Vidhas-Hasgjeli	3	3		9/10/2019
40	IV. Njësia Adm. Shirgjan	1	Shirgjan	7	7		5/10/2019
41		2	Bathes	5	5		5/10/2019
42		3	Bujqes	7	7		7/10/2019
43		4	Jagodin	5	5		7/10/2019

44		5	Kuqan	7	7		9/10/2019
45		6	Kryezjart	5	5		9/10/2019
46		7	Mjekes	5	5		10/10/2019
47	V. Njësia Adm.	1	Labinot-Fushë	5	5		11/10/2019
48	Labinot-Fushë	2	Griqan i Sipërm	3	3		16/10/2019
49		3	Griqan i Poshtëm	5	5		11/10/2019
50		4	Godolesh	5	5		18/10/2019
51		5	Xibrakë	5	5		17/10/2019
52		6	Mengël	5	5		17/10/2019
53	VI. Njësia Adm.	1	Labinot-Mal	7	7		5/10/2019
54	Labinot-Mal	2	Gur i Zi	5	5		6/10/2019
55		3	Sericë	5	5		20/10/2019
56		4	Lamolle	3	3		20/10/2019
57		5	Benë	7	7		9/10/2019
58		6	Lugaxhi	5	5		9/10/2019
59		7	Qafë	5	5		10/10/2019
60		8	Qerret	5	5		10/10/2019
61		9	Shmil	3	3		11/10/2019
62		10	Dritas	3	3		11/10/2019
63	VII. Njësia Adm.	1	Gjergjan	5	5		7/10/2019
64	Gjergjan	2	Bujaras	5	5		8/10/2019
65		3	Gjonme	5	5		9/10/2019
66		4	Keshtjellë	5	5		10/10/2019
67		5	Kodër Bujaras	5	5		9/10/2019
68		6	Muriqan	5	5		11/10/2019
69		7	Thanë	5	5		7/10/2019
70	VIII. Njësia Adm.	1	Gjinar	5	5		9/10/2019
71	Gjinar	2	Lleshan	5	5		9/10/2019
72		3	Valesh	3	3		9/10/2019
73		4	Pashtresh	5	5		10/10/2019
74		5	Derstile	3	3		11/10/2019
75		6	Lukan	3	3		11/10/2019
76		7	Sterstan	3	3		11/10/2019
77		8	Xibresh	3	3		12/10/2019
78		9	Maskarth	3	3		12/10/2019
79		10	Kaferr	3	3		16/10/2019
80		11	Pobrat	5	5		17/10/2019
81	IX. Njësia Adm.	1	Tregan	5	5		2/10/2019
82	Tregan	2	Blerimas	3	3		2/10/2019
83		3	Bizhdan	3	3		3/10/2019
84		4	Çikallesh	5	5		3/10/2019
85		5	Gurisht	3	3		3/10/2019
86		6	Kaçivel	5	5		4/10/2019
87		7	Kyçyk	5	5		8/10/2019
88		8	Muçan	7	7		8/10/2019
89		9	Shinavlash	7	7		9/10/2019
90		10	Shilbater	5	5		9/10/2019
91		11	Trepsenisht	5	5		10/10/2019

92		12	Tudan	5	5		10/10/2019
93	X. Njësia Adm.	1	Branesh	3	3		9/10/2019
94	Funar	2	Bixellë	3	3		9/10/2019
95		3	Preçë e Sipërme	3	3		10/10/2019
96		4	Cerujë	3	3		13/10/2019
97		5	Korrë	3	3		13/10/2019
98		6	Mollagjesh	5	5		17/10/2019
99		7	Krrabë e Vogël	3	3		10/10/2019
100		8	Preçë e Poshtme	3	3		10/10/2019
101		9	Stafaj	3	3		10/10/2019
102	XI. Njësia Adm.	1	Gracen	3	3		9/10/2019
103	Gracen	2	Plangarica	3	3		10/10/2019
104		3	Tërbaç	4	4		9/10/2019
105		4	Bodin	3	3		10/10/2019
106		5	Shingjin	3	3		13/10/2019
107		6	Gjormë	3	3		13/10/2019
108		7	Pajengë	3	3		9/10/2019
109		8	Mamel	5	5		18/10/2019
110		9	Dopaj	3	3		13/102019
111	XII. Njësia Adm.	1	Zavalinë	3	3		17/10/2019
112	Zavalinë	2	Seltë	3	3		17/10/2019
113		3	Kamiçan	3	3		17/10/2019
114		4	Jeronishtë	3	3		18/10/2019
115		5	Nezhan	3	3		18/10/2019
116		6	Burishtë	3	3		18/10/2019
*	Shuma Totale	116	Fshatra	495	495		

Miratoi:
Drejtori D.K.Nj.A.L
Shefqet Bullari

9288/2
07.10.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr.1354/1 **Prot.** **Elbasan më** 03/10 **.2019**

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.140 dt 23.09.2019 " Për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan " konfirmojmë në parim 5 pikat e aktit tuaj përvec pikës 3 për të cilën kërkojmë të dhëna plotësuese si më poshtë:

- Listën e detajuar të të deleguarve nga Këshilli Bashkiak për cdo fshat që do të marin pjesë ne komisionet e votimit për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Kryesive..

Deri në dërgimin e të dhënave të lartëpërmendura,pika 3 e aktit tuaj mbetet e pakonfirmuar.

PREFEKTI
NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Eva BICA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10429 **Prot.** **Elbasan, më:** 30.10.2019

VENDIM

Nr. 166 **datë** 31.10.2019

"Për plotësimin e pikës 3 dhe ndryshimin e pikës 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan""

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në Bashkinë Elbasan *"Për plotësimin e pikës 3 dhe ndryshimin e pikës 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan""*, mbështetur në nenin 70 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrative - territoriale të qeverisjes vendore në R.Sh." (i ndryshuar), në VKB përkatëse "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të strukturave komunitare të Bashkisë Elbasan", në VKB nr.140 datë 23.9.2019 si dhe në shkresën nr.1354/1 prot. datë 03.10.2019 të Prefektit të Qarkut Elbasan;

VENDOSI:

1) Të plotësojë pikën 3 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan", si më poshtë:

   "Të miratojë listën e të deleguarve të Këshillit Bashkiak, për çdo fshat, që do të marrin pjesë në komisionet e votimit për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive të fshatrave, sipas tabelës bashkëlidhur".

2) Të ndryshojë pikën 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan", si më poshtë:

   "Të organizojë zgjedhjet, për këto struktura komunitare, gjatë periudhës 01 - 30.11.2019".

3) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në bashki.

4) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Çiftja

Konceptoi:
Drejtoria e Koord. të Nj.Adm. dhe Lagjeve: *D. Dafina* *E. Mezini* *Sh. Bullari*
Pranoi:
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Miratoi:
Drejtori i Përgjth. i ShO: *B. Çabiri*
Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

Lista e fshatrave, numrat e lagjeve, numrat e anëtareve të kryesisë për çdo fshat në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan, të deleguarit e K. Bashkiak Elbasan dhe grafiku i mbledhjeve.

Nr.	I. Njësia A	Nr.i fsh	Emrat e fshatrave	Nr. Lgj.	Nr. Ant.	I/e deleguari/a K. Bashkiak	Grafiku mbledh.
1	Bradashesh	1	Bradashesh	7	7	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
2		2	Balëz-Lart	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
3		3	Balëz-Poshtë	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
4		4	Kusarth	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
5		5	Kozan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
6		6	Karakullak	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
7		7	Letan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
8		8	Rrilë	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
9		9	Shtemaj	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
10		10	Ulën	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
11		11	Katund i Ri	7	7	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
12		12	Fikas	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
13		13	Petresh	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
14		14	Shëmhill	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
15		15	Shijon	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
16		16	Reçan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
17		17	Gurabardh	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
18	II. Njësia A Shushicë	1	Shushicë	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
19		2	Shelcan	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
20		3	Mlizë	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
21		4	Hajdaran	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
22		5	Fush-Bull	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
23		6	Vasjan	3	3	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
24		7	Polis i Vogël	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019
25		8	Polis Valë	3	3	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019
26		9	Vreshtaj	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019

27	III. Njësia A	1	Balldre	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	5/11/2019
28	Papër	2	Bizhutë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	5/11/2019
29		3	Broshkë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
30		4	Jatesh	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
31		5	Lugaj	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
32		6	Murras	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
33		7	Pajun	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
34		8	Papër	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
35		9	Papër-Sallak	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
36		10	Ullishtaj	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
37		11	Valas	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
38		12	Vidhas	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
39		13	Vidhas-Hasgjel	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
40	IV. Njësia A	1	Shirgjan	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	6/11/2019
41	Shirgjan	2	Bathes	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	6/11/2019
42		3	Bujqës	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	7/11/2019
43		4	Jagodinë	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	7/11/2019
44		5	Kuqan	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
45		6	Kryezjart	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
46		7	Mjekës	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
47	V. Njësia A	1	Labinot-Fushë	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	11/11/2019
48	Labinot-Fushë	2	Griqan i Sipërm	3	3	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	11/11/2019
49		3	Griqan i Poshtëm	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	12/11/2019
50		4	Godolesh	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	12/11/2019
51		5	Xibrakë	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	13/11/2019
52		6	Mengel	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	13/11/2019
53	VI. Njësia A	1	Labinot-Mal	7	7	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	4/11/2019
54	Labinot-Mal	2	Gur i Zi	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	5/11/2019
55		3	Sericë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	7/11/2019
56		4	Lamollë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	7/11/2019

57		5	Benë	7	7	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	8/11/2019
58		6	Lugaxhi	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	8/11/2019
59		7	Qafë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
60		8	Qerret	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
61		9	Shmil	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
62		10	Dritas	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	12/11/2019
63	VII. Njësia A	1	Gjergjan	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	8/11/2019
64	Gjergjan	2	Bujaras	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	8/11/2019
65		3	Gjonmë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	11/11/2019
66		4	Keshtjellë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	12/11/2019
67		5	Kodër Bujaras	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	13/11/2019
68		6	Muriqan	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	14/11/2019
69		7	Thanë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	14/11/2019
70	VIII. Njësia A	1	Gjinar	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	11/11/2019
71	Gjinar	2	Lleshan	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	11/11/2019
72		3	Valesh	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	12/11/2019
73		4	Pashtresh	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	12/11/2019
74		5	Derstilë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
75		6	Lukan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
76		7	Sterstan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
77		8	Xibresh	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	14/11/2019
78		9	Maskarth	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	14/11/2019
79		10	Kaferr	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	15/11/2019
80		11	Pobrat	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	15/11/2019
81	IX. Njësia A	1	Tregan	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	11/11/2019
82	Tregan	2	Blerimas	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	11/11/2019
83		3	Bizhdan	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	15/11/2019
84		4	Cikallesh	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	15/11/2019
85		5	Gurisht	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019
86		6	Kacivel	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019

87		7	Kyçyk	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019
88		8	Muçan	7	7	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
89		9	Shinavlash	7	7	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
90		10	Shilbater	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
91		11	Trepsenisht	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	20/11/2019
92		12	Tudan	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	20/11/2019
93	X. Njësia A	1	Branesh	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	11/11/2019
94	Funar	2	Bixëlle	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	11/11/2019
95		3	Prec e Sipërme	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	12/11/2019
96		4	Cerujë	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	13/11/2019
97		5	Korrë	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	13/11/2019
98		6	Mollagjesh	5	5	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	14/11/2019
99		7	Krrabë e Vogël	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	14/11/2019
100		8	Prec e Poshtme	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	15/11/2019
101		9	Stafaj	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	15/11/2019
102	XI. Njësia A	1	Gracen	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	12/11/2019
103	Gracen	2	Plangaricë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	12/11/2019
104		3	Tërbaç	4	4	Bukurosh Stafa, Ali Korra	13/11/2019
105		4	Bodin	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	18/11/2019
106		5	Shingjin	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
107		6	Gjorm	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
108		7	Pajengë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
109		8	Mamel	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra	21/11/2019
110		9	Dopaj	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	22/11/2019
111	XII. Njësia A	1	Zavalinë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	18/11/2019
112	Zavalinë	2	Seltë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	19/11/2019
113		3	Kamiçan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	20/11/2019
114		4	Jeronishtë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	21/11/2019
115		5	Nezhan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	22/11/2019
116		6	Burishtë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	22/11/2019

*	Shuma Totale	116	Fshatra	495	495		

Miratoi:
Drejtori D.K.Nj.A.L
Shefqet Bullari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

13595
30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.9306/ prot. Elbasan më 30/09/2019

VENDIM

Nr.141 datë 23/09/2019

"Mbi miratimin e një ndryshimi në VKB-në nr.148 datë 05.12.2018"mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit te pagave për vitin 2019" si dhe VKB-në Nr. 162 Datë 24.12.2018'Mbi miratimine buxhetit te Bashkisë Elbasan për vitin 2019'

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2019, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore "Mbi miratimin e një ndryshimi në VKB-në nr.148 datë 05.12.2018"mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit te pagave për vitin 2019", bazuar neni 54 pika "dh" të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji 152/2013"Për nëpunësin civil" i ndryshuar, nenit 113 të ligjit 44/2015"Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 5 te ligjit nr.10405 datë 24.03.2001 "Për kompetencat dhe përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve", VKM nr.177 datë 8.03.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165 date 2.03.2016 të Këshillit të Ministrave "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore" VKB nr. 148 datë 05.12.2018

VENDOSI :

1.Te miratojë ndryshimin në zërat e Buxhetit sipas (titull /kapitull/artikull) sa mëposhtëshënuar:

Pakësohet **0 4520 -05- 600 – 300,000 leke**
0 4520 -05- 601 – 170,000 leke

Shtohet **0 4570 -05- 600 – 300,000 leke**
0 4570 -05- 601 – 170,000 leke

2.Të miratojë tabelën e pagave të Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan për vitin 2019.
3. Lidhja nr.3 e VKB-së nr.148 datë 05.12.2018 shfuqizohet.
4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore dhe Agjensia e Shërbimeve Publike.
4.Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Tetor 2019 dhe do të mbulohen nga fondi i pagave të parashikuara në buxhetin e vitit 2019 për Agjencinë e Shërbimeve Publike.
5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Financës, Administrata e Bashkisë dhe institucionet vartëse të saj.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, te nenit 55 të ligji nr. 139/2015, *Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor të Institucionit te Prefektit të Qarkut Elbasan

SEKRETARI

Klajdi GRIPSHI

KRYETAR

Hektor ÇIFTJA

Konceptoi: Pergj. L.Tutulaku
Dr. i ASHP: N. Sinani
DABNJ E. Shabanaj
Dr Finances A.Merkja
Dr Buxhetit E.Beluli
D.Juridike O.Deliallisi
D. Pergj B.Cabiri
D.Pergj Q.Tusha
Zv/Kryetari:I.Sina

Niveli i pagave per Agjensinë e Shërbimeve Publike **Lidhja Nr.3**

Nr	Emertimi i pozicionit	Kategoria	Paga Grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi+shtese pozicioni***				
1	**Drejtor i Pergjithshem**	**II A**	1	2%	98,000
2	**Drejtor Drejtorie**	**II B**	1	2%	77,000
3	Pergjegjes sektori	III A/1	1	2%	44,000
4	Sekretare	IV/A	1/2/3	2%	42,000
5	Specialist	IV/A	1/2/3	2%	42,000
6	Specialist (Magazinier)	IV/B	1/2/3	2%	35,000
II	***Punonjes te sistemit me klasa***	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga Baze**
1	Pergjegjes sektori	XI		1%	39,000
2	Magazinier	IV		1%	35,000
3	Specialisti mesem (Teknik+mekanik)	VI		1%	38,000
4	Shofer	VIII		1%	39,000
5	Pastruese zyrash	I		1%	33,000
6	Pastruese	I		1%	30, 000
7	Punetor	II		1%	30, 000
8	Punetor varrezash	II		1%	32,000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.3 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.3 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze e klases se I eshte 30 000 leke

1356
30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9300 Prot.

Datë 30 .09. 2019

VENDIM

NR. 142 DATE 23 . 09. 2019

MBI

"Miratim në parim i fondit limit për blerje karburant dhe shërbimin e internetit për vitin 2020"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23.09.2019, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Elbasan mbi **"Miratim në parim i fondit limit për blerje karburant dhe shërbimin e internetit për vitin 2020"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI

1. Miratimin në parim të fondeve limit për blerje karburanti (naftë + benzinë) për vitin 2019, për institucionet si më poshtë :

		Fondi limit	periudha
- Qendra Ekonomike e Arsimit,	blerje karburant	2,000 mijë lekë	viti 2020
- Mirëmbajtje Terrene Sportive,	" "	500 " "	viti 2020
- Agjensia e Shërbimeve Publike	" "	28,050 " "	viti 2020
- Qendra Sociale "Balashe"	" "	600 " "	viti 2020
- SHMZSH (Zjarrfikësja)	" "	1,620 " "	viti 2020
	Gjithsej :	32,770 mijë lekë	

2. Miratimin në parim të fondit limit 8,000,000 lekë, për shërbimin e internetit, për Bashkinë, njësitë administrative dhe njësitë vartëse, për vitin 2020.

3. Këto fonde do të përfshihen në buxhetin e vitit 2020 duke ruajtur destinacionin, me financim nga buxheti i Bashkisë (grant i pakushtezuar, grant specifik, të ardhura).

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Prokurimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETAR
Hektor Ciftja

Dr. Buxhetit : M.Beluli
Dr.Prokurimeve : A.Muhametaj
Dr. Pergjithsh. : Q.Tusha
Dr. Juridike : O.Deliallisi

1382
25.09.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9305/11 **Prot.** **Elbasan, më** 25 **.9.2019**

VENDIM

Nr. 143 **datë** 23 **.9.2019**

"Për miratimin e vazhdimit të proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik të sipërfaqes prej 0.0402 ha, sipas raportit të studimit tekniko - ekonomik, pjesë e VKB nr.14 datë 25.01.2018 të Bashkisë Elbasan, në ekonominë pyjore Gjinar - Zavalinë, për ndërtimin e hidrocentralit të Kamiçanit, nga subjekti "IDI 2005""

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.9.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit, i mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) Ligjin nr.9385 datë 04.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar);
d) VKM nr.1353 datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" (i ndryshuar);
e) VKM nr.433 datë 08.6.2016 "Për transferimin, në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave / bashkive";
f) Udhëzimin e MM nr.1 datë 09.6.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik";
g) VKB nr.14 datë 25.01.2018;
h) Shkresën nr.1101/2 prot. datë 19.02.2019 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik të sipërfaqes prej 0.0402 ha, në ngastrat 151/a dhe 154/a, në ekonominë pyjore "Gjinar - Zavalinë", të identifikuara sipas raportit tekniko - ekonomik bashkëlidhur këtij vendimi, dhënë nga Bashkia Elbasan me VKB nr.14 datë 25.01.2018, në funksion të ndërtimit të hidrocentralit të "Kamiçanit", nga shoqëria "IDI 2005" dhe për të cilën është dhënë më parë miratimi paraprak nr.6259/2 datë 15.3.2017, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Drejtoria e Shërbimive Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Elbasan, të

dërgojë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik, sipas shtojcës nr.1.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:

Specialisti i DShPBVM: P. Bardhi

P/Seksionit të Menaxhimit: J. Bodurri

Pranoi:

Drejtori i DShPBVM: Sh. Çullhaj

Miratoi:

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Konfirmoi:

Zv/Kryetari: I. Sina

1323

25-09-2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8307/2 **Prot.** **Elbasan, më** 25 **.9.2019**

VENDIM

Nr. 144 **datë** 23 **.9.2019**

"Për miratimin e vazhdimit të proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik të sipërfaqes prej 0.0726 ha, sipas raportit të studimit tekniko - ekonomik, pjesë e VKB nr.13 datë 25.01.2018 të Bashkisë Elbasan, në ekonominë pyjore Gjinar - Zavalinë, për ndërtimin e hidrocentralit të Arçovës, nga subjekti "IDI 2005""

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.9.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit, i mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) Ligjin nr.9385 datë 04.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar);
d) VKM nr.1353 datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" (i ndryshuar);
e) VKM nr.433 datë 08.6.2016 "Për transferimin, në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave / bashkive";
f) Udhëzimin e MM nr.1 datë 09.6.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik";
g) VKB nr.13 datë 25.01.2018;
h) Shkresën nr.1102/2 prot. datë 19.02.2019 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik të sipërfaqes prej 0.0726 ha, në nënngastrat 107 dhe 146/b, në ekonominë pyjore "Gjinar - Zavalinë", të identifikuara sipas raportit tekniko - ekonomik bashkëlidhur këtij vendimi, dhënë nga Bashkia Elbasan me VKB nr.13 datë 25.01.2018, në funksion të ndërtimit të hidrocentralit të "Arçovës", nga shoqëria "IDI 2005" dhe për të cilën është dhënë më parë miratimi paraprak nr.6129/5 datë 15.3.2017, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Drejtoria e Shërbimive Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Elbasan, të

dërgojë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e proçedurës për heqjen nga fondi pyjor / kullosor publik, sipas shtojcës nr.1.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Hektor Çiftja

Konceptoi:

Specialisti i DShPBVM: *P. Bardhi*

P/Seksionit të Menaxhimit: *J. Bodurri*

Pranoi:

Drejtori i DShPBVM: *Sh. Çullhaj*

Miratoi:

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Konfirmoi:

Zv/Kryetari: *I. Sina*

1352
30.9.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9307/1 **Prot.** **Elbasan, më** 30.9 **.2019**

VENDIM

Nr. 145 **datë** 23.09 **.2019**

"Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar dhe teknik midis Bashkisë Elbasan, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe World Vision Albania, për realizimin e projektit "Shërbimi Lëvizës Komunitar për Fëmijët në Nevojë për Mbrojtje dhe Aftësi të Kufizuar", i aplikueshëm në territorin e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.___.2019, pasi shqyrtoi *"Marrëveshjen e bashkëpunimit financiar dhe teknik midis Bashkisë Elbasan, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe World Vision Albania, për realizimin e projektit "Shërbimi Lëvizës Komunitar për Fëmijët në Nevojë për Mbrojtje dhe Aftësi të Kufizuar", i aplikueshëm në territorin e Bashkisë Elbasan"*, i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) Ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në R.Sh.";
c) Ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës";
d) Ligjin nr.9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.Sh." (i ndryshuar);
e) Ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar);
f) Udhëzimin e MF nr.2 datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit" (i ndryshuar);
g) VKB nr.162 datë 24.12.2018 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2019";

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit financiar dhe teknik midis Bashkisë Elbasan, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe World Vision Albania, për realizimin e projektit "Shërbimi Lëvizës Komunitar për Fëmijët në Nevojë për Mbrojtje dhe Aftësi të Kufizuar", i aplikueshëm në territorin e Bashkisë Elbasan", sipas lidhjes bashkëlidhur.

2. Të miratojë fondin 241 mijë lekë, kontribut i Bashkisë Elbasan për "Blerje furgon transporti për Qendrën Komunitare për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuar", bashkëfinancim me World Vision Albania, pjesë e këtij projekti.

3. Të miratojë transferimin e fondeve, në buxhetin e bashkisë të vitit 2019, për financimin e pikës

2 të këtij vendimi, si mëposhtë:

- **Pakësohet:** programi 04520, artikulli 231, njësia shpenzuese Bashkia, objekti: "Asfaltim i rrugës "8 Marsi", lagja "Visarion Xhuvani", **shuma 241 mijë lekë;**
- **Shtohet:** programi 10140, artikulli 231, njësia shpenzuese Bashkia, **shuma 241 mijë lekë,** bashkëfinancim për objektin: "Blerje furgon transporti për Qendrën Komunitare për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara". (Vlera e plotë e objektit = 1.700 mijë lekë);

4. Të miratojë shtesën e 3 (tre) punonjësve, financuar nga fondi social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për periudhën 12 (dymbëdhjetë) muaj, sipas tabelës "Buxheti i detajuar", pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Drejtoria e ShKSK: *Sh. Lika*

Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*

Pranoi:

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Miratoi:

Drejtori i Përgjith. PAABF: *Q. Tusha*

Konfirmoi:

Zv/Kryetari: *E. Saraçi*

Zv/Kryetari: *I. Sina*

Buxheti i detajuar:
Emërtimi i Projektit: Tungjatjeta Jete, Sherbim Levizes per Femije me Aftesi e Kufizuar
Kohëzgjatja e projektit: 12 muaj
Bashkia: Elbasan

No.	Cost Items	Njësia (p.sh. pjesë, orë pune / ditë, muaj i personit, muaj i viti, përmbledhje)	Sasia	Kosto për njësi / Lek	Kosto Total /lek	Kontributi i kërkuar nga Fondi Social	Kontributi i vet i Bashkisë	Kontributi i World Vision
1.	***Burimet njerëzore***							
1.1	**Pagat e Punonjësve të Njësisë Lëvizëse**							
1.1.1	Menaxhere e Projektit /	12	2	103,700.0	1,244,400.0	622,200.0	0.0	622,200.0
1.1.2	Punonjes sociale me kohe te plote (1 Bashkia punonjesi i NjMF-se)	12	1	51,960.0	623,520.0	0.0	623,520.0	0.0
1.1.3	Psikolog me kohe te plote	12	1	70,020.0	840,240.0	840,240.0	0.0	0.0
1.1.4	Fizioterapist me kohe te plote	12	1	70,020.0	840,240.0	840,240.0	0.0	0.0
1.1.5	Shoferi me kohe te plote	12	1	52,000.0	624,000.0	0.0	624,000.0	0.0
1.2	**Bashkëfinancimi në asete**							
1.2.1	Furgon Transporti per Qendren Komunitare per Femije dhe te rinj me Aftesi te Kufizuar	1	1	1,700,000.0	1,700,000.0	1,459,160.0	240,840.0	0.0
	Sub total				**5,872,400.0**	**3,761,840.0**	**1,488,360.0**	**622,200.0**
3.	***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)***							
3.1	Trajnime profesionale per Ekipin Levizes	2	5	10,000.0	100,000.0	0.0	0.0	100,000.0
3.2	Vizita te femijeve nga specialiste	1	1	70,000.0	70,000.0	0.0	0.0	70,000.0
	Sub total				**170,000.0**	**0.0**	**0.0**	**170,000.0**
4.	***Vizibiliteti, botimet, përkthimi etj.***							
4.1	Takime, konferenca	1	1	150,000.0	150,000.0	0.0	0.0	150,000.0
4.2	Broshura Vizibilitetit	1	300	200.0	60,000.0	0.0	0.0	60,000.0
	Sub total				**210,000.0**	**0.0**	**0.0**	**210,000.0**
I.	[illegible]							
II.	[illegible]							
	Sub total				**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**
	[illegible]							

FONDI SOCIAL

PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

I. Anekset

ANEKSI A: FORMULARI I APLIKIMIT PËR FONDIN SOCIAL BUXHETOR

Emri i aplikuesit:	Bashkia Elbasan
Adresa zyrtare postare:	Bashkia Elbasan.Rruga "Qemal Stafa"
E-mail zyrtar :	bashkiaelbasan@elbasani.gov.al
Faqja e internetit e parashtruesit:	www.elbasani.gov.al
Personi kontaktues për këtë projekt:	Shefki Lika
Numri i telefonit dhe adresa e emailit të personit të kontaktit:	0692258759 shefki.lika@elbasani.gov.al ; likashefki@yahoo.com

I. Plani Social Vendor i miratuar nga Këshilli Bashkiak (bashkëlidhur)

2.PERSHKRIMI I PROPOZIMIT

1. Titulli: Sherbim Levizes Komunitar per Femijet ne Nevoje per Mbrojtje dhe Aftesi te Kufizuar ne Zonen e Elbasanit

2. Vendndodhja: 12 Njësitë Administrative (Labinot Fushë, Labinot Mal,Bradashesh, Shushicë, Papër, Shirgjan, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Funar, Tregan dhe Zavalinë), Bashkia Elbasan

3. Kostoja e propozimit dhe shuma e kërkuar nga fondet buxhetore për Fondin Social, për shërbimet sociale të bazuara në komunitet

Kostoja totale e Projektit	Shuma e kërkuar për Fondin Social	% e fondit social të kërkuar
6.252.400.0 LEK	3.761.840.0 LEK	60 %

4. Përmbledhje

Adresimi i çdo rasti të fëmijeve ne nevoje per mbrojtje si dhe ofrimi i shërbimeve mbrojtese dhe rehabilituese per femijet me aftesi te kufizuar jane ende nje sfide per bashkite, specifikisht kur rastet e ketyre femijeve ndodhen ne zonat rurale apo Njesite Administrative.Ngritja e

sherbimeve me baze komunitare eshte nje detyre per bashkite e cila parashtrohet ne nje sere dokumentash si: Strategjinë Kombëtare per Mrojtjen Sociale 2015-2020,ne ligjin 121/2016 per Sherbimet Shoqerore,ligji 18/2017 per te drejtat dhe mbrojtjen e femijeve, si dhe në parimet bazë të konventave botërore ku nder të tjerat theksohet

"Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre"

"E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve

Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet

Pikerisht bazuar ne keto parime dhe legjislacionin shqiptar te lartpermendur bashkia Elbasan ka hartuar Planini e Mbrojtjes Sociale.Plani i Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Elbasan është një dokument i bazuar në një qasje gjithpërfshirëse i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve per individet ne nevoje ku nje vend te posacem ze target grupi" femije ne nevoje per mbrojtje" dhe "femijet me aftesi te kufizuar". Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë për të garantuar një vlerësim sa më afër te nevojave reale të ketyre target grupeve dhe mundësive për te adresuar këto nevoja. Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë edhe ndryshime ne shtrirjen gjeografike te Bashkise Elbasan duke sjelle dhe nje zgjerim te konsiderueshem te zones qe duhet mbuluar me sherbime per femije dhe ndryshim në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore jo vetem ne shtrirje por edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal. Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 24 përcaktohet se "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj. Këto funksione dhe përgjegjësi të reja nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendorë .Ne kete kontekst planifikimi është një komponent shumë i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të programeve dhe strategjive dhe Plani Social tenton të ofrojë një panramë sa më të plotë se derinë çfarë mase, shërbimet që aktualisht parashikohen në shportën e shërbimeve sociale ofrohen ose mbulohen financiarisht aktualisht dhe në të ardhmen nga Pushteti Vendor.

Ne Planin Social te Mbrojtjes nder te tjera parashikohet krijimi i Shërbimeve komunitare për të gjitha kategoritë në nevojë. Këto shërbime përfshijnë shërbime multidisiplinare të specializuara, për shembull këshillim psikologjik, ligjor, shërbime rehabilitimi, prindërimi etj si dhe ngritja e Njësisë së Operatorëve Social për Asistencën Shtëpiake e cila do të funksionojë edhe per personat me aftësi të kufizuara. Kjo Njësi do të ofrojë Shërbime individuale në familje (asistencë shtepiake, përkujdesje vetjake, këshillim psikologjik, social dhe ligjor), për femije, të moshuar dhe PAK në nevojë, viktima të dhunës etj. Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar në Bashkinë Elbasan ka bërë dhe bën përpjekje e maksimale për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet lokale

apo dhe qëndrore, por hendeku i plotësimit të këtyre nevojave është akoma në dukje. Ne nje situate kur ende **"Njësitë për Vlerësimi dhe Referimin e Rasteve"** të përbërë nga sektori i pagesave cash (ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj) dhe sektori i përkujdesit dhe përfshirjes sociale (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve) nuk jane stabilizuar del e nevojshme gjetja e alternativave te tjera per ofrimin e sherbimeve ne zonat ku ato mungojne.Pikerisht Zbatimi i modelit pilot të ofrimit të shërbimeve në familje permes" Sherbimit Levizes" te specializuar per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftesi te Kufizuar eshte nje alternative qe synon te ofroje sherbimet sa me prane femijeve, familjeve,komunitetit.Pikerisht rastet e femijeve ne nevoje per mbrojtje te paidentifikuar dhe te femijeve me AK qe kane nevoje per sherbime te specializuara do te gjejne mbeshtetje permes skuadres levizese te perbere nga profesioniste si punonjes social,psikolog,logopedist,fizioterapist.

Implementimi i projektit Sherbim Levizes per Femijet ne nevoje per mbrojtje dhe Aftesi te Kufizuar ne Bashkine e Elbasanit do te adresoje ceshtje te dala ne planin social mbi Identifikimin e rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje,mbeshtetjen e tyre,ofrimin e sherbimeve per femijet me aftesi te kufizuar te cilat mungojne ne zonat rurale apo njesite administrative,si dhe siguron mjetet monetare per kthimin e objektivave te planit social ne aksione konkrete.

Ju lutemi plotësoni tabelën më poshte:

Qëllimi i propozimit dhe lidhja me planin social vendor	Zbatimin e modelit pilot të ofrimit të shërbimeve në familje: Ofrimi i Sherbimi Levizes te specializuar per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftesi te Kufizuar etj. Objektivi 1.5: Të rritet bashkëpunimi me OJF-të që veprojnë në Bashkinë Elbasan 1.5.3.2 Mbështje e organizatave për t'u lidhur me komunitetin dhe për të dhënë kontributin e tyre Objektivi 2.1: Rritja e aksesit ndaj shërbimeve sociale dhe shëndetësore si dhe lobimi për plotësimin e nevojave bazë të personave me aftësi të kufizuar për një jetë dinjitoze 2.1.3 Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese për personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre në komunitet dhe në skemat e punësimit. 2.1.3.1 Ngritje e sherbimeve të integruara për PAK sipas kategorive Objektivi 3.3 Nxitja dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe integrimi i tyre në shoqëri. UDHËZIM Nr. 597, datë 22.12.2017 PËR MIRATIMIN E

	STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE, ASISTENCË SHTËPIAKE, PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA
Kohëzgjatja e Propozimit	12 muaj
Partner (ët), nëse ka	World Vision Albania, Zyra Elbasan
Grupi (et)	Femijet ne nevoje per mbrojtje,femijet me Aftesi te Kufizuar dhe Familjet e tyre
Përfituesit	150 femije ne nevoje per mbrojtje te identifikuar 85Femije me Aftesi te Kufizuara Ne zonat e thella te Elbasanit 160 prinder te informuar mbi mbrojtjen e femijeve dhe aftesine e kufizuar 12 punonjes sociale te njesive administrative rrisin kapacitetet e tyre mbi mbrojtjen e femijeve dhe aftesine e kufizuar 48 profesioniste te agjensive te tjera rrisin njohurite dhe kordinojne me skuadren levizese
Rezultatet kryesore të pritura	150 femije ne nevoje per mbrojtje jane identifikuar ,referuar dhe mbeshtetur me sherbimet e nevojshme 85 Femije me Aftesi te Kufizuara Ne zonat e thella te Elbasanit përfitojnë rregullisht nga shërbimet mbështetëse kognitive, psiko-sociale dhe terapeutike duke iu dhënë atyre një shans për të realizuar potencialin e tyre të plotë. 160 prinder te informuar mbi mbrojtjen e femijeve dhe aftesine e kufizuar 12 punonjes sociale te njesive administrative rrisin kapacitetet e tyre mbi mbrojtjen e femijeve dhe aftesine e kufizuar 48 profesioniste rrisin njohurite dhe kordinojne me skuadren levizese - Krijimi i modelit te sherbimit levizes per persona në nevojë dhe femije me aftesi te kufizuara - Njësia Levizese eshte funksionale dhe ofron shërbime në mjediset e shtëpisë për fëmijët me aftësi të kufizuara. -Fuqizimi i Familjeve te femijeve me Aftesi te Kufizuar

Aktivitetet kryesore (pikat kyce)	- Njësia Levizese eshte e formuar në nivel komunitar për të kontribuar në përmirësimin e jetës për fëmijët ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftësi të kufizuara. Njësia Levizese ka kapacitete për të identifikuar dhevleresuar rastet e femijeve ne nevoje per mbrojtje Njësia Levizese ofron sherbime emergjente per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftesi te kufizuar(kontroll mjekesor, ushqim,shoqerim ne institucionin me te afert etj) - Njësia Levizese ka kapacitete për të ofruar shërbim cilësor. - Njësia Mobile ofron terapi psikosociale, logopedi dhe fizioterapi për fëmijët me aftësi të kufizuara - Njësia levizese/ specialistët mbështesin anëtarët e familjes / kujdestarët lidhur me mbrojtjen e femijeve dhe për të kryer aktivitete që mund të bëjnë në shtëpi për të përmirësuar rezultatet e zhvillimit të fëmijëve me aftesi te kufizuar. -Tryeza te rrumbullakta dhe konferenca / shkembime pervoje ne kuader te transparences dhe vizibilitietit te sherbimit perfishire analiza progresi dhe rekomandime per permiresimin e sherbimit ne kuader te planit social. -Vizibiliteti me ane te broshurava dhe aktiviteteve ne ditet nderkombetare te respektimit te te drejtave te femijeve dhe aftesise se kufizuar.

5.Përshkrim i shkurtër

Modeli i ndërhyrjes "Sherbimi Levizes" është një bashkëveprim i shërbimeve në shtëpi dhe mobilizimit të komunitëtit.Sherbimi levizes i referohet ekipit te profesionisteve te cilet ofrojne asistencen e tyre ne terren, te trajnuar per te identifikuar,referuar,adresuar problemtika ne fushen e mbrojtjes se femijeve, ofruar sherbime te specializuara per femijet me aftesi te kufizuar (logoped,psikolog,fizioterapist),qe veprojne ne nje zone me sherbime te limituara ose plotesisht te munguara

"Sherbimi levizes " eshte shkruar per te adresuar ceshtje sensibel si identifikimi dhe mbeshtetja e femijeve ne nevoje per mbrojtje dhe nevojat e femijeve me aftesi te kufizuar, kjo referuar mungeses se shërbimeve komunitare të specializuara për ti ndihmuar ata të jetojnë në potencialin e tyre të plotë. Studim kombëtar realizuar nga World Vision Albania dhe Save the Children,Analizat locale te bashkise Elbasan ne kuadrin e hartimit te planit social te mbrojtjes kane evidentuar dukshëm faktore te tille si: (1) mungesa e shërbimeve me cilësi të lartë të cilat bëjnë të mundur që fëmija të arrijë potencialin e plotë përmes programeve edukative të individualizuara; (b) kushte të papërshtatshme për të siguruar mirëqënien dhe edukim cilësor

të fëmijëve me aftësi të kufizuara të larta ose të moderuara;(c) mungesa e një mjedisi shoqëror pozitiv dhe mikëpritës.

Shërbimet në shtëpi nënkuptojnë që një Njësi Lëvizëse e cila ka ne perberjen e saj një ekip profesionistësh; një menaxher projekti/ një punonjës social, një psikologë, një fizioterapist një logopedist dhe nje shofer e cila ka aftesi dhe infrastrukturen e nevojshme (automjet, materiale ndihmëse) per te ofruar mbeshtetjen per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe shërbim cilësore për fëmijët më aftësi të kufizuar ne vendin ku ata jetojne (shtepi).

Njesia levizese do të jete ne terren duke ofruar sherbime ne shtepine e cdo femije te identifikuar bazuar ne nje grafik te caktuar.Sherbimi fillon me vleresimin e nevojave te femijes dhe familjes,ne rastin e femijeve ne nevoje per mbrojtje punonjesi social i Njesise administrative perkatese (i cili eshte pjese e ekipit levizes) do te plotesoje formularin e identifikimit Proaktiv dhe do te kordinoje me NJMF ne bashkine Elbasan per menaxhimin e rastit.Ne rastin e femijeve me aftesi te kufizuar vleresimi I nevojave te femijes do te realizohet në bashkëpunim me grupin multidisiplinar të vlerësimit të Aftësisë së kufizuar në DAR, vleresim i cili bazohet ne Klasifikimin Nderkombetar te Funksionalitetit (KNF)dhe do te koordinohet per mbeshtetjen e rastit me , specialistin per PAK prane Drejtorise se sherbimit te kujdesit social dhe komunitar prane bashkise Elbasan.

Pasi vlërësohen nevojat e fëmijës dhe familjes do të zhvillohet një Plan Zhvillimi Individual (PZHI) i cili dakortesohet me kujdestarin e femijes. Gjate vleresimit dhe hartimit te planit te zhvillimit ekipi i specialisteve ndervepron/konsultohem me specialist (pediatrer zhvilimi, psikiater,ortoped,punonjes social, psikolog, mesues mbeshtes, mesues kujdestare etj) qe e njohin rastin e femijes dhe familjes. Ekipi specialisteve referuar planit te zhvillimit do te jete duke ofruar sherbim njehere ne jave si dhe do te mbështesë anetaret e familjes / kujdestaret per te kryer aktivitetet qe mund te behen ne shtepi, në mjëdisin e tyrë natyror, duke mundesuar keshtu në zhvillimin e potencialit te femijeve.

Nje vemendje e vecante e modelit "Sherbimi Levizes" është mobilizimi i komunitetit, duke punuar ngushtë me komunitetin, palët e interesuara dhe profesionistët. Sistemi i mbështetjes me bazë komunitare për femijet ne nevoje per mbrojtje, familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuar do të promovohet dhe fuqizohet duke krijuar një grup vullnetarësh(studente,nena,te rinj) që do të bashkepunojme me njesine levizese. e Komunitare. Vullnetarët do të mbështesin familjët me aktivitete psiko-sociale/ rikreative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vëllëzërit e motrat e tyre; takime ndërgjëgjësuese mbi mbrojtjen e femijeve nga dhuna/abuzimi dhe për të drejtat që u takojnë fëmijëve me Aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre .

Commented [DQ1]: Ketu sipas potencialit te AP te rinj, bashkemoshatare , nena, student etj

Ekipi duke pasur ne perberjen e tij profesioniste te fushes se mbrojtjes se femijeve si punonjesin social te njesise administrative perkatese ,psikolog, si dhe terapiste logopedist dhe fizioterapist per te ofruar sherbime direkte, do te realizoje:

- identifikimin e rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje,
- Ofrimin e sherbimeve te specializuara per femijet me aftesi te kufizuar
- referimin e rasteve te femijeve dhe familjeve ne nevoje per sherbime (kryesisht shendetsore, sociale, arsim)ne zonat me te aferta dhe prane NJMF
- Informimin e femijeve dhe familjeve mbi sherbimet ne dispozicion te tyre ne nivel lokal.

- Ndergjegjesimi dhe mobilizimi brenda komunitetit rreth shqetesimeve per mbrojtjen e femijeve dhe aftesise se kufizuar
- Identifikimi i shqetesimeve per mbrojtje brenda komuniteteve dhe fshatrave dhe marrja e masave per adresimin e ketyre shqetesimeve
- Fuqizimi i mekanizmave lokale te Mbrojtjes se femijeve duke integruar mekanizmat formale dhe informale te mbrojtjes se femijeve
- Rritjen e kapaciteteve te profesionisteve duke bashkevepruar me ta si :mjeku familje,infermieri,mesuesi,polici i zones etj

6. Analiza e Situatës dhe Arsyetimi

Bashkia Elbasan, është qëndra me e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ, qytetin e Elbasanit dhe 12 komunat, Labinot Mal, Funarë, Labinot fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan , Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.

Popullata rezidente e bashkisë Elbasan, si rrjedhoje e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 40% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim te vitit 2015, prej 147 mijë banorë .

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës dhe mosha mesatare të cilat tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Elbasan, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku, ka potencial të lartë të popullsisë në moshë punë që mund të jetë ekonomikisht aktive

Persa i perket target grupit femije ne nevoje per mbrojtje (te cilet mund te jene edhe femije me AK) problematike mbetet identifikimi dhe referimi i femijeve ne rrezik abuzimi,shfrytezimi, neglizhimi etj ne strukturat pergjegjese.

Kijimi i Sektorit te Mbrojtjes se Fëmijëve (NJMF) si pjesë e Drejtorisë së Kujdesit Social bëri qe ërbimet sociale publike të luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijeve dhe gjithashtu të bëhet i mundur dhe krijimi i një sistemi informacioni mbi situatën, nevojat e fëmijëve me probleme sociale si dhe shërbimet e ofruara ndaj tyre. Sektori i Mbrojtjës së Fëmijëve në bashkinë Elbasan në zbatim edhe të ligjit Nr.18/2017 "Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" është një ofrues publik shërbimesh sociale për fëmijët, qoftë drejtpërdrejt apo të koordinuara në rrjet, të cilat synojnë të përmbushin dhe respektojnë parimet dhe kriteret e përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë, në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe akte të tjera për respektimin e të drejtave të fëmijëve.Fokusi kryesor i punes i kesaj Njesie eshte identifikimi dhe menaxhimi i rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje. Per vitin 2017 NJMF ka menaxhuar 128 raste te femijeve ne nevoje per mbrojtje kryesisht raste qe i perkasin qytetit te Elbasanit dhe vetem 14 raste prej tyre jane referuar nga Njesite administrative. Megjithese prane ketyre Njesive administrative eshte vendosur nje punonjes social per identifikimin dhe refrimin e rasteve ne nevoje nder ta dhe femijet ne nevoje per mbrojtje mbetet problematike identifikimi i rasteve.

Identifikimi dhe refrimi i rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje ,ofrimi i ndihmes emergjente per rastet ne rrisk te larte si dhe mungesa e aksesit ne sherbime te specializuara per femijet me Ak qe jetojne ne zona te thella te bashkise Elbasan jane bere shpesh tema diskutimi ne Tryezat Teknike te organizuara nga Drejtoria e Sherbimit te Kujdesit Social dhe Komunitar prane Bashkise Elbasan me aktoret lokale pjese e mekanizmit te mbrojtjes se femijeve.Nga analiza e situates ne keto takime rezulton se identifikimi i femijeve ne nevoje per mbrojtje mbetet problematike per keto arsye:

- Moskuptim i konceptit" femije ne nevoje per mbrojtje" nga punonjesi social i vendosur prane Njesise Administrative,prej profesionisteve te tjere(mesues,mjek,infermiere,) familjareve dhe komuniteti.
- Ka zona te thella te cilat jane te veshtira te vizitohen nga punonjesi social ne kete menyre nuk njihen problematikat e femijeve .
- Komuniteti nuk ka informacionin e duhur per Rolin e Punonjesit per mbrojtjen e femijeve apo te institucioneve te tjera qe veprojne ne zonen e tyre per mbrojtjen e femijeve.

Lidhur me nevojat per sherbime te specializuara per femijet me aftesi te kufizuar jane evidentuar keto problematika:

- Nje pjese e mire e ketyre njesive jane te pambuluara me sherbime te specializuara rehabilituese per femijet me AK, nderkohe qe nevojat jane te medha si keshillim,fiziterapi,logopedi etj
- Njesite administrative kane nje shtrirje gjeografike te larget nga Bashkia qender ku jane te fokusuara sherbimet sociale per femijet me AK
- Edhe pse nje pjese e femijeve me AK me crregullim te spektrit Autik (xxx) marrin sherbime prane qendrave te specializuara ne qytetin e Elbasanit duke ju rimbursuar transportin Bashkia,ka ende nje numer te konsiderueshem raste te femijeve me AK te cilet e kane te pamundur te aksesojne sherbimet ne qytet per shkak te situates se tyre shendetsore apo dhe raste femijesh te pa diagnostifikuar(kryesisht ne zona te thella)

Commented [P2]: Nr femijeve me autizem qe rimbursohen per transportin nga Bashkia

Sipas statistikave te marra nga *Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, Bashkia Elbasan numri i femijeve me AK eshte sipas treguesve te meposhtem:*

Tab. 1 - Fëmijët me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike viti 2018

Grup-mosha	Aftësi e kufizuar e lindur	Aftësi ekufizuar e fituar gjatë jetës
0-3 vjec	233	32
4-18 vjec	471	334
Totali	704	366

Burimi i informacionit: Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunës në Familje, Bashkia Elbasan

Tab. 2. Fëmijët me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike ne Njesite Administrative ku do te implementohet projekti (viti 2018)

Njesia Administrative	Nr.femijeve me PAK	Femra	Meshkuj

Paper	29	12	7
Bradashesh	63	31	32
Labinot Fushe	42	23	19
Shushice	83	41	42
Shirgjan	44	19	25
Gjergjan	18	8	10
Gjinar	17	7	10
Zavaline	8	3	5
Total	304	144	160

Bazuar ne statistikat rezulton nje numer prej 1070 femije me AK por ka dhe raste te konsiderueshme femijesh me AK te padiagnostikuar kjo per arsye te ndryshme si:mungese informimi e prinderve,neglizhence, mos referim i rasteve nga profesionistet e specialistet perkates,mosndjekje e procedurave per perfitimin e KMCAP.

Ne nje situate te tille del e nevojshme marrja e masave per nderhyrje e duhura per te realizuar identifikimin e rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje dhe ofrimin e sherbimeve te duhura per ta si dhe ofrimin e sherbimeve te specializuara ne familje per femijet me Aftesi te kufizuara ne Njesite Administrative te Bashkise Elbasan.

Sherbim Levizes per Femijet ne Nevoje per Mbrojtje dhe Aftesi te Kufizuar ne Zonen e Elbasanit vjen eshte nje gjetje fale bashkepunimit te bashkise elbasan dhe organizates World Vizion. per te ofruar sherbimet sa me prane femijeve dhe komunitetit. Partneriteti me World Vision nuk eshte i rastesishem. World Vision ka qene nder vite nje partner i rendesishem i Bashkise Elbasan ne fushen e mbrojtjes se femijeve .Vlen te theksohet dhe ekspertiza qe kjo organizate ka tashme ne fushen e sudimit dhe mbeshtetjes se femijeve me aftesi te kufizuar.Projekti i hartuar se bashku me World vision do te mbeshtetet fort ne ekspertizen e kesaj organizate gjate implementimit te nje projekti te tille te ngjashem ne bashkine Librazhd si nje garanci e implementimit me sukses te tij dhe e gjetjes se nje alternative te suksesshme ne ofrimin e sherbimeve ne familje prane komuniteteve per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe femijeve me aftesi te kufizuar.

Perse nje sherbim levizes komunitar ?

Sherbimi Levizes i referohet ekipit te profesionisteve te cilet ofrojne asistencen e tyre ne terren, te trajnuar per te identifikuar,referuar,adresuar problemtika ne fushen e mbrojtjes se femijeve, ofruar sherbime te specializuara per femijet me aftesi te kufizuar (logoped,psikolog,fizioterapist),qe veprojne ne nje zone me sherbime te limituara ose plotesisht te munguara.Ekipi do te kete ne perberjen e tij profesioniste te fushes se mbrojtjes se femijeve si punonjesin social te njesise administrative perkatese ,psikolog, si dhe terapiste logopedist dhe fizioterapist per te ofruar sherbime direkte per femijet ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftesi te kufizuar.

.Ky sherbim eshte i nevojshem per keto arsye:

Ndertimin e nje maredhenie besimi me femijet dhe komunitetin

Identifikimin e rasteve te femijeve ne nevoje per mbrojtje

Lehtesimin e komunikimit me komunitetin e targetuar

Mbulimi me sherbime ne ato zona te cilat e kane te pamundur te sigurojne nje game te caktuar sherbimesh ne zona te thella rurale specifikisht per femijet me aftesi te kufizuar.

Femijet,familjet komuniteti zhvillojne nje kuptim me te mire te sherbimeve sociale,mjekesore dhe te aftesise se kufizuarqe jane ne dispozicion te tyre ne zonen e tyre apo ne zonen perreth

Femijet familjet komuniteti fitojne shkathtesi qe i ndihmojne te kapercejne pengesa sic mund te jete komunikimi.

Ofrim i mbeshtetjes direkte,mbeshtetje sociale,emocionale,mentorim advokim

Rritje e kapaciteteve te profesionisteve te zones mbi mbrojtjen e femijeve dhe aftesine e kufizuar permes koordinimit te perbashket dhe mentorimit.

Forcimi i bashkepunimit ndersektorial per mbrojtjen e femijeve

Njesia Levizese plotësohen kriteret sipas Planit Social Vendor për financim të Fondit Social për ngritjen e Shërbimeve Sociale me bazë komunitare duke qene se perfituestit direkt jane femijet ne nevoje per mbrojtje, femijet me aftesi te kufizuar dhe familjet e tyre duke ofruar sherbim te specializuar ne shtepi. Si rezultat i ketij projekti do te kemi përmirësim te shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ngritja e shërbimeve të reja per femijet me aftesi te kufizuar duke shtuar stafin dhe kualifikuar stafin e specialisteve sipas standarteve.

7. Objektivat:

Objektivi 1.Te identifikohen/referohen femijet ne nevoje per mbrojtje dhe ofrohen sherbime te specializuara femijeve me aftesi te kufizuar permes "Shërbimit Lëvizës Komunitar".

Bashkia Elbasan ne bashkepunim me World Vision hartojne marreveshjene e bashkepunimit e cila fokusohet ne:

a) rregullimin e marredhenieve mes paleve zbatuese kjo bazuar në Ligjin.nr139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kodit Civil te RSH dhe Ligjit nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Ligji nr.121/2016. Vec ketyre eshte "Dispozita të Përgjithshme të Projektit Tungjatjeta" -Shtojca A .

b) ofrimin e sherbimit sipas ligjit "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara".

c) perzgjedhjen e Njesise Levizese (rekrutimin e stafit). Kjo njesi perbehet nga kater specialiste (psikolog, punonjes social, logopediset, fizioterapist) dhe nje shofer . Per kete palet zbatuese do te mbeshteten VKM nr. 243, datë 18.3.2015 – Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive; "Dispozita të Përgjithshme të Projektit Sherbimi levizes"- Shtojca A dhe "Përshkrimi i punës për specialistët e ekipit lëvizës, Për ofruesit e shërbimeve për fëmijët dhe familjet me aftësi të kufizuara" - Shtojca B

Pas ngritjes se njesise levizese, stafi i rekruatuar kalon ne nje set trajnimesh qe rrisin aftesite e tyre ne identifikimin e femijeve ne nevoje per mbrojtje, dhenien e sherbimit ne kushte shtepiake duke e pare Aftesia e kufizuar ne lentet e modelit biopsikococial.Per te trajtuar

ngarkesen emocionale qe kalojne specialistet e njesise levizese ata supervizohen/mentorohen. Ne te njejten kohe sfai i njesise levizese pajiset me infrastrukturë të nevojshme si automjet dhe materiale ndihmëse për të ofruar shërbime cilësore për fëmijët ne nevoje per mbrojtje dhe femijet me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2. Te realizohet koordinimi multidisiplinar dhe ndersektorial ne dhenien e sherbimeve per femijet ne nevoje per mbrojtje,per femijet me aftesi te kufizuar dhe familjeve te.

Njesia levizese ne bashkepunim me Drejtorine e sherbimit te kujdesit social dhe komunitar prane bashkise Elbasan do të analizoje listen prej 40 perfitues qe do tu ofrohet sherbimi ne shtepi. Sigurisht palet zbatuese kane vendosur paraprakisht disa kritere qe ndihmojne ne perzgjedhjen e perfituesve. Pasi perzgjidhjen femijet dhe familjet qe do tu sherbehet behet komunikim dhe merret dakortesia per sherbimin ne shtepi te kujdestarit ligjor dhe perfituesit .

Sherbimi ne shtepi fillon me procesin e vleresimit . Njesia levivizese e lehteson kete proces vleresimi. Pasi vlërësohen nevojat e fëmijës dhe familjes do të zhvillohet një Plan Zhvillimi Individual (PZHI) i cili dakortesohet me kujdestarin e femijes. Gjate vleresimit dhe hartimit te planit te zhvillimit ekipi i specialisteve ndervepron/konsultohem me specialist (pediatrer zhvilimi, psikiater,ortoped,punonjes social, psikolog, mesues mbeshtes, mesues kujdestare etj) qe e njohin rastin e femijes dhe familjes. Ekipi specialisteve referuar planit te zhvillimit do te jete duke ofruar sherbim njehere ne jave si dhe do te mbështesë anetaret e familjes / kujdestaret per te kryer mirembajtur terapine me aktivitetet qe mund te behen ne shtepi, në mjëdisin e tyrë natyror, duke mundesuar keshtu në zhvillimin e potencialit te femijeve. Cdo perfitues sherbimi ka dosjen e tij ne te cilen jane pasqyruar vleresimet dhe planet e zhvillimit , te cilat rishikohen cdo gjashte muaj .

Objektivi 3. Të rritet përfshirja aktive e familjareve, komunitetit në mbrojtjen e femijeve dhe respektimin e te drejtave te tyre.

Komunitet mbështetës i fuqizuar dhe promovues për shërbimin lëvizës dhe të drejtat e familjeve ne nevoje per mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

Ashtu sic eshte artikuluar me lart ky projekt eshte shkruar per te adresuar femijet ne nevoje per mbrojtje dhe numrin e konsiderueshem te femijeve me aftesi te kufizuar dhe mungeses se shërbimeve komunitare të specializuara për ti ndihmuar ata të jetojnë në potencialin e tyre të plotë. Ky objektiv synon te permiresojne mjedisi shoqëror ku femjes i duhet te zhvilloje potencialin e tij. Thelbi i kesaj nderhyrje eshte respektimi i te drejtave te femijeve ne nevoje per mbrojtje dhe femijeve me aftesi te kufizuar permes mbeshtetjes se familjes dhe mobilizimi i komunitetit.

Roli i familjes në aspektin e mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijës është vendimtar dhe praktika tregon nevojen e madhe për identifikimin, mbështetjen e femijeve ne nevoje per mbrojtje dhe shërbime te specializuara pa kosto (ose me kosto të përballueshme) per femijet me AK Ne këtë perspektivë, njësia levizese nderton plane zhvillimi per familjen 1- aftesimi i prindërve ne zhvillimin e potencialit te femjeve te tyre 2-mbështetje emocionale; 3- mbështetje sociale ; 4- Rritja e ekonomisë dhe kushteve të jetesës.

Prindërit, kujdestarët , vëllezërit e motrat e fëmijëve që përfitojnë nga programi pasi mësohen dhe këshillohen nga njesia levizese si të kryejnë ushtrime të thjeshta dhe të ndërtojnë disa aftësi që i ndihmojnë ata të kryejnë aktivitete që ndikojnë në zhvillimin e potencialit të fëmijëve sipas Planit Individual të Zhvillimit . Përveç kësaj, ndërhyrjet e programit planifikojnë të organizojnë sesione informuese nga punonjësi social dhe psikologu i ekipit për të informuar familjet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me legjislacionin per mbrojtjen e femijeve dhe përfitimet që fëmijët e tyre kanë dhe ti mbështesin në proceset që kanë të bëjnë me qasjen në arsim, shëndetësi dhe shoqëri shërbimeve.

Objektivi 4. Te rriten kapacitet e te gjitha agjencive që janë pjesw e sistemit te mbrojtjes se femijeve dhe e trajtimit te rasteve te femijeve me aftesi te kufizuar

Grupi levizes ne procesin e identifikimit,vleresimit dhe mbeshtetjes se rasteve do te bashkepunoje,konsultohet me specialist (pediatrer zhvilimi, psikiater,ortoped,punonjes social, psikolog, mesues mbeshtes, mesues kujdestare etj) qe e njohin rastin e femijes dhe familjes. Gjithashtu do te organizohen takime ndersektoriale nen koordinimin e mentorimin e NJMF prane bashkise Elbasan per te diskutuar raste e femijeve te identifikuar ne nevoje per mbrojtje dhe ofrimin e sherbimeve per te cilat kane nevoje femijet dhe familjet.Ne kete menyre do te realizohet rritja e kapaciteteve te profesionisteve te fushes dhe shkembimi i eksperiencave per te arritur ne praktika pozitive te menaxhimit te rasteve.

8. Rezultatet e pritura

- Për çdo objektiv të propozimit, përfshi një përshkrim të detajuar të ndikimit të pritshëm mbi grupet / përfituesit e synuar. Jini specifik dhe cilësoni rezultatet sa më shumë që të jetë e mundur.

R.1.150 femije ne nevoje per mbrojtje identifikohen/referohen dhe 35 femijeve me aftesi te kufizuar ju ofrohen sherbime direkte nga 4 profesioniste te trajnuar(sherbimi levizes) dhe te pajisur me aftesi dhe infrastrukturen e duhur.

R.2. Koordinimi multidisiplinar i Shërbimit lëvizës me profesioniste te tjere (pediatrer zhvilimi, psikiater,ortoped,punonjes social, psikolog, mesues mbeshtes, mesues kujdestare etj) është funksional dhe ofron shërbime mbështetëse për fëmijët ne nevoje per mbrojtje,femijet me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre .

R.3.160 prinder/anetare te komunitetit jane fuqizuar dhe jane mbeshtetes dhe promovues për shërbimin lëvizës dhe të drejtat e femijeve ne nevoje per mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

R.4 .48 profesioniste perfaqesues te agjensive te ndryshme dhe 8 punonjes sociale te njesive administrative kane rritur kapacitetet e tyre ne mbrojtjen e femijeve dhe trajtimin e rasteve te femijeve me aftesi te kufizuar

9. Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë

- Kush do të përfitojë nga zbatimi i programit - direkt dhe indirekt. Jini specifik dhe sasior sa më shumë që të jetë e mundur.

- Si do të sigurojë, ose synon të sigurojë, barazinë gjinore, qasjen e burimeve dhe mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, si dhe të planifikojë që ata të kenë mundësinë të përfitojnë nga të gjitha aktivitetet.

Përfitues te drejperdrejte 235 femije nga te cilet 150 ne nevoje per mbrojtje dhe 85 me Aftesi te Kufizuar. Perfitues direct do te jene dhe 160 Prinder te femijeve ,48 profesioniste te agjensive te ndryshme(mesues,infermier,mjek,punonjes I policimit ne zone) dhe 8 punonjes sociale te Njesive Administrative[1]

Modeli "Sherbimi levizes komunitar " do te realizoje identifikimin e 150 femijev ne nevoje per mbrojtje permes vizitave te terren dhe ne sherbime drejpersedrejti 85 femijeve me Aftesi te kufizuar dhe 160 prinderit e tyre . Femijet me aftesi te kufizuar do te perzgjidhen ne bashkepunim me Dr.SHSSHR, DSHP dhe DAR . Triangulimin i te dhenave nga keto tre institucione baze do te na siguroje barazinë gjinore, qasjen e burimeve dhe mundësive të barabarta për te gjithe.

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **TETOR 2019** gjithsej 160 familje me një fond prej 400.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1486
25.10.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.10251/1 Prot. Elbasan më, 24.10.2019

VENDIM

Nr 148 Dt. 24/10 /2019

"PËR MBARIMIN PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT BASHKIAK

z. Albano DUSHKU"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24/10/2019, në mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronjat "b" dhe pika 5, të nenit 54 shkronja "j", dhe të nenit 55 pika 3 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Komisionit i Mandateve i Këshillit Bashkiak;

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Elbasan, z. Albano Dushku, përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste e Shqiperise, për arsye të doreheqjes nga mandati.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i Këshillit Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

Konceptoi:

Kryetari i K.M. L. Popja

Konfirmoi:

Drejtoria Juridike O. Deliallisi

1526
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr.9508/prot

Elbasan me 30.10.2019

VENDIM

Nr.156/datë 24/10/2019

Per mbështetje financiare për shërbime në situatë emergjente sociale në shtëpi.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të dates 24/10/2019 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar për miratim të paketës financiare të ndihmës për shërbime në situatë emergjente sociale në shtëpi nga fondet sociale të të ardhurave të bashkise ; bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 24 pikat 1 dhe 4; ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 4 pika 4; ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh" neni 8 pika 1 germa c (Shërbimet në situatë emergjente), nenet 46,47 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Shërbimet e kujdesit shoqerore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat dhe masën e shumës për shpenzime për përfituesit e shërbimeve sociale" pikat 4 e 31 (shërbimet e emergjencës sociale në shtëpi),

VENDOSI

I.Të trajtojë me pagesë 10.000 lekë në muaj duke filluar nga muaji Tetor deri në Dhjetor 2019 në kushte emergjente sociale në shtëpi si më poshtë:

1.Çaush Ymer Mustafaj , banues në Elbasan, lagje "Vullnetari",

2.Vrani Qosja , banor i Njesise Administrative Zavaline,

3. Elinor Bardhi , banor i Njesise Administrative Zavaline.

4.Sabri Nazmi Çeka banor i Njesise Administrative Gracen,

5.Shpetim Zyber Mullahu, Banor i Njesise Administrative Bradashesh.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori K.Social Sh.Lika

Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxhetit M.Beluli

Drejtori Finances A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9860 Prot.

Datë 30 .10. 2019

VENDIM

NR. 157 DATË 24 . 10. 2019

MBI

"Transferim fonde për shpenzime, midis njësive shpenzuese"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24 .10. 2019, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde midis njësive shpenzuese, në buxhetin e vitit 2019", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", vendimin e Këshillit Bashkiak nr.162, datë 24.12.2018 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2019" dhe nr.26, date 21.03.2019 "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, si dhe transferim fonde në buxhetin e vitit 2019",

VENDOSI :

1. Në buxhetin e vitit 2019, të bëhet transferimi i fondeve për paga dhe sigurime shoqërore, midis njësive shpenzuese, si më poshtë :

Paksohet : në mijë lekë

Programi	Kap.	Artikulli	Shuma	Njësia Shpenzuese
01120	5	600	1,000	Bashkia
04260	5	600	2,440	Bashkia (Sh.Pyjor)
		Gjithsej :	**3,440**	

Shtohet :

Programi	Kap.	Artikulli	Shuma	Njësia Shpenzuese
10220	5	600	300	Q.S."Balashe" (Sh.Moshuarve)
10220	5	601	100	Q.S."Balashe" (Sh.Moshuarve)
10430	5	600	420	Q.S."Balashe"
10430	5	601	130	Q.S."Balashe"
08130	5	600	100	M.Terrene Sportive
08130	5	601	100	M.Terrene Sportive
08220	5	600	280	Trashëgimia Kulturore
08220	5	601	110	Trashëgimia Kulturore
08220	5	600	1,200	Qendra e Artit
08220	5	601	700	Qendra e Artit
		Gjithsej :	**3,440**	

2. Transferimin e fondeve midis njësive shpenzuese, miratuar ne buxhetin e vitit 2019 në artikullin shpenzime (602-604) dhe përdorim i fondit rezerve (për financimin e shpenzimeve për ndriçimin rrugor), si më poshtë :

Paksohet : në mijë lekë

Programi	Kap.	Artikulli	Shuma	Emërtimi	Njësia Shpenzuese
01110	5	604	4,900	kuote anetarësie	Bashkia
06260	5	602	5,000	shp.internet falas	Bashkia
04980	5	609	7,900	fondi rezerve	Bashkia
		Gjithsej :	**17,800**		

Shtohet :

Programi	Kap.	Artikulli	Shuma	Emërtimi	Njësia Shpenzuese
09120	5	602	840	ushqime (femije ne nevoje)	Q.Ek.Arsimit
06440	5	602	9,000	shp.ndriçim rrugor	ASHP
06260	5	602	4,353	shp.shërbimi rojeve	ASHP
08220	5	602	707	shpenz.penalitete	Qendra e Artit
01110	5	602	2,900	shpenzime	Bashkia
		Gjithsej :	**17,800**		

Programi 01110, Njësia shpenzuese Bashkia, detajohet si më poshtë :

- Shpenzime për energjinë 900 mijë lekë
- Shpenzime poste 380 mijë lekë
- Shpenzime (komisione)për postën si agjent tatimor 600 mijë lekë
- Komisione banke për pagesën e nd. ekonomike 220 mijë lekë
- Rinovim liçensa antivirus 800 mijë lekë

Gjithsej : 2,900 mijë lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Prokurimeve dhe njësite vartëse të Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Dr.Buxhetit : M.Beluli
Dr.Përgj. Q.Tusha
Dr.Prok.Publike : A.Muhametaj
Dr.Juridike: O.Deliallisi
ZV/ Kryetari : I.Sina

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9531 **Prot.** **Elbasan, më** 30 **.10.2019**

V E N D I M

Nr. 158 **Datë:** 24 **.10.2019**

"Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të ambjenteve për t'u përdorur për shkolla për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24 .10.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave), *"Miratim për marrje me qira të ambjenteve për t'u përdorur për shkolla për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"* bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, në ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*, Udhëzim i MAS nr. 348 datë 18.10.1994.

V E N D O S I :

1. Miraton marrjen me qira të ambjenteve për t'u përdorur për shkolla si paraqiten në vijim:

Nr	Njësia Administ.	Subjekti qiramarrës Shkolla	Qëllimi qiramarrjes	Vend ndodhja	Klasa Nr.	Vlera kontratës Lekë/muaj	Subjekti qiradhënës
1	GRACEN	Shkolla Mamël-Gracen	Shkollë	Tërbaç	1(një)	2000	Kujtim Stafa
2	SHUSHICË	Shkolla "9-vjeçare"	Shkollë	Mlize	1(një)	6000	Shefki Tahiri
3	GJINAR	Shkolla "9 vjeçare"	Shkollë	Pobrat/Lleshan	1(një)	2000	Haxhi Ahmati

2. Afati i kontratave është 01.09.2019-30.06.2020.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave) dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Beniuli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

1529
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.9930 Prot. **Elbasan, më 30.10.2019**

V E N D I M

Nr.159 Datë:24.10.2019

"Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të ambjenteve për t'u përdorur për kopshte për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave), **"***Miratim për marrje me qira të ambjenteve për t'u përdorur për kopshte për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"* bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, në ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*, Udhëzim i MAS nr. 348 datë 18.10.1994.

V E N D O S I :

1. Miraton marrjen me qira të ambjenteve për t'u përdorur për kopshte si paraqiten në vijim:

Nr	Njësia Administ.	Subjekti qiramarrës Shkolla	Qëllimi qiramarrjes	Vend ndodhja	Klasa Nr	Vlera kontratës L/muaj	Subjekti qiradhënës
1	Tregan	Shkolla Shilbatër	kopësht	Cikallesh	1(një)	5200	Ahmet Tashi
2	Papër	Kopshti Papër	kopësht	Vidhas	1(një)	7000	Maringlen Ballhysa
3	Labinot Fushë	Shkolla"S.Rranci"	kopësht	Mengël	1(një)	6000	Xhevit Shabani
4	Gracen	Shkolla Mamël-Gracen	kopësht	Tërbaç	1(një)	2000	Kujtim Stafa

2. Afati i kontratave është 01.09.2019-30.06.2020.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave) dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

1030
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9933/1 **Prot.** **Elbasan, më** 30.10.2019

V E N D I M

Nr. 160 **Datë:** 24.10.2019

"Marrje me qira ambjent/sallë (rinovim kontrate) për të zhvilluar mbledhje të Administratës së Bashkisë"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24 .10.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori i Pronave) i relaton Këshillit Bashkiak, *"Marrje me qira ambjent/sallë (rinovim kontrate) për të zhvilluar mbledhje të Administratës së Bashkisë"*, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*,

V E N D O S I :

1. Miraton marrje me qira Sallën e Konferencave të Hotel Turizmit "Skampa" në pronësi të Shoqërisë "HOTEL SKAMPA" për të zhvilluar mbledhje të Administratës së Bashkisë për periudhën 1 (një) vjeçare nga 01.11.2019 deri 31.10.2020, me vlerë qiramarrje prej 17000 lekë përfshirë T.V.SH për çdo mbledhje të zhvilluar të Administratës së Bashkisë.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Sektori Pronave: *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

1531
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.9949/1 Prot. **Elbasan, më 30.10.2019**

V E N D I M

Nr.161 Datë:24.10.2019

"Mbi miratimin e nisjes së proçedurave për marrjen me qira të tre mjeteve (një autoveturë, një fuoristradë, një fadromë) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan, me një fond deri në 300.000 lekë në muaj"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve Buxhetit dhe Finances (Sektori i Pronave) Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban (Sektori i Transportit), Agjensia e Shërbimeve Publike, "Mbi miratimin e nisjes së proçedurave për marrjen me qira të tre mjeteve (një autoveturë, një fuoristradë, një fadromë) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan, me një fond deri në 300.000 lekë në muaj", bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, *"Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publike dhe nëpunësit civile"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*, dhe në kërkesën nr. 9034 Prot., datë 12.09.2019 të Agjensisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë të Shërbimit të Territorit Urban (Sektori i Transportit),

V E N D O S I:

1. Miraton nisjen e proçedurave për marrjen me qira të tre mjeteve (një autoveturë, një fuoristradë, një fadromë) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë Elbasan, me një fond deri në 300.000 lekë në muaj", me afat 1 vit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e të gjithë proçedurës përkatëse të konkurimit për marrjen me qira ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban (Sektori i Transportit) dhe Agjensia e Shërbimeve Publike.

3. Miraton *"Anulimin e V.K.B Nr. 116 datë 23.08.2019"*

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9929 **Prot.** **Elbasan, më** 30 **.10.2019**

VENDIM

Nr. 162 **datë** 24 **.10.2019**

"Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Këshillit të Qarkut Elbasan, për realizimin e investimit "Hidroizolim i çatisë dhe sistemim i murit rrethues e i territorit të kopshtit nr.11, Bashkia Elbasan""

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 24 .10.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 (pika 1.2/c e pika 1.5), neni 14 e neni 23 (pika 11 e tij), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Këshillit të Qarkut Elbasan, me qëllim realizimin nga ky i fundit i investimit *"Hidroizolim i çatisë dhe sistemimin e murit rrethues e të territorit të kopshtit nr.11, Bashkia Elbasan"*, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:

Drejtoria e Buxhetit:	*M. Beluli*
Drejtoria e Financës;	*A. Merkja*
Drejtoria Juridike:	*O. Deliallisi*
Drejtoria e Përgjithshme e PAPTKTS:	*K. Krasnika*
Drejtoria e Përgjithshme e SHO:	*B. Çabiri*
Sekretari i Përgjithshëm:	*A. Bylykbashi*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT ELBASAN
KRYETARI

Nr.345 Prot.
Elbasan me 10.10. 2019

Nr 9372 Prot
Elbasan me 11.10.2019

MARRËVESHJE BASHKEPUNIMI

E lidhur sot më daë __.10.2019, midis paleve:
-Këshillit të Qarkut Elbasan, perfaqesuar nga **z.Bukurosh Stafa**, me funksion Kryetar i Keshillit te Qarkut
-Bashkia Elbasan e perfaqesuar nga z.**Gledian LLATJA** me funksion Kryetar i Bashkise Elbasan

me permbajtje si me poshte:

Neni 1
Qëllimi/Objektivi/Kohezgjatje

Qëllimi:
Per realizimin e investimit " Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan" me vlere 2 323 547 leke .

Objektivi i Projektit
Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan.

Kohezgjatja
Deri ne realizimin perfundimtar te investimit" Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan ".

Neni 2
Baza Ligjore

Baza ligjore mbi të cilën mbeshtetet kjo marreveshje është :

- Ligji Nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore".
- Vendimi Nr.36 date 30.09.2019 "Per miratimin e realizimit te projektiti" Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan"

Neni 3
Te Drejtat, Detyrat dhe Pergjegjesite e paleve

A.Te Drejtat dhe Detyrat e Këshillit të Qarkut janë:

- Te financoje projektin " Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan" ne vleren 2 323 547 leke . sipas planit te buxhetit te miratuar nga Keshilli qarkut Elbasan.

- Te realizoje investimin " Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan.
- Te realizoje proceduren e prokurimit me tender per fondin e mesiperm duke perfshire investimin si dhe mbikqyrjen dhe kolaudimin.
- Te marre ne dorezim investimin e kryer nepermjet grupit te punes te perbere nga perfaqesues te Keshillit te Qarkut dhe Bashkise Elbasan
- Ti dorezoje Bashkise Elbasan investimin e kryer per " Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan", per regjistrim ne aktivet e bashkise.

B. Te Drejtat dhe Detyrat Bashkise Elbasan janë:

- Te vere ne dispozicion te Keshillit te Qarkut Elbasan dokumentacionin teknik te projektit" Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan" me pjeset perberese projekt, preventiv, specifikimeve teknike, grafik te punimeve, si dhe inxhiniere ndertimi per te qene pjese e njesise se prokurimit, kvo dhe grupit te punes per marrjen ne dorezim te punimeve.
- Te marre ne dorezim investimin e kryer nepermjet grupit te punes te perbere nga perfaqesues te Keshillit te Qarkut dhe Bashkise Elbasan.
- Te marre ne dorezim nga Keshilli i Qarkut investimin e kryer per " Hidroizolimi i çatise dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit te kopshtit nr. 11 , bashkia Elbasan", per regjistrim ne aktivet e Bashkise.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.
Ajo hartohet në 4 kopje, dy kopje për çdo palë.

Këshilli i Qarkut Elbasan

KRYETARI

Bukurosh STAFA

Bashkia Elbasan

KRYETARI

Gledian LLATJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10219 **Prot.** **Elbasan, më** 30 **.10.2019**

VENDIM

Nr. 163 **datë** 24 **.10.2019**

"Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Elbasan, Këshillit të Qarkut Elbasan dhe subjektit "Woman Centre for Development and Culture Albania", në cilësinë e donatorit, me qëllim realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan";

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 24 .10.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 (pika 1.2/c e pika 1.5), neni 14 e neni 23 (pika 11 e tij), në ligjin nr.9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" si dhe në VKB nr.162 datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Elbasan, Këshillit të Qarkut Elbasan dhe subjektit "Woman Centre for Development and Culture Albania", në cilësinë e donatorit, me qëllim realizimin e investimit *"Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan"*, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë kontributin prej 3.354.000 lekë, si diferencë e fondit total të investimit të lartpërmendur, që do financohet nga Bashkia Elbasan.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:
Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*
Drejtoria e Financës: *A. Merkja*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Drejtoria e Përgjithshme e PAPTKTS: *K. Krasnika*
Drejtoria e Përgjithshme e SHO: *B. Çabiri*
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT ELBASAN	REPUBLIKA E SHQIPËRISË OJF "WOMAN CENTER FOR DEVELOPMENT & CULTURE ALBANIA"
Nr. 1062 *Prot.* *Dt.* 22.10.*2019*	*Nr.* 152/1 *Prot.* *Dt.* 22.10.*2019*	*Nr.* 87 *Prot.* *Dt.* 22.10.*2019*

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

"Për realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)"

E lidhur sot, më datë ___.___.2019, midis palëve:

1) **Bashkia Elbasan,** e përfaqësuar nga Kryetari i saj, **z. Gledian Llatja;**

2) **Këshilli i Qarkut Elbasan,** i përfaqësuar nga Kryetari i tij, **z. Bukurosh Stafa;**

3) **Organizata Jofitimprurëse "Woman Center for Development and Culture Albania" (WCDCA),** e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv i saj, **znj. Rudina Çollaku;**

me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet me qëllim realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)".

Neni 2
Objekti

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për objekt bashkëfinancimin, nga ana e palëve, sipas fondeve respektive, për të realizuar investimin e lartpërmendur, në vlerën totale 9.453.054 lekë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të jetë deri në realizimin përfundimtar të investimit.

Neni 4
Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në mbështetje të:

- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *(i ndryshuar);*
- Kodit Civil të R.SH. në fuqi;
- Vendimit të Këshillit të Qarkut Elbasan nr.57 datë 14.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2019";
- Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.8 datë 15.02.2019 "Për një ndryshim në planin e buxhetit të vitit 2019";
- Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.11 datë 15.02.2019 "Për bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta me bashkitë, për vitin 2019".

Neni 5
Të Drejtat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Palëve

- **Bashkia Elbasan** merr përsipër të financojë kontributin prej **3.354.000 lekë,** si diferencë e fondit total të investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)".
- **Këshilli i Qarkut Elbasan** merr përsipër të financojë vlerën **4.500.000 lekë** për realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)".
- **OJF "Woman Center for Development and Culture Albania"** merr përsipër financimin në vlerën **1.600.000 lekë** për realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)".

A. Të Drejtat dhe Detyrat e Bashkisë Elbasan janë:

- Të hartojë projekt zbatimin "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)";
- Të financojë në vlerën **3.353.054 lekë** për realizimin e investimit "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)";
- Të realizojë investimin "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)";
- Të realizojë proçedurën e prokurimit publik për objektin, duke përfshirë investimin, mbikqyrjen dhe kolaudimin;
- Të marrë në dorëzim investimin e kryer;
- Të bëjë regjistrimin në aktivet e bashkisë të investimit të mësipërm;

B. Të Drejtat dhe Detyrat e Këshillit të Qarkut Elbasan janë:

- Të financojë projektin "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)", në vlerën **4.500.000 lekë**, sipas planit të buxhetit të miratuar nga Këshilli i Qarkut Elbasan, me VKQ nr.57 datë 14.12.2018, VKQ nr.11 datë 15.02.2019 dhe VKQ nr.8 datë 15.02.2019;
- Të transferojë në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Elbasan, nëpërmjet Degës së Thesarit, fondin prej **4.500.000 lekë,** per realizimin e investimit të mësipërm.

C. Të Drejtat dhe Detyrat e OJF "Woman Center for Development and Culture Albania" janë:

- Të financojë projektin "Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan" (Faza e parë)", në vlerën **1.600.000 lekë;**
- Të transferojë në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Elbasan, nëpërmjet Degës së Thesarit, fondin prej **1.600.000 lekë,** për realizimin e investimit të mësipërm.

Neni 6
Dispozita të Fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj, nga palët.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në 6 kopje origjinale, nga dy për secilën palë.

PALËT:

BASHKIA ELBASAN

KRYETARI
Gledian Llatja

KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

KRYETARI
Bukurosh Stafa

OJF "Woman Center for Development and Culture Albania"

DREJTORE EKZEKUTIVE
Rudina Collaku

1534
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9990/1 **Prot.** **Elbasan më,** 30 **.10.2019**

VENDIM

Nr. 164 **datë** 24 **.10.2019**

"Për miratimin e sistemit të pikëzimit, që do të përdoret për përzgjedhjen e familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social";
- VKM nr.384 datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";
- VKM nr.362 datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij";

VENDOSI:

1) Të miratojë sistemin e pikëzimit, që do të përdoret për përzgjedhjen e familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë, sipas tabelës bashkëlidhur.
2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit si dhe Komisioni i Strehimit.
3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Ciftja

Konceptoi:
Drejtoria e APS: *A. Xhaja* *A. Suli*
Pranoi:
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Miratoi:
Drejtori i DPPAABF: *Q. Tusha*
Konfirmoi:
Zv/kryetari: *I. Sina*

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

TABELA - Sistemi i pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë

	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
1.1	***Kushtet e strehimit:***	**20**
	a) nuk disponojnë banesë në pronësi;	8
	b) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;	4
	c) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	4
	d) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	2
	e) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga proçesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	2
1.2	***Kushtet familjare:***	**20**
	a) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	10
	b) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	5
	c) familjet me më shumë se katër fëmijë;	4
	d) bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç;	1
1.3	***Kushtet sociale:***	**40**
	a) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me VKM;	9
	b) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;	3
	c) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish - pronarëve;	1

	d) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;	1
	e) familjet e policëve të rënë në detyrë;	1
	f) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);	1
	g) punonjësit e repartit RENEA;	1
	h) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	1
	i) viktimat e dhunës në familje;	7
	j) viktimat e trafikimit / viktimat e mundshme të trafikimit;	4
	k) anëtarë të komunitetit rom;	2
	l) anëtarë të komunitetit egjiptian;	2
	m) të miturit në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit;	1
	n) vajzat nëna;	5
	o) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, që janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjilacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr.22/2018;	1
1.4	***Kushtet ekonomike:***	**20**
	a) familje pa të ardhura mujore;	12
	b) familje me të ardhura shumë të ulëta: < 70% e të ardhurave mesatare;	5
	c) familje me të ardhura të ulëta: 70% - 100% e të ardhurave mesatare;	3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 9995/11 **Prot.** **Elbasan, më** 01.11. **2019**

VENDIM
Nr 165 **Date** 24/10/**2019**

Per dhënje titulli "Qytetar Nderi"

Këshilli Bashkiak, ne mbledhjen e tij te datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi materialin dhe kërkesën e sektorit te turizmit dhe trashëgimisë kulturore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit, për dhenjen e titullit "Qytetar Nderi" artistit Zeqir (Jorgo) Sulkuqi, me propozim të komisionit të vlerësimit të figurave, pranë Këshillit Bashkiak, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9 e 54 të tij,

Vendosi

1- Ti japë titullin "Qytetar Nderi", artistit të qytetit, z. Zeqir (Jorgo) Sulkuqi, me motivacionin:
"Si mjeshtër i madh dhe promovues i vlerave më të mira të qytetit, përmes tingujve të artë të violinës, në të gjithë trojet shqiptare dhe në nivel ndërkombëtar"
2- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Konc. E. Krraba
Konfirmoi F. Musai
Miratoi K. Krasniqi

Sek Kësh. Bashkiak

Klajdi Gripshi

Kryetari

Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

1536
01/11/2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10120/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 30.10.2019

VENDIM

Nr. 166 **datë** 24.10.2019

"Për plotësimin e pikës 3 dhe ndryshimin e pikës 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan""

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në Bashkinë Elbasan *"Për plotësimin e pikës 3 dhe ndryshimin e pikës 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan""*, mbështetur në nenin 70 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrative - territoriale të qeverisjes vendore në R.Sh." (i ndryshuar), në VKB përkatëse "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të strukturave komunitare të Bashkisë Elbasan", në VKB nr.140 datë 23.9.2019 si dhe në shkresën nr.1354/1 prot. datë 03.10.2019 të Prefektit të Qarkut Elbasan;

VENDOSI:

1) Të plotësojë pikën 3 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan", si më poshtë:

   "Të miratojë listën e të deleguarve të Këshillit Bashkiak, për çdo fshat, që do të marrin pjesë në komisionet e votimit për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive të fshatrave, sipas tabelës bashkëlidhur".

2) Të ndryshojë pikën 4 të VKB nr.140 datë 23.9.2019 "Për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan", si më poshtë:

   "Të organizojë zgjedhjet, për këto struktura komunitare, gjatë periudhës 01 - 30.11.2019".

3) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak dhe Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve në bashki.

4) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Çiftja

Konceptoi:
Drejtoria e Koord. të Nj.Adm. dhe Lagjeve: *D. Dafina* *E. Mezini* *Sh. Bullari*
Pranoi:
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Miratoi:
Drejtori i Përgjth. i ShO: *B. Çabiri*
Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

Lista e fshatrave, numrat e lagjeve, numrat e anëtareve të kryesisë për çdo fshat në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan, të deleguarit e K. Bashkiak Elbasan dhe grafiku i mbledhjeve.

Nr.	I. Njësia A	Nr.i fsh	Emrat e fshatrave	Nr. Lgj.	Nr. Ant.	I/e deleguari/a K. Bashkiak	Grafiku mbledh.
1	Bradashesh	1	Bradashesh	7	7	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
2		2	Balëz-Lart	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
3		3	Balëz-Poshtë	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	4/11/2019
4		4	Kusarth	5	5	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
5		5	Kozan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
6		6	Karakullak	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
7		7	Letan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	5/11/2019
8		8	Rrilë	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
9		9	Shtemaj	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
10		10	Ulën	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
11		11	Katund i Ri	7	7	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	6/11/2019
12		12	Fikas	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
13		13	Petresh	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
14		14	Shëmhill	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	7/11/2019
15		15	Shijon	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
16		16	Reçan	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
17		17	Gurabardh	3	3	Bukurosh Stafa, Ertjan Cabairi	8/11/2019
18	II. Njësia A Shushicë	1	Shushicë	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
19		2	Shelcan	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
20		3	Mlizë	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	4/11/2019
21		4	Hajdaran	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
22		5	Fush-Bull	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
23		6	Vasjan	3	3	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	5/11/2019
24		7	Polis i Vogël	5	5	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019
25		8	Polis Vale	3	3	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019
26		9	Vreshtaj	7	7	Lutfi Lala, Ymer Tola, Sokol Sinani	6/11/2019

27	III. Njësia A	1	Balldre	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	5/11/2019
28	Papër	2	Bizhutë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	5/11/2019
29		3	Broshkë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
30		4	Jatesh	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
31		5	Lugaj	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	6/11/2019
32		6	Murras	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
33		7	Pajun	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
34		8	Papër	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
35		9	Papër-Sallak	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	7/11/2019
36		10	Ullishtaj	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
37		11	Valas	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
38		12	Vidhas	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
39		13	Vidhas-Hasgjel	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Eva Bica	8/11/2019
40	IV. Njësia A	1	Shirgjan	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	6/11/2019
41	Shirgjan	2	Bathes	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	6/11/2019
42		3	Bujqës	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	7/11/2019
43		4	Jagodinë	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	7/11/2019
44		5	Kuqan	7	7	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
45		6	Kryezjart	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
46		7	Mjekës	5	5	Lutfi Lala, Sulejman Himci, Enerieta Ferra	8/11/2019
47	V. Njësia A	1	Labinot-Fushë	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	11/11/2019
48	Labinot-Fushë	2	Griqan i Sipërm	3	3	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	11/11/2019
49		3	Griqan i Poshtëm	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	12/11/2019
50		4	Godolesh	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	12/11/2019
51		5	Xibrakë	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	13/11/2019
52		6	Mengel	5	5	Bukurosh Stafa, Lisiena Metoshi, Rexhep Kaculi	13/11/2019
53	VI. Njësia A	1	Labinot-Mal	7	7	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	4/11/2019
54	Labinot-Mal	2	Gur i Zi	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	5/11/2019
55		3	Sericë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	7/11/2019
56		4	Lamollë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	7/11/2019

57		5	Benë	7	7	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	8/11/2019
58		6	Lugaxhi	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	8/11/2019
59		7	Qafë	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
60		8	Qerret	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
61		9	Shmil	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	11/11/2019
62		10	Dritas	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra, Rexhep Kaculi, Luan Rama	12/11/2019
63	VII. Njësia A	1	Gjergjan	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	8/11/2019
64	Gjergjan	2	Bujaras	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	8/11/2019
65		3	Gjonmë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	11/11/2019
66		4	Keshtjellë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	12/11/2019
67		5	Kodër Bujaras	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	13/11/2019
68		6	Muriqan	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	14/11/2019
69		7	Thanë	5	5	Lutfi Lala, Astrit Lici, Enerieta Ferra	14/11/2019
70	VIII. Njësia A	1	Gjinar	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	11/11/2019
71	Gjinar	2	Lleshan	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	11/11/2019
72		3	Valesh	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	12/11/2019
73		4	Pashtresh	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	12/11/2019
74		5	Derstilë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
75		6	Lukan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
76		7	Sterstan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	13/11/2019
77		8	Xibresh	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	14/11/2019
78		9	Maskarth	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	14/11/2019
79		10	Kaferr	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	15/11/2019
80		11	Pobrat	5	5	Lutfi Lala, Afrim Qosja, Sokol Sinani	15/11/2019
81	IX. Njësia A	1	Tregan	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	11/11/2019
82	Tregan	2	Blerimas	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	11/11/2019
83		3	Bizhdan	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	15/11/2019
84		4	Cikallesh	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	15/11/2019
85		5	Gurisht	3	3	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019
86		6	Kacivel	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019

87		7	Kyçyk	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	18/11/2019
88		8	Muçan	7	7	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
89		9	Shinavlash	7	7	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
90		10	Shilbater	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	19/11/2019
91		11	Trepsenisht	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	20/11/2019
92		12	Tudan	5	5	Lutfi Lala, Eva Bica, Shpetim Llapushi	20/11/2019
93	X. Njësia A	1	Branesh	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	11/11/2019
94	Funar	2	Bixëlle	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	11/11/2019
95		3	Prec e Sipërme	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	12/11/2019
96		4	Cerujë	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	13/11/2019
97		5	Korrë	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	13/11/2019
98		6	Mollagjesh	5	5	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	14/11/2019
99		7	Krrabë e Vogël	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	14/11/2019
100		8	Prec e Poshtme	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	15/11/2019
101		9	Stafaj	3	3	Bukurosh Stafa, Shefki Haxhiu, Marsela Likrama	15/11/2019
102	XI. Njësia A	1	Gracen	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	12/11/2019
103	Gracen	2	Plangaricë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	12/11/2019
104		3	Tërbaç	4	4	Bukurosh Stafa, Ali Korra	13/11/2019
105		4	Bodin	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	18/11/2019
106		5	Shingjin	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
107		6	Gjorm	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
108		7	Pajengë	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	20/11/2019
109		8	Mamel	5	5	Bukurosh Stafa, Ali Korra	21/11/2019
110		9	Dopaj	3	3	Bukurosh Stafa, Ali Korra	22/11/2019
111	XII. Njësia A	1	Zavalinë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	18/11/2019
112	Zavalinë	2	Seltë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	19/11/2019
113		3	Kamiçan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	20/11/2019
114		4	Jeronishtë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	21/11/2019
115		5	Nezhan	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	22/11/2019
116		6	Burishtë	3	3	Lutfi Lala, Afrim Qosja	22/11/2019

*	Shuma Totale	116	Fshatra	495	495		

Miratoi:
Drejtori D.K.Nj.A.L
Shefqet Bullari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.9952 Prot.

Elbasan më, 01.11.2019

VENDIM

Nr.149 Datë: 24.10.2019

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Thoma Naun Kavaja, banor i fshatit Seltë, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Thoma Naun Kavaja,** banor i fshatit Seltë, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Thoma Naun Kavaja,** e cila është në **1 110 549** (një milion e njëqind e dhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **2 221 098 x 50% = 1 110 549** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për familjen e **Z. Thoma Naun Kavaja.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Thoma Naun Kavaja** prej **1 060 549** (një milion e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës

së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

KRYETARI

Hektor Çiftja

1520
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.9953 **Prot.** **Elbasan më,**01.11.**2019**

V E N D I M

Nr.150 **Datë:**24.**10.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Anastas Jovan Dedja, banor i fshatit Nezhan, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Anastas Jovan Dedja,** banor i fshatit Nezhan, Njësia Administrative Zavalinë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Anastas Jovan Dedja,** e cila është në **1 053 478** (një milion e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **2 106 956 x 50% = 1 053 478** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për familjen e **Z. Anastas Jovan Dedja.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Anastas Jovan Dedja** prej **1 003 478** (një milion e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës

së ndihmës së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

1521
01.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9954 **Prot.** **Elbasan më,** 01.11.**2019**

VENDIM

Nr. 151 **Datë:** 24 **.10.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Gëzim Halil Lika, banor i fshatit Labinot Katund, Njësia Administrative Labinot Mal si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Shpëtim Sali Hidri,** e cila është në **1 422 906** (një milion katërqind e njëzet e dy mijë e nëntë qind e gjashtë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë, d.m.th. **2 845 813 x 50% = 1 422 906** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë**,** për familjen e **Z. Shpëtim Sali Hidri.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Shpëtim Sali Hidri** prej **1 372 906** (një milion tre qind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntë qind e gjashtë)lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme

financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Sulejmani
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Klajdi Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

Me Urdhër dhe me Porosi

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

Ana Muça

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10886 **Prot.** **Elbasan më,** 12.12.**2019**

V E N D I M

Nr. 174 **Datë:** 04 **.12.2019**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Ndriçim Hamit Kaca, banor i fshatit Bixëlle, Njësia Administrative Funar si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 04.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Ndriçim Hamit Kaca**, banor i fshatit Bixëlle, Njësia Administrative Funar si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Ndriçim Hamit Kaca,** e cila është në **962 487** (nëntë qind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë, d.m.th. **1 924 975 x 50% = 962 487** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë**,** për familjen e **Z. Ndriçim Hamit Kaca.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Ndriçim Hamit Kaca** prej **912 487** (nëntë qind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës së pjesshme

financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).

Konceptoi:
Specialist: A. Sulejmani
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Klajdi Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

Me Urdhër dhe me Porosi

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

Ana Muça

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10885 **Prot.** **Elbasan më,** 12.12.2019

V E N D I M

Nr. 178 **Datë:** 04 .12.2019

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Ramazan Osman Murati, banor i fshatit Godolesh, Njësia Administrative Labinot Fushë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 04.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Ramazan Osman Murati,** banor i fshatit Godolesh, Njësia Administrative Labinot Fushë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 162. datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Ramazan Osman Murati,** e cila është në **2 230 208** (dy milion e dyqind e tridhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga, d.m.th. **4 460 416 x 50% = 2 230 208** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës së pjesshme financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **50.000** (pesëdhjetëmijë) lekë, për familjen e **Z. Ramazan Osman Murati.**
4. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, akordimin e pjesës së mbetur të vlerës për shtetasin **Z. Ramazan Osman Murati** prej **2 230 208** (dy milion e dyqind e tridhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë, si diferencë e vlerës financiare të miratuar në pikën 2 (vlerën financiare të dëmshpërblimit) dhe vlerës së ndihmës

së pjesshme financiare sipas pikës 3 të këtij vendimi meqenëse Bashkia Elbasan nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

5. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 162 datë 24.12.2018.
6. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Sulejmani
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Klajdi Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

Me Urdhër dhe me Porosi

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

Ana Muça

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10961/1 **Prot.** **Elbasan, më** 12.12. **2019**

VENDIM

Nr. 179 **Datë** 04.12.2019

"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN PËR VITIN 2020"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2020"*, bazuar në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin e veterinarisë në Republiken e Shqiperisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9385, datë 04 05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative";
- Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/ bashkive";

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 09.03.2016 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 "Për tarifat në sektorin e Kullotave";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 04.01.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave në Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 "Përmetodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 09.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së";

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si dhe nivelin e gjobave për kundravajtjet, si mëposhtë vijon:

- **Tabela A.** Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë";
- **Tabela A/1.** Taksa mbi tokën bujqësore;
- **Tabela A /2.** Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike);
- **Tabela B.** Taksa e fjetjes në hotel;
- **Tabela C.** Taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- **Tabela C/1.** Taksë për objektet në proçes legalizimi;
- **Tabela C/2 .**Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve;
- **Tabela D.** Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- **Tabela E.** Taksa për vendosjen e tabelës;
- **Tabela F.** Tarifat Vendore;
- **Tabela F/1.**Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
- **Tabela F/2.** Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit;
- **Tabela G.** Tarifa për zënien e hapësirave publike;
- **Tabela H.** Tarifat vendore të transportit;
- **Tabela H/1.** Tarifat per liçensa/autorizime/çertifikata;
- **Tabela H/2.** Tarifë për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- **Tabela I.** Tarifat vendore për popullatën;
- **Tabela J.** Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve;
- **Tabela K.** Tarifat vendore të veterinarisë;
- **Tabela L.** Tarifa vendore të shërbimeve të institucioneve vartëse;
- **Tabela L/1.** Tarifat vendore mbi shërbimin e varrimit;
- **Tabela L/2.** Tarifat vendore për shfrytëzimin e truallit publik për tubacionet, kabllot telefonike, fibrën optike;
- **Tabela L/3.** Tarifat vendore për pyjet dhe kullotat;
- **Tabela L/4.** Tarifa për sektorin e bujqësisë;
- **Tabela L/5.** Tarifa për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje;

- **Tabela N.** Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

PAKETA FISKALE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE 2020

Tabela A

1. Tabela A - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë"

Vlera e taksës së ndërtesës do të përllogaritet sipas aneksit 1 dhe 2 të V.K.M nr. 132 "*Përmetodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*", e ndryshuar.

Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim

a. Të bëhet **ulje me 20%** e shkallës së taksës (**shkalla e taksës nga 0.05 % shkon në 0.04%**) për sipërfaqjet ndërtesë banesë në qytet (*Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 04 % x 50.300= 20.120 lekë).*

b. Të bëhet **ulje me 30%** të çmimit mesatar referues për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative **(çmimi nga 50,300 shkon në 35,210)** *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 35,210= 17.605 lekë).*

Për ndërtesat të cilat shërbejnë jo për banim

Aneksi 2

ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM

1. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi, shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqjes së banimit. Në këtë kategori do të përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe proçese të përziera prodhimi, tregtimi ose/edhe shërbime me pakicë. (Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 2 % x 75, 450 = 150,9 lekë).

1.a. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi/njësi ku nuk kryhet aktivitet ekonomik është 120.7[1] lekë/m^2 në vit.

2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit. (Shembull: Vlera për m^2= 1 m^2 x 0, 2 % x 35, 210 = 70.42 lekë)

[1] Të bëhet ulja me 20% e çmimit mesatar referues (75,450 -20%= 60,360. Vlera për m^2= 1m^2 x 0,2 % x 60,360 lekë = 120.7 lekë)

3. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit (Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 2 % x 15, 090 = 30.18 lekë).

4. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së banesave (Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 2 % x 25, 150 = 50.3 lekë).

5. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së banesave, me përjashtim të përpunimit ushqimor (Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 2 % x 15, 090 = 30.18 lekë).

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Për taksën e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", për të cilat nuk disponojmë vlerën e ndërtesës, do të përdoret vlerat referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*", të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative.

Për sa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarimin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë aplikohet vlerësimi me prezumim prej 100 m^2 për biznesin e vogël dhe 500 m^2 për kategoritë e tjera të biznesit. Pas dorëzimit të dokumentacionit administrata tatimore duhet të bëjë verifikimet përkatëse.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.

<u>1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është:</u>

1. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, për taksën e biznesit të madh dhe të vogël (pagesa kryhet nëpërmjet çdo banke të nivelit të dytë postës, Unioni Financiar Tiranë).

2. Për subjektet familje të cilat disponojnë kontratë me shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." pagesa e taksës bëhet çdo muaj si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga kjo ndërmarrje, në cilësinë e agjentit tatimor (taksat e popullatës për vitin 2019 dhe detyrimet e prapambetura për klientët e faturuar).

3. Për subjektet familje të cilat nuk disponojnë kontratë furnizimi me ujë me shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." afati i pagesës është data 31.10.2020.

Administratorët në Njësitë Administrative dhe Lagjet për ato zona (persona) ku nuk ka kontratë me ujësjellësin.

4. Lagjet dhe Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." për debitorët familjarë dhe Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e taksave vendore.

5. Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data 31.07.2020.

6. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, por jo më shumë se 12 muaj.

2.Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

1. Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me V.K.M, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të bashkive;
5. Pasuritë e paluajtshme – ndërtesa, pronë e subjekteve juridikë ose fizikë, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. Strukturat akomoduese "Hotel / Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
8. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore;
11. Ndërtesat e invalidëve të punës kur janë kryefamiljarë, pas paraqitjes së dëshmisë së invaliditetit, në ato raste kur familja përbëhet vetëm nga invalidi, ose dhe nga persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë ose pensionistë;
12. Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me 5 yje, "status special", sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit.
13. Në qoftë se ndërtesa dëmtohet nga forca madhore, përjashtohet nga taksa e ndërtesës në masën 75% të vlerës.
14. Kur ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet për periudhën e të qenit pronar.

Tabela A/1 - Taksa mbi tokën bujqësore:

	Kategoritë e tokës bujqësore	lekë /ha/vit.
1.	Klasa I	4200
2.	Klasa II	3500
3.	Klasa III	2800
4.	Klasa IV	2300
5.	Klasa V	1900
6.	Klasa VI	1600
7.	Klasa VII	1400

1. Afati për pagesën e taksës së tokës bujqësore është data **31.10. 2020.**
2. Strukturat e caktuara për mbledhjen e kësaj takse janë:
   a. Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
   b. Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore.

Shënime:

1. Përjashtohen nga taksimi mbi tokën bujqësore sipërfaqjet e mbjellura me kulturat dru frutor dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes.

2. Kur toka bujqësore dëmtohet nga fatkeqësi natyrore i zbritet 75 % e vlerës së taksës, për sipërfaqjen e dëmtuar, nga momenti i dëmtmit.

Tabela – A /2 Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike)

	Kategoritë dhe nën/kategoritë	lekë/m^2/vit
1.	Për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik	0.42
2.	Për qëllime biznesi	18
3.	Për sipërfaqje të gjelbëruara nga bizneset në territorin e tyre	12.6

1. Trualli është pasuria e paluajtshme e emëtuar e tillë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
2. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqjes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.
3. Niveli i taksës caktohet në *lekë për metër katror*. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për të gjitha kategoritë e trullit që nuk shërbejnë për aktivitet ekonomik do të aplikohet taksa sipas pikës 1 të kësaj tabele.
5. Struktura e caktuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
6.Afati për pagesën e taksës së truallit për kategorinë 1 në Njësitë Administrative është data **31.10 2020.**
7. Afati për pagesën e kësaj takse për kategoritë 2 dhe 3 është data **31.07 2020.**
8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj, mbi detyrimin.

Tabela B – Taksa e fjetjes në hotel

Nr.	**Baza e taksës**	**Niveli** **lekë/netë fjetje/person**
1	Hotel me 4 ose 5 yje.	175
2	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese.	70

1. Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
4.Subjektet janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentacionin justifikues për muajin paraardhës.
5. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.
6. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

7. Afati për pagesën e kësaj takse është data 5 e muajit pasardhës.
8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj mbi detyrimin si dhe ndërprietet aktiviteti nga strukturat përkatëse.

Tabela C – Taksa e ndikimit në infrastrukturë

	Emërtimi	Niveli i taksës
a.	Strukturë banimi: 1. ndërtime për banim e shërbim apo njësi tregtimi.	4% e çmimit të shitjes për m^2
	Strukturë banimi: 2. për ndërtime për banim e shërbime nga investitorë të tjerë për qëllime jo fitimi.	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
b.	Ndërtime të karakterit, turizëm, industrial, bujqësor, ndërtime individuale për qëllime të përdorimit vetjak të ndërtuara nga vetë individët apo me sipërmarrës.	3 % e preventivit real të investimit, më çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
c.	Strukturë për qëllime publike, përjashtohen investimet e Bashkisë Elbasan.	2 % të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
ç.	Rehabilitim rrugësh, ujësjellësash, kanalizimesh, përjashtuar Bashkinë Elbasan.	2 % e vlerës së investimit sipas të preventivit me çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
e.	Struktura me funksion privat (prodhime, tregtimi e shërbimi).	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit të Banesave në fuqi.
f.	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1% të vlerës të preventivit në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
g.	Për ndërtesat në proçes legalizimi.	0.5% e vlerës së investimit në bazë të çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
h.	Për ndryshim funksioni.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
i.	Rikonstruksione e struktura të ndryshme.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.

j.	Për individët që trajtohen nga emergjenca civile për rrëshqitje të tokës ose nga fatkeqësi të tjera natyrore.	0%
k.	Objekte qe zhvillojne veprimtari pritëse të çertifikuar si agro-turizem sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.	0 %
l.	Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zona malore.	0% të vlerës së investimit
ll.	Personat që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 21 shtator 2019, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë."	0%

1. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

2. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".

3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:

a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit;

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0, 1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi;

d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 për qind e vlerës së investimit, Këshilli bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

4. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/1– Taksë për objektet në proçes legalizimi

	Kategoritë dhe nënkategoritë për më tepër se një (1) objekt në proçes legalizimi	**Përqindja e ndikimit në infrastrukturë**
1.	Struktura banimi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
2.	Struktura me funksione shërbimi dhe njësi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
3.	Struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike).	2% e ndikimit në infrastrukturë

1. Për ndërtesat të cilat janë në proçes legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
2. Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/2 – Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve

Garancia financiare për heqjen e inerteve	**% e vlerës së strukturës së objektit**
Garancia financiare për heqjen e inerteve.	4% e vlerës së investimit sipas strukturës së objektit

1. Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan ose kontratë sigurimi, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit.

2. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela D- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Niveli tregues i taksës (Qyteti Elbasan) lekë/m^2	Njesitë Administrative lekë/m^2
1.	Ndërtesa banimi.	300	100
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime.	700	300
3.	Ndërtesa të tjera.	500	200

1.Kjo taksë vendoset për rastet e transferimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

2.Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

3.Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%.

4.Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

5.Pagesa e taksës së çdo ndërtimi fillon nga momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, si detyrim i ndërtuesit. Me paraqitjen e kontratave të shitjes prej tij, detyrimi i lind subjektit blerës të sipërfaqjes së ndërtimit.

6.Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit të Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela E – Taksa për vendosjen e tabelës

	Kategoritë	Njësia matëse	Niveli i taksës Qyteti	Niveli i taksës Njësitë administrative
I	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit).**			

a	**deri në 2 m²**	lekë/ m² /vit	0	0
b	**mbi 2 m² deri 10 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m² /vit	10,000	10,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m² /vit	15,000	15,000
	elektronike.	lekë/ m² /vit	20,000	20,000
c	**mbi 10 m² deri 20 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m² /vit	8,500	8,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m² /vit	12,750	12,750
	elektronike.	lekë/ m²/vit	17,000	17,000
ç	**mbi 20 m² deri 40 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m² /vit	5,500	5,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m² /vit	8,250	8,250
	elektronike.	lekë/ m²/vit	11,000	11,000
d	**mbi 40 m²**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m² /vit	4,000	4,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m² /vit	6,000	6,000
	elektronike.	lekë/ m² /vit	8,000	8,000
II	**Taksë tabele për qëllime identifikimi jashtë territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.**			
	Tabela identifikuese.	lekë/ m² /vit	120	120
III	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²**			
	e thjeshtë(me/pa ndriçim).	lekë/ m² /vit	22,500	22,500
	elektronike.	lekë/ m² /vit	45,000	45,000
IV	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.**			

	të të gjitha llojeve dhe përmasave.	lekë/ m^2 /ditë	1,000	1,000

1. Detyrimi për taksën e vendosjes së tabelës referuar kategorive I dhe II është vjetor.
2. Për "kategoritë I dhe II" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31.07.2020 të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 31.07.2020, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga momenti i deklarimit.
3. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
4. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
5. Për "kategorinë III" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31.07.2020 të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan.
6. Për "kategorinë IV" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan dhe paguhet menjëherë.

7. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
8. Tabelat kategorizohen në:

a.Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

b.Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

c.Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

9. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
10. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.
11. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
12. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.
13. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga taksa për vendosjen e tabelës.
14. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

F. Tarifat Vendore

Tabela F/1-- Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Nr.	Subjekti	Niveli i Tarifës lekë/vit
1.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet prodhim metalesh nga skrapi ose minerali, shkrirje e substancave minerale, përpunimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i çimentos.	3,360,000
2.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, industria e	448,000

	peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjesimi i mbetjeve metalike, prodhim polisteroii, apo aktivitete të tjera, që ndikojnë në mjedis.	
3.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrire guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, shfrytëzim të lumenjve, që ndikojnë në mjedis.	336,000
4.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: industria e gomës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i polisterolit, industri të tjera, që ndikojnë në mjedis.	224,000
5.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis.	25,000
6.	Subjektet persona fizik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis.	8,000

1. Lista me subjektet vendoset në dispozion nga Inspektoriati i Mjedisit para datës 15.02.2020 dhe rast pas rasti për subjktet e reja.
2. Afati i pagesës së detyrimit është data 31.07.2020.

Tabela F/2 Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje, dhe zgjatjeve të orarit

Nr.	Lloji i tarifës	Njësia	Niveli i tarifës
1.	**Tarifë pastrimi:**		
a	Familje.	lekë / vit	1,100
b	Biznesi i vogël (pa TVSH).	lekë / vit	8,000
c	Biznesi i vogël (me TVSH).	lekë / vit	15,000

ç	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	15,000
d	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash mbi 3.5 ton.	lekë / vit	20,000
dh	Restorant - biznes i vogël.	lekë / vit	20,000
e	Restorant - biznes i madh.	lekë / vit	40,000
ë	Biznesi i madh (tregti e shërbim).	lekë / vit	40,000
f	Biznesi i madh (njësi prodhimi).	lekë / vit	55,000
g	Firmë ndërtimi (pas lejes së përdorimit).	lekë / vit	30,000
gj	Firmë ndërtimi.	lekë / vit	60,000
h	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	60,000
i	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000
j	Institucione shtetërore.	lekë / vit	30,000
k	OJF	lekë / vit	3,000
2.	**Tarifa e gjelbërimit:**		
a	Familje në qytet.	lekë / vit	500
b	Biznesi i vogël (pa TVSH)/ OJF	lekë / vit	1,000
c	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	1,500
ç	Biznesi i madh/Institucione.	lekë / vit	5,000
d	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	25,000
dh	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000
3.	**Tarifa e ndriçimit:**		
a	Familje	lekë / vit	1,200
b	Biznesi i vogël, taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	1,200
c	Biznesi i madh	lekë / vit	6,000

ç	Institucione.	lekë / vit	5,000
d	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	25,000
dh	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000
e	OJF	lekë / vit	700
4.	**Tarifë shërbimi në tregje:**		
a	Bagëti e imët në tregje publike.	lekë / krerë	50
b	Bagëti e trashë në tregje publike.	lekë / krerë	100
c	Fruta - perime në merkato dhe në tregjet e Njësive Administrative.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	100
ç	Fruta - perime në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	200
d	Artikuj industrialë në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	200
5.	**Tarifë për zgjatje orari:**		
a	"Non Stop" për një natë.	lekë /ditë	10,000
b	Deri në orën 24^{00}.	lekë / vit	20,000
c	"Non Stop", karburante, lokale dasmash, etj.	lekë / vit	35,000
6.	**Tarifë për vërtetim**	lekë/vërtetim	100
7.	**Tarifë për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative**	lekë / vit	500

1. 1.Familjet me ndihmë ekonomike përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
2. Personat me aftësi të kufizuar, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhor në familje, me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes, përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
3. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
4. Subjektet që tregtojnë tek tregu industrial (lagja "Shënkoll"), tregu i fruta perime (Namazjaja dhe markata tek ish Zyra e Punës), tek fusha e vjetër e sportit, lagja "Luigj Gurakuqi" (tek rruga "Mustafa Sahatçi") trajtohen si ambulant.

5. Subjektet që tregtojnë në tregjet e Njësive Administrative Tregan, Gjinar, Funar, Shmil, Zavalinë, Papër, si dhe në tregun e bagëtive në Mengël, i nënshtrohen tarifës së shërbimit në tregje.
6. Ambulantët menaxhohen nga Sektori i Tregut dhe në fillim të vitit lidhen të gjithë kontratat. Në vazhdimësi, ndryshimet në kontrata depozitohen në Drejtorinë e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, jo më vonë se 5 ditë nga momenti i ndryshimit të kontratës.
7. Tarifat e ambulantëve në tregjet e miratuara bëhen 0 lekë (tarifa e pastimit, e ndriçimit, e gjelbërimit)
8. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është për familjarët U.K.E., Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Lagjet dhe Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.
9. Për pikën 4/c (lokale dasmash) lista vendoset në dispozion nga Inspektoriati i Mjedisit para datës 31.01.2020 dhe rast pas rasti për subjktet e reja.
10. Afati për pagesën e tarifave të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 5 germat b dhe c, dhe 7 është data **31.07.2020.** Për tarifat e mbetura pagesa ekzekutohet në momentin e marrjes së aprovimit.
11. Për mos pagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj (deri në 12 muaj). Përjashtohen nga gjoba tarifat e pikës 4, 5 dhe 7.

Tabela G. Tarifa për zënien e hapësirave publike

Nr.	Lloji i Tarifës	Niveli tregues Bashkia Elbasan Njësia	Njesitë e tjera Administrative Njësia
1.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës A.	500 lekë m^2/ muaj	50 lekë m^2/ muaj
2.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës B.	300 lekë m^2/ muaj	50 lekë m^2/ muaj
3.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës C.	150 lekë m^2/ muaj	50 lekë m^2/ muaj
3.	Për personat dhe shoqëritë që shesin automjete në hapësirë publike (1 automjet x 5m^2 x 100 lekë).	500 lekë/automjet/ditë	500 lekë/automjet/ditë
4.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt mbi 4 kate.	150.000 lekë/vit	150.000 lekë/vit

5.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt nën 4 kate.	100.000 lekë/vit	100.000 lekë/vit
6	Tarifë kantieri/ ndërtim çatie, muri rrethues apo shkallë	5,000 lekë/ vit	5,000 lekë/ vit
7.	Tarifë për instalimin e "strukturave për nevoja të çastit dhe të përkohshme"	100 lekë/m^2/muaj	50 lekë/m^2/muaj

1."Zona A", zona "B" dhe zona "C", për efekt tatimor janë zonat sipas hartës bashkëngjitur këtij projektvendimi. Kjo tarifë llogaritet duke shumëzuar sipërfaqjen e zënë me nivelin tregues të tarifës dhe numrin e muajve për të cilët merret në përdorim.

Etleva Kënuti, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Operacionale
Qemal Tusha, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës
Eglantina Shabanaj, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore
Aida Talli, Koordinator për të Drejtën e Informimit

Grupi i Punës, IDM:

Dr. Rovena Sulstarova, Eksperte për Çështje të Integritetit
Dr. Elsa Dobjani, Eksperte Ligjore
Erald Bezhani, Ekspert për Menaxhimin e Riskut

STAR II PROJECT

Institute for Democracy and Mediation
IDM

Ky dokument është hartuar në kuadër të aktivitetit "Forcimi i etikës dhe integritetit në Qeverisjen Vendore" në kuadër të projektit STAR II – Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të Grupit të Punës dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Suedi Sverige
AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE
UNDP

Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Forcimi dhe përmirësimi i integritetit është aktualisht një nga prioritetet më të rëndësishme strategjike për qeverisjen vendore të qytetit të Elbasanit. Ne në Bashkinë e Elbasanit integritetin e çmojmë si një dimension jetik të qeverisjes së mirë, forcimi i të cilit do të rrisë besimin publik dhe do të kontribuojë në ndërtimin e një demokracie të qëndrueshme vendore.

Baza e këtij qëllimi është shtruar me miratimin e Planit të Integritetit, një dokument gjithëpërfshirës, i cili përmban një paketë masash rregullatore, administrative dhe politike për integritetin, etikën, transparencën dhe rritjen e llogaridhënies publike të bashkisë. Integriteti është i domosdoshëm për përmbushjen e misionit tonë si institucion vendor në funksion të komunitetit dhe shërbimeve publike efikase dhe cilësore. Ndaj, nëpërmjet miratimit të këtij Plani Integriteti, Bashkia po demonstron angazhimin e saj institucional për përmirësimin dhe forcimin e integritetit në ushtrimin e përgjegjësive të veta si një qeveri llogaridhënëse dhe të veprojë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe rregulloret në fuqi. Po ashtu, bashkia përkushtohet në ndërmarrjen e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike në bashki duke përmirësuar klimën e biznesit dhe standardet e jetesës së komunitetit të Bashkisë Elbasan.

Ky plan integriteti paraqet një nismë të Bashkisë Elbasan për dhënien e informacionit në lidhje me gjendjen aktuale të integritetit të bashkisë, vendosjen e objektivave strategjikë, të nënobjektivave dhe të masave përkatëse për të forcuar dhe përmirësuar kuadrin e brendshëm rregullator dhe politik të bashkisë për integritetin. Ne besojmë se ky plan do të jetë gur themeli për një sistem funksional të menaxhimit të integritetit në bashkinë tonë. Si një instrument për parandalimin e korrupsionit, ky plan do të kontribuojë njëherazi edhe në forcimin e rezistencës së institucionit ndaj risqeve që i kanosen integritetit dhe që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të përgjegjësive tona. Prandaj, jemi të përkushtuar jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara në këtë Plan Integriteti, por edhe të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për ta integruar procesin e vlerësimit të riskut të integritetit si kulturë pune në Bashkinë Elbasan.

Ne, punonjësit e Bashkisë Elbasan, unë si Kryetar i Bashkisë dhe përfaqësues i këtij institucioni, zotohemi të demonstrojmë integritet dhe të mos bëjmë asnjë kompromis në mbështetje të standardeve më të larta të qeverisjes demokratike, efektive, efikase, transparente dhe sa më afër qytetarëve tanë.

Kryetari i Bashkisë Elbasan

(GLEDIAN LLATJA)

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE 5

1. PLANI PËR INTEGRITET 6

1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit 6

1.2 Fazat e Planit të Integritetit 7

1.3 Qasja metodologjike 8

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, SPECIFIKË DHE MASAT PËRKATËSE 10

3. PLANI I VEPRIMIT 20

3.1 Fusha e Menaxhimit Financiar 21

3.2 Fusha e Burimeve Njerëzore 26

3.3 Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit 34

3.4 Fusha e Shërbimeve Publike 37

3.5 Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave 39

3.6 Fusha e Planifikimit të Territorit 42

3.7 Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik 44

LISTA E SHKURTESAVE

AB	Auditi i Brendshëm
DABNJ	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
KB	Këshilli Bashkiak
KQTBP	Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara
MVRINJVV	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
PT	Plani i Transparencës
PI	Plani i Integritetit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. PLANI PËR INTEGRITET

Bashkia Elbasan ka hartuar Planin Strategjik Kundër Korrupsionit[1] për periudhën 2017-2019. Në lidhje me këtë plan nuk rezulton të jetë hartuar ndonjë raport monitorimi për zbatimin e aktiviteteve të synuara. Hartimi i një Plani Integriteti për Bashkinë Elbasan është një proces që zhvillohet për herë të parë. Plani i Integritetit (PI) është një dokument strategjik dhe një instrument parandalues për forcimin e integritetit të bashkisë. Ai është një komponent shumë i rëndësishëm i proceseve të përgjithshme planifikuese të bashkisë, i lidhur ngushtë me planin strategjik të bashkisë. Gjithashtu, plani është një dokument pune, ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe për të arritur objektivat strategjikë dhe specifikë për bashkinë. Ai është rezultat i një procesi vlerësimi të riskut të integritetit të proceseve dhe nënproceseve të punës së bashkisë sipas fushave të funksionit të saj.

PI është një instrument që rrjedh nga Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Anti-Korrupsion (2018-2020) miratuar me VKM Nr. 241/2018, përkatësisht Objektivi A.9 që ka të bëjë me miratimin e politikave anti-korrupsion në nivel vendor. Në këtë kuadër institucioni i bashkisë Elbasan është në listën e institucioneve publike pararendëse që kanë zhvilluar dhe miratuar një plan integriteti.

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Elbasan dhe konkretisht në:

- Ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në bashki që synon sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet e integritetit;
- Zhvillimin e burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të integritetit, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të integritetit;
- Fuqizimin dhe mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në bashki;
- Planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit në bashki me fokus në fushat e funksionit të bashkisë me risk më të lartë të cenimit të integritetit duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale të bashkisë; Forcimi i rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit përmes përmirësimit të kontrolleve operacionale në fushat e funksionit të bashkisë me risk korrupsioni.

Plani i Integritetit është pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme të planifikimit të bashkisë dhe konkretisht në planin strategjik për zhvillimin institucional. Me zbatimin e PI-së bashkia angazhohet në sigurimin e efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe etikës në institucion.

1.1. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

[1] Miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 31, datë 20.03.2017, "Për miratimin e Planit Strategjik Anti-korrupsion 2017-2019 për Bashkinë Elbasan"

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në bashkinë Elbasan ka përfshirë vlerësimin e risqeve të integritetit në të gjitha proceset e punës në bashki sipas shtatë fushave të funksionit të bashkisë, të identifikuara nga legjislacioni në fuqi për vetëqeverisjen vendore:

i) menaxhimi financiar (buxheti - të ardhurat dhe shpenzimet);
ii) menaxhimi i burimeve njerëzore;
iii) kontrolli, auditi dhe mekanizmat kundër korrupsionit;
iv) shërbimet publike;
v) administrimi dhe menaxhimi i pronave;
vi) planifikimi, administrimi dhe zhvillimi i territorit;
vii) arkivimi, ruajtja dhe administrimi i dokumenteve si dhe të informacionit dhe të dokumenteve elektronike.

Proceset përkatëse të ndara sipas fushave të funksioneve të bashkisë janë referuar në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

PI është ndërtuar mbi bazën e rezultateve të një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të riskut të tij në bashkinë Elbasan, i cili ka filluar në gusht 2019. Grupi i punës i ngritur në bashki, në bashkëpunim me administratën e Bashkisë Elbasan, është përfshirë në vlerësimin e risqeve të këtyre fushave duke shqyrtuar edhe ndikimin e tyre në integritetin e bashkisë dhe mundësinë e shfaqjes së tyre gjatë proceseve të punës në këtë institucion. Po ashtu, administrata ka qenë pjesë e hartimit të masave konkrete sipas risqeve të vlerësuara për të përmirësuar integritetin e bashkisë.

1.2. Fazat e Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Elbasan ka kaluar në disa faza kryesore. Në fazën e parë Kryetari i Bashkisë ngriti grupin e punës për hartimin e këtij plani, grup që kryesohej nga një koordinator, që është caktuar një zëvendëskryetar i bashkisë. Koordinatori siguroi mbarëvajtjen e procesit si dhe bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të realizuara në kuadër të procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në bashki. Anëtarët e grupit të punës janë drejtorë të drejtorive të ndryshme të bashkisë që mbulojnë fushat kryesore funksionale të saj. Grupi i punës me asistencën e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM),[2] mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore shqyrtoi dokumentet strategjike të bashkisë dhe kuadrin e brendshëm rregullator, të tilla si Plani Strategjik Kundër Korrupsionit 2017-2019, Plani Strategjik i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Elbasan, rregulloren e brendshme të bashkisë, rregulloren e organizmit dhe funksionimit të këshillit bashkiak, rregulloren e organizimit të drejtorive të ndryshme në bashki, manuale, etj.

Në fazën e dytë, grupi i punës, me asistencën teknike të IDM-së, analizoi raportet e ndryshme të bashkisë mbi veprimtarinë e saj si, p.sh., raporte të auditit, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, raporte monitorimi për veprimtarinë e bashkisë, etj. Gjithashtu, në këtë fazë u administrua edhe pyetësori i vetëvlerësimit me stafin e bashkisë për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e

[2] Grupi i punës së integritetit në Bashkinë Elbasan është asistuar nga ekspertët e IDM-së, në kuadër të projektit "Forcimi i etikës dhe integritetit në Qeverisjen Vendore" në kuadër të projektit STAR II – Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP.

sistemit të menaxhimit të integritetit në Bashkinë Elbasan.

Në fazën e tretë, grupi i punës realizoi shtatë (7) diskutime në fokus grupe me stafin e drejtorive të ndryshme të bashkisë për të vlerësuar risqet e integritetit për të gjitha proceset e punës sipas fushave të funksionit të Bashkisë Elbasan. Risqet e identifikuara u vlerësuan sipas mundësisë së ndodhjes dhe pasojave që ato sjellin në integritetin e bashkisë. Grupi i punës në këtë fazë vijoi me vlerësimin e masave ekzistuese të kontrollit për risqet e vlerësuara dhe propozimin për marrjen e masave të reja për trajtimin e tyre.

Ky proces pati një qasje gjithëpërfshirëse me angazhimin dhe mbështetjen e të gjitha drejtorive dhe strukturave të bashkisë. PI iu vu në dispozicion të gjithë stafit administrativ të Bashkisë Elbasan, Këshillit Bashkiak dhe aktorëve të tjera të bashkisë.

Plani i Veprimit, i cili përmban masat për trajtimin e risqeve të vlerësuara, do të shoqërohet me një buxhet paraprak për zbatimin e tij, i cili do të jetë pjesë e zërave të buxhetit vjetor.

1.3. Qasja metodologjike

Grupi i Punës së integritetit në Bashkinë Elbasan ka punuar sipas metodologjisë së përshkruar në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore[3]. Procesi kombinon dy qasjet tradicionale studimore: qasjen sasiore nëpërmjet sondazhit me punonjës të bashkisë dhe qasjen cilësore nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor dhe rregullator të bashkisë, të dokumenteve dhe raporteve ekzistuese; dhe fokus grupe me punonjës të ndryshëm të drejtorive të bashkisë që mbulojnë fushat e funksionit të bashkisë.

Gjatë hartimit të këtij plani, grupi i punës në bashki zbatoi 2 (dy) metoda kryesore për analizimin dhe vlerësimin e riskut të integritetit në kuadër të Bashkisë Elbasan. Metoda e parë kishte të bënte me plotësimin e pyetësorëve në mënyrë anonime nga ana e stafit të bashkisë. (Për përmbajtjen e pyetësorit referojuni dokumentit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore). Pyetësorët shërbejnë si një mekanizëm kontrolli për zvogëlimin e devijimit të riskut të integritetit. Ato janë mjet i rëndësishëm për mbledhjen e perceptimeve dhe për të siguruar të dhëna me vlerë dhe të besueshme. Gjithashtu, ky instrument i mundëson stafit të bashkisë që të marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjithë procesin e menaxhimit të riskut të integritetit. Anketimi u administrua në mënyrë elektronike. Ky anketim u bazua në kampionimin dhe raportimin vullnetar të popullatës së studiuar. Përzgjedhja e individëve për të plotësuar anketimin u bazua në vullnetin e tyre për t'u përfshirë dhe ishte tërësisht rastësore. Në sondazh morën pjesë 86 punonjës të bashkisë nga 409 punonjës që është numri total i stafit të Bashkisë Elbasan. Shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 2% (me nivel besueshmërie statistikore 95%). Demografia e kampionit kishte në përbërje shpërndarjen gjinore, moshore dhe të vjetërsisë në profesion të popullatës së synuar.

[3] Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (MVRINJVV) është hartuar nga IDM për Projektin "Forcimi i etikës dhe integritetit në Qeverisjen Vendore" në kuadër të projektit STAR II – Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP. Ky dokument është konsultuar me 61 bashkitë e vendit, institucionet publike që kanë në funksionet e tyre çështje të integritetit dhe është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, Koordinatori Kombëtar për Anti-korrupsionin.

Metoda e dytë e përdorur nga grupi i punës, sipas MVRI-së, ishte edhe realizimi i diskutimeve në fokus grupe me stafin administrativ të drejtorive të ndryshme të bashkisë, përfshirë këtu edhe drejtuesit e proceseve të punës që shfaqnin risk të lartë. (U realizuan 7 fokus grupe me punonjës të bashkisë që i përkasin drejtorive të ndryshme të bashkisë sipas fushave të identifikuara në MVRI). Qëllimi i përdorimit të kësaj metode është sigurimi i të dhënave shtesë në lidhje me masat ekzistuese në bashki për përmirësimin e integritetit dhe si dhe marrja e sugjerimeve për hartimin e masave të reja.

Ky plan integriteti është rrjedhojë e këtij procesi vetëvlerësimi në Bashkinë Elbasan dhe zbatimi i tij përfshin periudhën 2020-2023. Bashkia Elbasan do të vijojë me monitorimin e këtij plani dhe raportimin e tij sipas parashikimeve në MVRI-së, do të rishikohet rregullisht dhe do të përditësohet në përputhje me zhvillimet përkatëse normative, institucionale e procedurale të bashki.

PI ka në përmbajtje të tij:

- **Deklaratën e Integritetit Institucional**, e cila parashtron angazhimin dhe përkushtimin institucional për forcimin e integritetit në bashki. Bashkia merr përsipër që proces i vlerësimit të riskut të integritetit të jetë proces i vazhdueshëm në bashki, për të integruar vlerësimin e riskut të integritetit në kulturën e punës së bashkisë, në mënyrë të qëndrueshme.
- **Planin e Integritetit**, i cili përcakton qëllimin, fazat e procesit të hartimit të planit dhe metodologjinë e përdorur për realizimin e procesit në bashki.
- **Objektivat strategjike, objektivat specifikë dhe masat** për arritjen e tyre. Objektivat strategjikë janë objektiva të identifikuara sipas procesit të vlerësimit të risqeve të integritetit dhe në përputhje me planin strategjik të bashkisë. Çdo objektiv strategjik detajohet në nënobjektiva, të cilat përfshijnë fushat e bashkisë që kanë për qëllim forcimin dhe përmirësimin e integritetit të bashkisë, nisur nga vlerësimi i situatës aktuale në bashki (kuadri rregullator dhe praktika institucionale). Plani synon formalizmin e objektivave dhe masave për të forcuar dhe përmirësuar politikat dhe praktikat anti-korrupsion dhe rritjen rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit dhe korrupsionit në bashki.
- **Planin e veprimit** përmban masat që duhet të ndërmerren për të realizuar objektivat strategjike dhe ato specifikë. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit (sipas një procesi të vlerësimit të risqeve për procese të punës në bashki), afati kohor dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, SPECIFIKË DHE MASAT PËRKATËSE

Bashkia Elbasan ka në vizion të saj funksionimin e një sistemi efikas të menaxhimit të integritetit nëpërmjet integrimit të procesit të vlerësimit të integritetit në kulturën e punës për të menaxhuar sa më mirë risqet e integritetit dhe korrupsionit. Bashkia Elbasan e cilëson forcimin e integritetit si një dimension jetik të qeverisjes vendore, në funksion të një qeverisje demokratike, transparente, efektive dhe efikase. Nëpërmjet përcaktimit të objektivave strategjikë për forcimin e integritetit në bashki dhe të masave të parashikuara për arritjen e tyre, në këtë Plan Integriteti Bashkia Elbasan po bën përpjekje për të instaluar një sistem funksional të menaxhimit të integritetit, i cili do të forconte rezistencën institucionale të bashkisë ndaj korrupsionin dhe shkeljeve të integritetit. Këto objektiva synojmë t'i kemi komponentë kyç në strategjinë institucionale të bashkisë dhe kanë rëndësi themelore për procesin e planifikimit strategjik. Objektivat strategjikë në forcimin dhe përmirësimin e integritetit në Bashkinë Elbasan janë:

Më poshtë jepen objektivat strategjikë, të zbërthyer në objektiva specifikë (nën-objektiva), të shoqëruara me masat përkatëse për arritjen e tyre.

1) **Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në bashki përmes fuqizimit të një administrate vendore profesionale dhe efikase.**
   Përmirësimi i kornizës politike dhe institucionale për të instaluar një sistem funksional të menaxhimit të riskut të integritetit; përmirësimi i kuadrit të brendshëm politik dhe rregullator në lidhje me punësimin dhe ngritjen në karrierë për punonjësit e bashkisë; zhvillimi profesional i burimeve njerëzore në bashki për të ndërmarrë dhe zbatuar reforma pro-integritet në bashki.

2) **Përmirësimi i llogaridhënies dhe rritja e transparencës së bashkisë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm vendor si dhe për të forcuar integritetin e institucionit.**
   Përmirësimi dhe zbatimi i instrumenteve të transparencës dhe llogaridhënies publike në bashki për të siguruar rritjen e aksesit dhe konsultimit publik të strategjive vendore, proceseve vendimmarrëse, planeve të zbatimit dhe monitorimit të proceseve.

3) **Forcimi dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm në bashki për fushat operative që janë më të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit.**
   Përmirësimi i praktikave të menaxhimit të riskut të integritetit përmes vendosjes dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit operativ në fusha të veçanta me risk të lartë.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

- **Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në bashki përmes fuqizimit të një administrate vendore profesionale dhe efikase.**

Objektivat specifikë:

1.1 Miratimi dhe zbatimi i një Kodi Sjelljeje për administratën e bashkisë dhe për anëtarët e Këshillit Bashkiak.

Vlerësimi i situatës: Bashkia nuk ka të miratuar një Kod Sjelljeje, i cili të parashikojë standardet e sjelljes së mirë dhe etike si për punonjësit e administratës ashtu edhe për anëtarët e Këshillit Bashkiak. Këta të fundit janë vendimmarrësit më të rëndësishme të bashkisë dhe në vendimmarrjen e tyre përfshihen çështje të rëndësishme dhe prioritare të riskut të integritetit. Për këtë arsye, parashikimi i këtyre standardeve të sjelljes edhe për anëtarët e Këshillit Bashkiak në kornizën rregullatore të bashkisë është shumë i rëndësishëm për konsolidimin e një sistemi funksional të integritetit. Nga ana tjetër, punonjësit e administratës gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre mund të kenë raste ku mund t'u kërkohet të marrin vendime për të cilat duhet të veprojnë me përgjegjshmëri të plotë. Në këtë prizëm, nuk konstatohen mekanizma monitorues lidhur me respektimin e normave të sjelljes së punonjësve apo këshilltarëve bashkiakë apo për raportimin e dilemave që lidhen me etikën apo të rasteve të konfliktit të interesit, si, p.sh., Këshilli i Etikës që do të merrej me shqyrtimin e dilemave etike në bashki. Nga sondazhi me punonjësit e bashkisë, të pyetur se si kanë reaguar kur janë vënë në dijeni të shkeljeve etike dhe joprofesionale nga ana e kolegëve të tyre, 41.7% e tyre kanë raportuar se e kanë ballafaquar me kolegun dhe i kanë kërkuar të ndreqë gabimin, 30% e tyre nuk kanë reaguar fare, 13% e tyre e ka raportuar te strukturat përkatëse dhe pjesa tjetër e përgjigjedhënësve në mënyrë të barabartë kanë përzgjedhur alternativat e tjera (pyetja 21 në pyetësorin e vetëvlerësimit).

Masat konkrete:

1. Të miratohet Kodi i Sjelljes,[4] i cili të parashikojë standarde sjelljeje si për punonjësit administratës së bashkisë ashtu edhe për anëtarët e Këshillit Bashkiak. Të parashikohen në këtë Kod rregulla për rimin e konfliktit të interesit, pasurisë për zyrtarët që janë subjekt rimi dhe rregulla për rimin e dhuratave.
2. Të parashikohen në përmbajtje të kodit edhe mekanizma monitorues për zbatimin e tij, si Këshilli i Etikës si për dhënien e interpretimeve të nevojshme në lidhje me dispozita të këtij kodi por edhe për të dhënë zgjidhje rasteve të dilemave etike që mund të lindin në bashki. Vendimet e këtij të fundit të bëhen të ditura për të gjithë punonjësit e bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak.
3. Të ofrohen trajnime për të gjithë stafin dhe Këshillin Bashkiak për njohjen sa më të mirë të dispozitave të këtij kodi.
4. Të parashikohet mundësia që rregulla të veçanta pro-integritet në përmbajtje të kodit të kërkojnë angazhimin dhe respektimin edhe nga ana e kontraktorëve të bashkisë (ofruesit e shërbimeve të ndryshme për bashkinë) për t'i zbatuar me rigorozitet dispozitat e këtij kodi.

1.2 Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në bashki, për të parandaluar, luftuar dhe zbutur risqet e integritetit

Vlerësimi i situatës: Kuadri i brendshëm rregullator nuk përmban rregulla të brendshme të detajuara për procesin e rekrutimit në tërësi në bashki apo atë të ankimimit për këtë proces nga aplikantët me qëllim sigurimin e transparencës së vetë procesit. Mënyra e funksionimit të organeve të ngritura në bashki për procesin e rekrutimit (si, p.sh., Komisioni i Përhershëm i

[4] (Kodi Standard i Sjelljes për bashkitë bashkë me Udhëzuesin tip dhe shtojcat të miratuara nga Ministria e Drejtësisë)

Pranimeve) apo procedura të brendshme të punës për realizmin me transparencë të këtij procesi nuk janë parashikuar në kuadrin rregullator të bashkisë edhe pse praktika institucionale kryhet në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Në bashki është ngritur një sistem vlerësimi periodik i punonjësve (çdo 6 muaj). Në realizimin e këtij procesi, evidentohet një planifikim jo i detajuar në kohë i vlerësimit nga eprorët për punonjësit vartës duke krijuar kështu përplasje me rezultatet e depozituara për vlerësimin e mëparshëm me atë pasardhës. Formati i brendshëm i vlerësimit të performancës nuk është i personalizuar për bashkinë, por është format standard i përcaktuar nga Departamenti i Administratës Publike për nëpunësit civilë.[5] Rregullat në lidhje me vlerësimin e punonjësve të bashkisë për detyrat shtesë që ata kryejnë (p.sh., përveç detyrës funksionale në një sektor punonjësi i bashkisë kryen edhe detyrën e Koordinatorit të Transparencës) janë të paplota në kuadrin rregullator ekzistues. Vlerësimi më i shpeshtë që i është dhënë stafit të bashkisë në dy vlerësimet e fundit të performancës ka qenë "shumë mirë". Nga të dhënat e sondazhit me punonjësit e bashkisë, të pyetur nëse sistemi i vlerësimit aktual të performancës ka mangësi, të anketuarit kanë raportuar: 42% e punonjësve raportojnë se sistemi aktual krijon hapësira për subjektivitet; 23% që sistemi aktual i vlerësimit është formalitet; 10% raportojnë që nuk ka mangësi dhe pjesa e mbetur ndahet në mënyrë të barabartë për alternativat e tjera (të parashikuara për këtë pyetje në pyetësor). Kuadri politik dhe rregullator i bashkisë nuk evidenton politika institucionale dhe rregulla të brendshme për ngritjen në karrierë të lidhura me rezultatet e vlerësimit të performancës. I njëjti konstatim vlen edhe për parashikimin e planit për trajnime dhe zhvillimin profesional të punonjësve të bashkisë.

Masat konkrete:

1. Të hartohen dhe miratohen rregulla të brendshme të DABNJ në bashki për procesin e rekrutimit të stafit të bashkisë, të tilla si puna e Komisionit të Pranimeve (administrimi i intervistave me kandidatët, zbardhja e vlerësimeve përkatëse të kandidatëve, nënshkrimi i deklaratave të Konfliktit të Interesit nga anëtarët e komisionit për çdo proces përzgjedhës), monitorim i vazhdueshëm i shpalljeve të vendeve të lira të punës, etj.
2. Të monitorohet procesi i rekrutimit, përmes përfshirjes në planin e auditit të brendshëm, të hartuar nga Drejtoria e Auditit, të monitorimeve ad-hoc në mënyrë rastësore të proceseve të realizuara.
3. Të hartohet Manuali i Përshkrimeve të Vendeve të Punës për të gjitha funksionet e ushtruara në bashki apo struktura që ngrihen për vendimmarrje të caktuara. Manuali të përfshijë për çdo funksion/strukturë në bashki, përgjegjësitë konkrete në përputhje me përcaktimet e bëra me rregulloret e veçanta të drejtorive të bashkisë. Stafi i bashkisë duhet të njihet me përmbajtjen e këtij Manuali.
4. Të përmirësohet sistemi i vlerësimit periodik të performancës së punonjësve në bashki duke hartuar një formular vlerësimi për bashkinë me tregues të qartë dhe realistë për vlerësimin e cilësisë së punës (tregues që përfshijnë të gjitha detyrat që punonjësit kryejnë apo për funksionet që ata ushtrojnë); një planifikim më të mirë në kohë ndërmjet drejtorive dhe DABNJ në lidhje me realizimin e vlerësimeve periodike; rezultate realiste të bazuara në

[5] VKM Nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë" (ndryshuar me VKM Nr. 252, datë 30.03.2016)

tregues dhe parashtrim i qartë i procedurës së ankimimit të rezultatit të vlerësimit nga ana e punonjësit.

5. Të promovohen politika institucionale për zhvillimin në karrierë të stafit të bashkisë.

1.3 Forcimi i burimeve njerëzore të bashkisë nëpërmjet zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak për të parandaluar, zvogëluar dhe eliminuar risqet e integritetit.

Vlerësimi i situatës: DABNJ bashkëpunon me drejtoritë e tjera në bashki për të hartuar planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e bashkisë. Trajnimet e realizuara me punonjësit e bashkisë nuk shoqërohen me një sistem vlerësimi për efektshmërinë e tyre nga kjo drejtori. Plani vjetori i trajnimeve për punonjësit e administratës duhet të përputhet më shumë me nevojat reale të punonjësve, duke u mbështetur në nevojat që rezultojnë nga sistemi i vlerësimit të performancës të punonjësve të bashkisë. Nga të dhënat e sondazhit, të pyetur në lidhje me informimin e punonjësve të bashkisë për planin vjetor të kualifikimeve në bashki, rezulton se 23% e punonjësve të bashkisë raportojnë se nuk janë aspak të informuar në lidhje me këtë plan; 20% e punonjësve të bashkisë raportojnë qëndrim të njëjtë si pohimin që janë të mirinformuar dhe po 20% për pohimin disi të informuar. Modulet e trajnimeve më të kërkuara nga stafi i bashkisë kanë qenë ato për përvetësimin më të mirë të përditësimeve ligjore sipas drejtorive ku punojnë. Module trajnimi të nevojshme për stafin rezultojnë dhe ato për konfliktin e interesit, etikën dhe integritetin.

Masat konkrete:

1. Të hartohet një plan vjetor për trajnimet dhe zhvillimin profesional, mbështetur në nevojat për trajnim dhe zhvillim profesional të punonjësve të bashkisë, si rrjedhojë e sistemit të vlerësimit të performancës në bashki.
2. Të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme procesi i trajnimit nga ana e DABNJ për të vlerësuar nëse pjesëmarrja e stafit në trajnime është bërë në bazë të nevojave dhe meritave.
3. Të ngrihet një sistem vlerësimi për trajnimet, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Të ofrohen trajnime për stafin e bashkisë mbi ndryshimet e fundit ligjore dhe nënligjore sipas fushave që mbulojnë. Të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme trajnime me modulin për etikën dhe integritetin për të gjithë stafin e bashkisë.
5. Të sigurohet që i gjithë stafi i bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak të njihen me përmbajtjen e Kodit të Sjelljes përmes trajnimeve fillestare dhe të vazhduara me bashkinë si dhe me të gjitha rregullat e bashkisë në lidhje me fushat kryesore të integritetit: konflikti i interesit dhe deklarimi i tij, deklarimi i dhuratave, mbrojtja e sinjalizueseve dhe dypunësimi i stafit të bashkisë.

<u>OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:</u>

- **Rritja e llogaridhënies dhe transparencës së bashkisë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm vendor si dhe për të forcuar integritetin e institucionit**

Objektivat specifike:

2.1. Përmirësimi i rregullave dhe instrumenteve mbi transparencën dhe procesin e njoftimit dhe konsultimit publik për vendimmarrjet e bashkisë.

Vlerësimi i situatës: Bashkia Elbasan ka caktuar koordinatorin për transparencën dhe të dhënat e tij janë publikuar në faqen e bashkisë. Bashkia ka miratuar Programin e Transparencës[6], por në faqen zyrtare të saj është publikuar vetëm rubrika e Programit të Transparencës dhe jo përmbajtja e tij. Bashkia ka caktuar Koordinatorin për Konsultimin Publik, por nuk i ka bërë publike të dhënat e tij. Në faqen zyrtare të internetit është krijuar një rubrikë "Pjesëmarrja qytetare" ku publikohen disa rregulla të përgjithshme mbi pjesëmarrjen qytetare, si në mbledhjet e hapura, dëgjesa publike, etj. Në këtë faqe nuk ka një rubrikë informacioni mbi njoftimet për konsultimet publike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".

Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator konstatohet se nuk ka dispozita të detajuara lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit si dhe të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Gjithashtu, konstatohet se dispozitat për komunikim e brendshëm të drejtorive dhe me koordinatorin e transparencës nuk janë të detajuara në lidhje më dhënien e informacionit me kërkesë nga publiku dhe për hartimin apo përditësimin e Programit të Transparencës (PT). Instrumenti i PT dhe përditësimi i tij nuk janë detajuar në rregulloren funksionale të bashkisë. Nuk detajohen as rregullat për llojin e informacionit që duhet bërë publik me kufizimet që vijnë nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga sondazhi me punonjësit e bashkisë, të pyetur për mënyrën e informimit të publikut për aktivitetet e bashkisë Elbasan, 34% e përgjigjedhënësve kanë raportuar se këtë e bëjnë përmes informacionit të bërë publik në faqen zyrtare të internetit; 20.8% raportojnë përmes koordinatorit të transparencës e ndjekur nga 14.2% përmes konsultimeve publike.

Rregullorja e Këshillit Bashkiak nuk përputhet me përgjegjësitë ligjore të dhëna nga Ligji "Për vetëqeverisjen vendore". Konstatohet nevoja për përditësimin e saj në lidhje me: i) parashikimin e rregullave për ndjekjen nga ana e qytetarëve të mbledhjeve të KB, edhe pse nga praktika institucionale rezulton se ato kryhen; ii) parashikimin e rregullave për mënyrat dhe paraqitjen e nismave qytetare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tyre në KB, afate e njoftimeve të konsultimit publik dhe detaje për mbajtjen e procesverbalit të takimeve konsultuese në formën e një dokumenti zyrtarë. Konstatohet nevoja për një konsolidim më të mirë të praktikës së publikimit të procesverbaleve të dëgjesave publike.

Masat konkrete:

1. Të parashikohet në rregulloren e organizimit të bashkisë detyra e Koordinatorit të Transparencës dhe përgjegjësitë e tij si edhe Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.
2. Të publikohet dhe të përditësohet rregullisht Programi i Transparencës së Bashkisë Elbasan. Të publikohen në faqen zyrtare të bashkisë raporte monitorimi/të auditit të brendshëm dhe të jashtëm për veprimtarinë e bashkisë. Të publikohen në faqen zyrtare të bashkisë kontratat publike të ofrimi të shërbimeve.
3. Të parashikohen në rregulloren e brendshme të bashkisë koordinimi dhe komunikimi mes drejtorive të bashkisë dhe koordinatorit të Transparencës për sigurimin e informacionit me kërkesë nga publiku si dhe për hartimin dhe përditësimin e PT-së.

[6] Vendimi i Këshillit Bashkiak, Nr. 10, datë 24.01.2019, "Për miratimin e Programit të Transparencës për Bashkinë Elbasan"

4. Të parashikohen në rregulloren bashkisë rregulla të qarta në lidhje me kufizimet e të drejtës për informim, sipas përcaktimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Të publikohen të dhënat e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për bashkinë.
6. Të krijohet një regjistër elektronik me informacione për të gjitha hallkat e procesit vendimmarrës për aktet administrative nënligjore të Këshillit Bashkiak. Të hartohet rregullorja e KB me përgjegjësitë e reja në lidhje me njoftimin dhe konsultimin publik, për nismat qytetare, për ndjekjen nga ana e qytetarëve të mbledhjeve të KB, publikimit të procesverbaleve të mbledhjes, etj.
7. Të trajnohen vazhdimisht punonjësit për të gjithë rregullat e mësipërme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të shmangur rrezikun që hasin gjithmonë sistemet e informacionit lidhur me përhapjen, trajtimin apo përpunimin sipas ligjit për të drejtën për informim dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Të hartohet dhe të publikohet raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes në zbatim të Nenit 20 të Ligjit Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

- **Forcimi dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm në bashki për fushat operative që janë më së shumti të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit.**

Objektivat specifike:

3.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë në lidhje me aspektet kryesore të garantimit të integritetit: konflikti i interesit dhe deklarimi i tij, deklarimi i dhuratave, mbrojtja e sinjalizueseve dhe dy punësimi i stafit të bashkisë.

Vlerësimi i situatës: Duke iu referuar kuadrit ekzistues të brendshëm rregullator, kryesisht rregullores së funksionimit të administratës së bashkisë, rregulloreve të organizimit të drejtorive përkatëse dhe asaj të Këshillit Bashkiak, konstatohet se nuk është detajuar me parashikimin e parimeve, vlerave etike dhe standardeve të sjelljes të administratës së bashkisë apo të Këshillit Bashkiak. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Bashkiak bëhet me Rregulloren përkatëse të KB (2006), që për nga vetë viti i miratimit të saj nuk reflekton përgjegjësitë e reja që vijnë nga Ligji "Për vetëqeverisjen vendore" (i vitit 2014), Ligji "Për të Drejtën e Informimit", Ligji "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", Ligji "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", etj. Rregullorja në fuqi përcakton strukturat e Këshillit Bashkiak, detyrat, funksionet, mënyrat dhe rregullat e funksionimit të tij, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore", i shfuqizuar me ligjin e vitit 2014.

Me ngritjen e strukturës së parandalimit të konfliktit të interesit në bashki, është krijuar Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzorë (DABNJ) dhe regjistri përkatës, por konstatohet mungesë e ndonjë praktike të regjistruar apo procedura nga kjo strukturë. Sipas të dhënave nga sondazhi me punonjës të bashkisë, të pyetur nëse kishin dijeni për raste të konfliktit të interesit të regjistruara zyrtarisht në bashki, 60.8% e përgjigjedhënësve raportuan se nuk kanë dijeni nëse ka raste të konfliktit të interesit të regjistruara në bashkinë e tyre, 33.8% raportuan se nuk ka raste të regjistruara dhe vetëm 5.4% e tyre raportuan se raste të konfliktit të interesit regjistrohen në bashkinë e tyre. Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator rezulton mungesë në rregulla të brendshme për funksionimin e njësisë për parandalimin e konfliktit të interesit (autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit) si edhe të rregullave procedurale për deklarimin e rasteve konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Rregulla të qarta parandalimin e konfliktit të interesit për këshilltarët bashkiakë nuk konstatohen edhe në rregulloren e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Elbasan[7].

Në DABNJ nuk konstatohet një regjistër i dhuratave sipas parashikimeve ligjore. Nga të dhënat e sondazhit me punonjësit e bashkisë, të pyetur nëse kanë dijeni për ekzistencën e rregullave për pranimin dhe administrimin e dhuratave, rezulton se 55.7% e përgjigje dhënësve në bashki raportojnë se nuk kanë informacion nëse ka një regjistër të tillë dhe rregullat për funksionimin e tij. 14.2% e tyre raportojnë se nuk ka rregulla të tilla në bashki dhe 30.1% e përgjigjedhënësve raportojnë se në bashkinë e tyre ka rregulla për këtë qëllim.

Bashki ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesve. Konstatohet se rregullat për mënyrën e funksionimit të kësaj njësie si dhe të dispozitave për procedurën e regjistrimit, hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprimeve ose praktika të dyshuara korrupsioni duhet të jenë të plota dhe të detajuara. Kjo njësi nga momenti i ngritjes nuk ka praktikë të regjistruar. Nga informacioni i marrë nga diskutimet në fokus grupe me punonjësit e bashkisë rezulton se ata nuk kanë dijeni për ekzistencën e kësaj njësie në bashki. Sipas të dhënave nga anketimi i stafit të bashkisë rezulton se 52.8% e të anketuarve raportojnë se nuk kanë dijeni për ekzistencën e rregullave mbi sinjalizimet në bashkinë e tyre, 36% e tyre raportojnë se ka rregulla dhe zbatohen në praktikë, 6.4% raportojnë se ka rregulla të tilla por nuk zbatohen në praktikë dhe 4.6% e të anketuarve

[7] Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak më 20.05.2004

raportojnë se nuk ka rregulla për sinjalizimet në bashki. Në lidhje me trajnimin e ofruar për stafin e bashkisë për rregullat dhe procedurat e parashikuara për njësinë e sinjalizimit, 72.6% e përgjigjedhënësve raportojnë se nuk janë trajnuar në lidhje me to dhe 27.4% raportojnë se janë trajnuar.

Masat konkrete:

1 Të rishikohet rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Elbasan me qëllim parashikimin e rregullave të qarta që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit, ligji për financat vendore, ligji për njoftimin dhe konsultimin publik, ligji për konfliktin e interesit, kuadri nënligjor për menaxhimin financiar, etj.

2 Të rishikohen rregulloret e veçanta të drejtorive të përgjithshme të bashkisë lidhur me bashkërendimin mes tyre, kompetencat dhe funksionet përkatëse.

3 Të hartohet dhe miratohet rregullorja e re e Këshillit Bashkiak ku të përfshihen përgjegjësitë e dhëna me përcaktimet e ligjit të ri për vetëqeverisjen vendore.

4 Të hartohen dhe miratohen rregulla të qarta për funksionimin e njësisë për parandalimin e konfliktit të interesit në bashki; rregulla dhe procedura të qarta për deklarimin e një situate të konfliktit të interesit në bashki si për punonjësit e administratës ashtu edhe për këshilltarët bashkiakë dhe për procedimin e saj nga autoriteti përgjegjës; rregulla për mënyrën e funksionimit të regjistrit përkatës. Këto rregulla të detajohen përtej përcaktimeve të Kodit të Sjelljes, rregullores së brendshme të bashkisë dhe rregullores së KB, në mënyrë që të rregullojnë në mënyrë të plotë dhe efikase të gjitha fushat e integritetit në bashki. Të ofrohen trajnime të vazhduara për stafin e bashkisë dhe këshilltarët bashkiakë për legjislacionin dhe procedurat e konfliktit të interesit, me qëllim deklarimin e tyre.

5 Të krijohet regjistri i dhuratave në bashki, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim. Të detajohen rregulla të brendshme për funksionimin dhe mbajtjen e tij për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e tyre. Të sigurohet njohja e stafit të bashkisë me këtë regjistër.

6 Të normohen procedura dhe rregulla të qarta dhe të detajuara për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me rregullore të veçantë ose si pjesë e rregullores së bashkisë, duke filluar që nga regjistrimi, hetimi dhe përfundimi i një procedure sinjalizimi. Të inkurajohen politika dhe qasje të brendshme sinjalizimi, ku "kultura e heshtjes" të mos frenojë raste të dyshuara korruptive.
7 Të informohet dhe të trajnohet stafi i bashkisë në lidhje me detyrimet e ligjit për sinjalizimin si dhe mbi funksionimin e njësisë përgjegjëse për sinjalizimet.

3.2 Përmirësimi i rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit në procese me risk për shkelje të integritetit për bashkinë

Vlerësimi i situatës: Në nivel institucional, bashkia ka disa procese pune të lidhura me drejtori të veçanta që paraqesin risk dhe kompleksitet, që mbartin ndërveprimin edhe me publikun dhe krijojnë mundësi për përfitime, favorizime dhe abuzime dhe të cilat mund të konsiderohen si "procese risku" në bashki. Këto risqe janë të lidhura me procese të tilla si prokurimi publik ku ndërveprimi publik dhe privat është shumë i lartë; procesi i menaxhimit dhe administrimit të pronave publike, i cili përfshin tjetërsimin e pronës publike; procese me funksione menaxheriale si menaxhimi financiar; procesi i mbrojtjes së territorit nga ndërtimet pa leje. Në këtë hartë të proceseve të riskut përfshihen edhe proceset e punës të lidhura me fushën e shërbimeve publike si p.sh., ai i dhënies së lejeve të ndërtimit apo mbikëqyrja në terren e zbatimit të lejeve të ndërtimit nga subjektet që janë pajisur me një të tillë, janë procese më të riskuar ndaj shkeljes së integritetit, etj. Ndaj, rekomandohet që këto procese të shoqërohen me kontrolle operative për të menaxhuar më mirë risqet e integritetit. Këto kontrolle operative mund të përfshijnë rregulla, udhëzime, procedura, kontrolle fizike, përdorim të burimeve njerëzore ekzistuese si edhe ngritjen e kapaciteteve të tyre përmes ofrimit të trajnimeve apo edhe aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Masat konkrete:

Prokurimet publike:

1. Të fuqizohen kapacitetet njerëzore në bashki mbi njohjen dhe përmirësimin e standardeve të kërkuara për proceset e prokurimit publik dhe veçanërisht në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes kuadër me operatorë të ndryshëm, përmes zhvillimit të programeve të trajnimit në këto nevoja.
2. Të përcaktohen rregullat e menaxhimit të proceseve të prokurimit publik në bashki duke i detyruar shoqëritë/kompanitë fituese të zotohen ndaj rregullave pro-integritet të bashkisë (të vendosura në Kodin e Sjelljes së bashkisë).
3. Të përmirësohen kontrollet e cilësisë në procesin e zbatimit të kontratave të prokurimit publik, përmes kontrollove të shpeshta ad-hoc (kontrolle me disa punonjës në përbërje).
4. Të zhvillohet një sistem auditi nga Drejtoria e Auditit post-prokurimi për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të prokurimit publik.

Planifikimi dhe mbrojtja e territorit:

1. Të formalizohet, në aspektin e brendshëm rregullator, procesi i hartimit, miratimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit, i

detajuar, që do të trajtonte në mënyrë sa më shteruese një planifikim të të gjithë nevojave të qytetit në planin e përgjithshëm vendor.
2. Të bëhen pjesë përbërëse e rregullores së përgjithshme të bashkisë edhe rregullat për procesin e dhënies së lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit.

Shërbime publike:
1. Të miratohen standarde për llojin dhe cilësinë e shërbimit, proceset e hartimit dhe përzgjedhjes së instrumentit për administrimin e shërbimit publik si pjesë përbërëse e rregullores së përgjithshme të bashkisë.
2. Të parashikohet (hartimi dhe miratimi i) një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, si pjesë përbërëse e rregullores së përgjithshme të bashkisë.
3. Të rishikohet praktika ekzistuese e funksionimit të zyrave me një ndalesë (one-stop shop), duke mos dublikuar funksionin e tyre me vijimin e praktikës shkresore për punonjësit e bashkisë.
4. Të përcaktohet një proces bazuar në praktika të ngjashme të pushtetit vendor, i cili bën të qartë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë për përgatitjen e termave të referencës për hartimin, miratimin, nënshkrimin dhe monitorimin e kontratave publike.
5. Të ofrohen trajnime të vazhdueshme për stafin për rritjen e profesionalizmit në hartimin e specifikimeve teknike për shërbimet.

Menaxhimi i pronave në administrim vendor:
1. Të hartohet dhe miratohet një strategji institucionale për administrimin e pronave të bashkisë duke konsideruar buxhetet edhe ndikimin social.
2. Të ngrihet një sistem informacioni për administrimin dhe përdorimin e pronave të bashkisë i cili garanton transparencën dhe informon të gjitha palët mbi fazat e procesit. Të krijohet inventarizimi i pronave të bashkisë përmes një sistemi të informatizuar të mbajtjes së tyre.
3. Të krijohet dhe administrohet regjistri i kontratave për pronat në pronësi ose administrim të bashkisë me qëllim sigurimin e transparencës.
4. Të ngrihet një sistem monitorimi mbi procesin e regjistrimit të pronave, i cili të përfshijë kontrolle periodike të regjistrit dhe informacionit të hedhur për pronë.
5. Të ofrohet trajnim i vazhdueshëm i stafit të drejtorisë përkatëse në bashki për legjislacionin mbi pronat dhe ndryshimet ligjore përkatëse.

Menaxhimit financiar:
1. Të parashikohen rregulla të brendshme për planifikimin dhe komunikimin e punës mes drejtorive të bashkisë (ekipe të menaxhimit të buxhetit) dhe Drejtorisë së Buxhetit për procesin e hartimit të buxhetit vjetor të bashkisë.
2. Të rriten kapacitetet profesionale në drejtoritë e ndryshme në bashki në drejtim të hartimit të projekt-buxheteve për programet përkatëse, në kuadër të PBA-së si edhe për përpilimet e raporteve të përmbledhura mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës.
3. Të përcaktohen tendencat dhe kufijtë bazuar në pritshmëri sa më të përafërta me realitetin për planifikimin e buxhetit në kuadër të procesit të përgatitjes së buxhetit vjetor të bashkisë dhe në proceset e përgatitjes se taksave e tarifave vendore.

3. PLANI I VEPRIMIT

1. Fusha e menaxhimit financiar (buxheti - të ardhurat dhe shpenzimet).
2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore.
3. Fusha e kontrollit, auditit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit.
4. Fusha e shërbimeve publike.
5. Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave.
6. Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimi të territorit.
7. Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik

DATO

3.1 Fusha e Menaxhimit Financiar

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e Menaxhimit Financiar

Nr.	Risku	Masat prioritare • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve	Objektivat strategjikë dhe specifikë
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[8]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përkatësinë e masave sipas objektivave
1.1	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit, publikimit në kohë dhe zbatimit të programit buxhetor afatmesëm të tilla si: 1. Njësia e buxhetit paraqet burime njerëzore të pamjaftueshme. 2. Kërkesat e buxhetit nuk dorëzohen në kohë nga njësitë në bashki. 3. Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore paraqesin nevoja për ngritje kapacitetesh në hartimin e programeve buxhetore. 4. Programe buxhetore paraqesin harmonizim të pamjaftueshëm me	Prioritet i lartë	1. Vlerësimi me tregues të matshëm të nevojave për kapacitete njerëzore dhe njohuri profesionale për pozicionin. 2. Përcaktimi i planifikimit të hershëm për të evituar vonesat nga njësitë. 3. Ndërlidhja e objektivave të njësisë me strategjinë institucionale, të jetë subjekt i vlerësimit cilësor të Ekipit të Menaxhimeve të programeve buxhetore. 4. Raportimi i ndryshimeve të shpeshta të programeve buxhetore pranë autoriteteve drejtuese dhe argumentimi i plotë i tyre. 5. Përpilimi i listës dhe kontakteve të grupeve	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2 Objektivi 1.3

[8]Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

	strategjitë ekzistuese dhe nevojat reale në bashki. 5. Programet buxhetore te aprovuara të cilat rishikohen vazhdimisht dhe pasjellin efekt në investime. 6. Pjesëmarrje e ulët e aktorëve të interesit në procesin e konsultimit publik të PBA-së.		të interesit dhe njoftimi në kohë i tyre për konsultimet publike.		
1.2	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit, publikimit në kohë dhe zbatimit të buxhetit vjetor të bashkisë të tilla si: 1. Buxheti vjetor nuk realizohet plotësisht në zbatim si pasojë e aplikimit të skenarëve optimiste në planifikimin e të ardhurave.	Prioritet i lartë	Përcaktimi i tendencave dhe kufijve bazuar në pritshmëri sa më të përafërta me realitetin për planifikimin e buxheteve.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2
1.3	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit dhe publikimit të taksave e tarifave vendore: 1. Mbledhja e taksave vendore të miratuara jo efektive duke cenuar realizimin buxheti vendor, si rrjedhojë e një planifikimi me skenarë optimalë. 2. Ndërgjegjësim i ulët i qytetarëve në lidhje me pagesën e taksave vendore (pasuria etj.).	Prioritet i lartë	Përcaktimi i tendencave dhe kufijve në mbledhjen e taksave, bazuar në pritshmëri sa më të përafërta me realitetin për planifikimin e buxheteve. Identifikimi i mënyrave lehtësuese për të paguar nga ana e qytetarëve me këste pagesën vendore.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2 Objektivi 2.1
1.4	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të rregullave dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si rrjedhojë e: 1. Kuadri rregullator i brendshme nuk parashikon rregulla për menaxhimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të	Prioritet i lartë	Plotësimi i rregullores së përgjithshme duke siguruar grupe inventarizimi efikase dhe përdorimin e softuerëve të dedikuar për inventarizimin.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 3.2 Objektivi 2.1

	aktiveve të Bashkisë.				
1.5	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes dhe miratimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe realizimi i tyre si rrjedhojë e: 1. Regjistri i prokurimeve nuk miratohet në afat si rrjedhojë e mos parashikimi të plotë të zërave në buxhet. 2. Regjistri i prokurimeve pëson rishikime të destinacioneve për shkak të prioriteteve emergjente; 3. Burime njerëzore në Drejtorinë e Prokurimeve të pamjaftueshme. 4. Monitorim dhe mbikëqyrje të një cilësie jo optimale e zbatimit te marrëveshjeve kuadër me operatorë të ndryshëm si pasojë e kapaciteteve të kufizuara teknike.	Prioritet i moderuar	1. Përcaktimi i zërave të buxhetit mbi planifikimet konkrete në linjë me planifikimin e vjetor. 2. Përcaktimi i zërave dhe buxheteve për parashikimin e nevojave në raste emergjencash, bazuar në historikun e viteve të fundit. 3. Vlerësimi me tregues të matshëm të nevojave për kapacitete njerëzore dhe njohuri profesionale për pozicione pune në Drejtorinë e Prokurimeve.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2 Objektivi 1.3
1.6	Risqe të mundshme në proceset e ngritjes dhe funksionimit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe të njësisë së prokurimeve si rrjedhojë e: 1. Manuali i çmimeve i papërditësuar që implikon punën në planifikimin e Drejtorisë së Projekteve; 2. Çmimet në manual nuk janë të unifikuara me vlerat reale të tregut.	Prioritet i moderuar	1. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme të Drejtorisë së Prokurimeve, i procedurës së rifreskimit periodik të listës së çmimeve për qëllime planifikimi të Drejtorisë së Projekteve. 2. Përcaktimi i burimeve të informacionit duke përfshirë: a) Internetin; b) Listat e mëparshme të ofertave; c) Vizitat dhe këqyrjet në terren të artikujve të planifikuar.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 3.2
1.7	Risqe te mundshme në procesin e prokurimit publik, në lidhje me: 1. Koordinim dhe raportim jo efektiv ndërmjet punonjësve në drejtorinë	Prioritet i moderuar	1. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme të ndarjes së qartë dhe të duhur të detyrave brenda Drejtorisë së Prokurimit Publik si dhe raportimit të brendshëm, për procesin e	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2 Objektivi 2.1

	e prokurimeve, në procesin e zbatimit të kontratave publike. 2. Operatorët e bashkisë (ofruesit e shërbimeve) paraqesin mungesë angazhimi për të respektuar rregullat pro-integritet të bashkisë.		zbatimit të kontratave publike. 2. Përmirësimi i kontrolleve të cilësisë në procesin e zbatimit të kontratave të prokurimit publik, përmes kontrollove të shpeshta ad-hoc (me disa punonjës në përbërje) për realizmin e kontrolleve të cilësisë. 3. Të përcaktohet, në rregulloren e përgjithshme të menaxhimit të proceseve të prokurimit publik në bashki si edhe në Kodin e Sjelljes, detyrimi që shoqëritë/ kompanitë fituese të zotohen ndaj rregullave *pro* integritet të bashkisë.		
1.8	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit dhe publikimit çdo muaj (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të raporteve të përmbledhura mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës të tilla si: 1. Raportet mujore dhe katër mujorë të buxhetit nuk përpilohen në afat, për shkak të afateve kohore të ngushta, ngarkesës së stafit, madhësisë së bashkisë dhe numrit të lartë të njësive buxhetore në varësi (në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore për PBA).	Prioritet i moderuar	Vlerësimi me tregues të matshëm i kapacitetit të punës dhe përcaktimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe të trajnuar për të përmbushur në afatet kohore raportimet mbi ecurinë e realizimit të treguesve , sipas planit vjetor dhe të periudhës.	Gjashtë mujori I 2021	Objektiv 3.2 Objektivi 1.3
1.9	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit dhe publikimit të raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor të tilla si: 1. Grupet e Menaxhimit të Programeve kanë aftësi teknike të	Prioritet i lartë	1. Vlerësimi me tregues të matshëm i kapacitetit të punës dhe përcaktimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe të trajnuar për të përmbushur afatet kohore të përpilimeve dhe raportimeve.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.1 Objektivi 1.3

	kufizuara në procesin e përgatitjes së raportit vjetor të buxhetit.				
1.10	Risqe të mundshme në proceset e përgatitjes, miratimit dhe publikimit të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër mujorë të monitorimit të zbatimit të buxhetit) të tilla si: 1) Burime njerëzore të pamjaftueshme dhe më aftësi teknike të kufizuara, në Drejtorinë e Buxhetit, për procesin e monitorimit për zbatimin e Buxhetit.		Vlerësimi me tregues të matshëm i kapacitetit të punës dhe përcaktimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe të trajnuar për të përmbushur afatet kohore të përpilimeve dhe raportimeve	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.1 Objektivi 1.3

3.2 Fusha e Burimeve Njerëzore

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e burimeve njerëzore					
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[9]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përkatësinë e masave sipas objektivave
2.1	Risku i organizimit të duhur në funksionimin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (BNJ) 1. Plani vjetor, i miratuar, i pranimeve për vendeve vakante të punës në shërbimin civil pëson ndryshime gjatë zbatimit. 2. Plani vjetor i trajnimeve, i miratuar, nuk përputhet plotësisht me nevojat reale të punonjësve. 3. Përshkrimet e vendeve të punës për punonjësit e administratës së bashkisë nuk përmbajnë detaje për çdo pozicion pune që çdo ushtrohet në bashki. 4. Kuadri i brendshëm rregullator nuk	Prioritet i lartë	1. Një sistem i mbledhjes së mendimit dhe sugjerimeve nga të gjitha drejtoritë/ njësitë e institucionit mbi ndryshimet dhe nevojat e reja në periudhën pasardhëse në mënyrë që parashikimet vjetore të jenë realiste. 2. Zbatimi i parimit të katër syve në nivelet miratuese, përfshirë këtu shefa sektori dhe drejtues njësish apo departamentesh, për pjesëmarrjen e punonjësve sipas nevojave në trajnime. 3. Hartimi dhe miratimi i manualeve/katalogut të përshkrimit të detyrave sipas vendeve të punës për administratën e bashkisë duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e çdo pozicioni pune në përputhje me rregulloren e brendshme të bashkisë, rregulloret përkatëse	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 1.2 Objektivi 1.3

[9] Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

	parashikon rregulla për procesin e rekrutimit të stafit të bashkisë në funksion të garantimit të transparencës.		të drejtorive të bashkisë dhe të sigurohet njohja e stafit me to. 4. Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme për procesin rekrutimit të punonjësve në bashki. Këto rregulla të përfshijnë të gjitha modalitetet e procesit dhe strukturat e ngritura për këtë qëllim si, p.sh., procesi i dokumentimit të vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Përhershëm i Pranimeve, nënshkrimi i deklaratave të konfliktit të interesit nga anëtarët e tij etj.		
2.2	Risqet e mundshme gjatë procesit të pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive që bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe transparent mund të kenë të bëjnë me si më poshtë: 1. Faqja e internetit mund të jetë e paaksesueshme; 2. Praktika e lidhjes së kontratave sipas dispozitave të Kodit të Punës për vendet e punës që i përkasin shërbimit civil.	Prioritet i lartë	1. Mirëmbajtja në kohë dhe monitorimi i plotësisë dhe funksionalitetit të faqes për të gjitha seksionet (sidomos në rastet e shpallje së vendeve vakante). 2. Monitorim periodik (çdo 6 muaj) nga një grup ad-hoc, i cili raporton pranë titullarit për të gjitha punësimet e bëra në bashki. Përbërja e grupit: përfaqësues nga BNJ, Dep. Juridik, Auditimi i Brendshëm.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.2 Objektivi 2.1
2.3	Risqet gjatë procesit të administrimit të dosjeve të personelit për çdo të punësuar: 1. Sistemi elektronik (sistem i informatizuar) për përmbajtjen e dosjeve personale të stafit (dosjet e personelit) nuk është ngritur. 2. Të dhënat e personelit të bashkisë në Regjistrin Qendror te Personelit (DAP) nuk hidhen. 3. Infrastruktura e dobët teknike për mirëmbajtjen e dosjeve të personelit (mjediset ekzistuese jo të	Prioritet i lartë	1. Ndërtimi i një baze të dhënash (në Excel apo Access) me të gjitha referencat e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët në dosjet e tyre. 2. Verifikimi i periodik i listës së personelit të bashkisë me listën e raportuar pranë regjistrit qendror të personelit (DAP). (Rezultatet e këtij verifikimi të raportohen pranë titullarit.) 3. Krijimi i vendeve të caktuara në ambientet e institucionit për ruajtjen dhe magazinimin e dosjeve të personelit. Ruajtja e tyre të bëhet në dollapë me mbrojtje nga zjarri. 4. Të përcaktohen rregulla të qarta ,në kuadrin	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 1.2

	përshtatshme për volumin e dosjeve). 4. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla/dispozita për llojin e informacionit që mund të jepet mbi dosjet e personelit, sipas kërkesave për informim.		rregullator të bashkisë, për llojin e të dhënave që mund të jepen për personelin mbi bazën e kërkesave të ligjit mbi ruajtjen e të dhënave personale (që të mund të shmanget risku ligjor i dhënies së të dhënave personale të paautorizuar).		
2.4	Risqet e mundshme të funksionimit të sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë për punonjësit e bashkisë vijojnë si më poshtë: 1. Formati i brendshëm standard i vlerësimit të punonjësve, i personalizuar për bashkinë, nuk është miratuar. 2. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla për vlerësimin e punonjësve të cilët kryejnë punë të ndërthurura (detyra shtese), në mënyrë që ata të vlerësohen dhe për detyrat shtesë që kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës parësore. 3. Kuadri i brendshëm politik dhe rregullator nuk parashikon politika dhe rregulla për promovimin në karrierë, përparimin në pagë dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional. 4. Rezultatet e sistemit të vlerësimit nuk shërbejnë si bazë për parashikimet në kalendarin e trajnimeve për punonjësit. 5. Planifikim jo efektiv për dorëzimin e vlerësimeve nga eprorët në kohë.	Prioritet i lartë	1. Projektimi dhe ngritja e një sistemi vlerësimi të performancës që bën të mundur: i) përcaktimin e objektivave të periudhës në vlerësim; ii) vlerësimin e përmbushjes së tyre në mënyrë të matshme; iii) përmbajtjen e formularëve me fusha standarde dhe përshkallëzimin e tyre bazuar në arritjen e objektivave; iv) afatet e vlerësimeve dhe komunikimin e tyre palëve. 2. Miratimi i një politike të brendshme që garanton zhvillimin e karrierës në të cilën të parashikohen hapat e mundshëm të promovimit, intervalet e mundshme të kohës së nevojshme dhe aftësitë e nevojshme që duhen të përmbushen për arritjen e tyre të suksesshme. 3. Planifikimet e nevojave për trajnim të personelit të bashkisë të ushqehen edhe nga identifikimi i nevojave të aftësimit të stafit në fund të periudhave të vlerësimit.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 1.2 Objektivi 1.3

2.5	Hartimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i bazës së brendshme rregullatore të bashkisë mund të përmbaje risqet e mëposhtme: 1. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon parime, standarde etike dhe sjelljeje të organizimit dhe funksionimit të administratës së bashkisë. 2. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla të qarta të linjave të hierarkisë, raportimit dhe komunikimit ndërmjet drejtorive të bashkisë.	Prioritet i lartë	1. Plotësimi dhe formalizmi i rregullores së përgjithshme ku në vijim të strukturave organizative të përcaktohen përgjegjësitë për linjat e komunikimit dhe raportimit ashtu sikurse edhe nivelet e autoritetit (rregullore e brendshme e funksionimit të organizatës). Parashikimi në këtë kuadër i parimeve dhe vlerave etike të organizimit dhe funksionimit të administratës së bashkisë. 2. Zhvillimi i një cikli trajnimesh periodik (vjetor) me qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kuadrin e brendshëm rregullator të bashkisë, si p.sh: Rregulloren e funksionimit të bashkisë, rregulloret përkatëse organizative të drejtorive të bashkisë dhe Kodit të Sjelljes.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.2 Objektivi 1.3
2.6	Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planit/programit për kualifikimin dhe trajnimin të administratës: 1. Plani vjetor i trajnimeve për administratën nuk pasqyron plotësisht nevojat reale të bashkisë. 2. Plan vjetor i trajnimeve nuk ka lidhje me nevojat për trajnime të rezultuara nga sistemi i vlerësimit të performancës. 3. Mungon një kalendar vjetor i testimeve paraprake dhe ngritja e komisionit të vlerësimit për këtë qëllim.	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi i qartë i nevojave për trajnimeve bazuar mbi vlerësimet periodike. 2. Planifikimi i trajnimeve vjetore bazuar mbi këto nevoja dhe duke konsideruar edhe projektet e reja me "njohuritë praktike" të specializuar. 3. Kryerja e një procedure kontrolli dhe verifikim nëpërmjet kontrolleve rastësore periodike për të vlerësuar se pjesëmarrja në trajnime është vendosur sipas nevojave dhe meritave dhe jo caktimeve subjektive. 4. Përmirësimi i trajnimit profesional duke bashkërenduar me ofertuesit e trajnimeve në lidhje me nevojat e stafit si dhe komentet e këtyre të fundit për modulet e trajnimeve të shfrytëzohen për përmirësimin e tyre. 5. Ngritja e një sistemi të vlerësimit të	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 1.3

			trajnimeve që përfshin jo vetëm perceptimin ndaj trajnimit por edhe zbatimin e tij në vendin e punës. Rezultatet e këtij vlerësimi t'i komunikohen bordit të drejtorëve të bashkisë.		
2.7	Kuadri i brendshëm rregullator nuk ka një "Kodit të Sjelljes" për bashkinë.	Prioritet i lartë	Të miratohet dhe zbatohet Kodi i Sjelljes për bashkinë dhe anëtarët e këshillit bashkiak si dhe të sigurohet njohja e tij nga i gjithë stafi i bashkisë (p.sh. trajnime fillestare dhe të vazhdueshme).	Gjashtë mujori I 2020	Objektivi 1.1 Objektivi 1.3

DRAFT

2.8	Risqe të mundshme në proceset e miratimit dhe publikimit të programit të transparencës si: 1. Programit të Transparencës (PT) nuk publikohet dhe nuk përditësohet në mënyrë periodike. 2. Informacioni për PT dërgohet me vonesa nga drejtoritë përkatëse. 3. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla or nuk parashikon rregulla për funksionin e Koordinatorit të Transparencës dhe instrumentit të PT-së. 4. Detyra e Koordinatorit të Transparencës ushtrohet nga një punonjës i bashkisë që ushtron njëkohësisht një detyrë tjetër (mbivendosje detyrash). 5. Kuadri i brendshëm rregulla për komunikim e brendshëm në lidhje më dhënien e informacionit me kërkesë nga publiku.	Prioritet i lartë	1. Programi i Transparencës i publikuar dhe i përditësuar i vlefshëm për publikun. 2. Faqja e përditësuar me informacionet që janë detyrim për të qenë transparent me publikun. Vlerësimi i faqes dhe përditësimit të saj në mënyrë periodike nga një komision i pavarur 3. Parashikimi në rregulloren e bashkisë së funksionit të Koordinatorit të Transparencës. (për të drejtën e informimit) dhe në strukturën organizative. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive dhe roli i tij në institucion. 4. Përcaktimi në rregulloren e bashkisë i modaliteteve për realizmin e Programit të Transparencës në bashki. 5. Miratimi i dispozitave në rregulloren e brendshme të bashkisë për komunikim e brendshëm në lidhje më dhënien e informacionit me kërkesë nga publiku.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.2 Objektivi 2.1
2.9	Risqet e në procesin e konsultimit publik dhe ndjekjen e mbledhjeve të e këshillit të bashkisë (KB) nga publiku: 1. Rregullorja e Këshillit Bashkiak nuk parashikon rregulla dhe procedura për ndjekjen nga ana e qytetarëve të mbledhjeve që kryhen,	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme të KB të procesit të këshillimeve me publikun sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. 2. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme i nismave të publikut për të qenë në fokusin e bashkisë.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.2 Objektivi 2.1

	përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve të KB. 2. Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të bashkisë nuk janë publikuar. 3. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon funksionin e këtij koordinatori. 4. Procesverbalet konsultuese nuk publikohen. 5. Nuk është hartuar dhe miratuar raporti vjetor i transparencës.		3. Hartim dhe miratim i rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të KB sipas përgjegjësive të dhëna me ligjin e vetëqeverisjes vendore (2014). 4. Publikimi i të dhënave të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në bashki. 5. Parashikimi në rregulloren e bashkisë të funksionit dhe detyrave të këtij koordinatori. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive dhe roli i tij në institucion (ndërveprimit me strukturat e tjera të bashkisë) 6. Konsolidimi i praktikës së publikimit të procesverbaleve konsultuese në dëgjesa publike. 7. Ngritja e një grupi pune për hartimin e raportit vjetor të transparencës. Të realizohet publikimi i tij pas miratimit. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme të procesit të përgatitjes së tij.		
2.10	Risqet e mundshme të procesit të nismave qytetare në Këshillin Bashkiak: 1. Rregullorja e KB nuk parashikon dispozita për mënyrat dhe paraqitjen e iniciativave qytetare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tyre në KB.	Prioritet i lartë	Përcaktimi në rregulloren e KB-së i nismave të publikut për të qenë në fokusin e bashkisë.	Gjashtë mujori I 2020	Objektivi 1.1 Objektivi 2.1
2.11	Risqet në procesin e funksionimit të autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në bashki: 1. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla për funksionimin e njësisë për parandalimin e konfliktit të interesit në bashki (Autoritetit Përgjegjës për	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme të bashkisë i pavarësisë së autoritetit dhe funksionimit të tij. 2. Përcaktimi i mënyrës së proceseve dhe përdorimit të mekanizmave të autoritetit për parandalimin e konfliktit të interesave. 3. Raportimet e këtij autoriteti pranë titullarit dhe pranë organeve të pavarura (nëse është	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 1.2 Objektivi 1.3 Objektivi 3.1

	parandalimin e konfliktit të interesit). 2. Njohja e pamjaftueshme e legjislacionit dhe procedurave për konfliktin e interesit nga stafi i bashkisë dhe këshilli bashkiak. 3. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.		nevoja). 4. Miratimi i rregullave të brendshme të qarta për rastet e deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e punonjësve të bashkisë dhe anëtarëve të këshillit bashkiakë. 5. Informimi dhe njohja me këto rregulla i punonjësve të bashkisë dhe anëtarëve të KB përmes trajnimeve të vazhdueshme.		
2.12	Risqet në procesin e administrimit të regjistrit të konfliktit të interesit: 1. Regjistrit i konfliktit të interesit nuk përmban praktika të regjistruara, për shkak të mungesës së informacionit nga ana e administratës së bashkisë për ekzistencën e tij.	Prioritet i lartë	1. Sigurimi i njohjes së regjistrimit dhe mënyrës së funksionimit të regjistrit përkatës nga ana e punonjësve të bashkisë dhe anëtarëve të KB përmes trajnimeve për këtë qëllim. 2. Raportimi i rezultateve të regjistrit në mënyrë periodike.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.1

3.3 Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e Auditit të Brendshëm (AB)					
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh., pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[10]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës.	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përputhshmërinë e masave me objektivat e përcaktuara
3.1	Risqe të mundshme në ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në pikëpamjen e: 1. Plotësimi i organikës së miratuar për këtë strukturë, me rrjedhojë në performancën e njësisë.	Prioritet i lartë	1. Vlerësimi dhe plotësimi i vendeve vakante të njësisë së Auditimit të Brendshëm. 2. Vendosja e kritereve të përvojës minimale të punës dhe të certifikimeve përkatëse, për kandidatët që do të aplikojnë, si kushte të domosdoshme për t'u plotësuar.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 1.2
3.2	Risqet e proceseve të hartimit, miratimit dhe zbatimit të veprimtarive të kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara si: 1. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla që garantojnë pavarësinë e njësisë. 2. Planet e hartuara të kontrollit miratohen vetëm nga titullari;	Prioritet i lartë	1. Krijimi i një strukture të pavarur të Komitetit të Auditimit (me tre anëtarë të pavarur nga jashtë institucionit) në të cilën të raportojë Njësia e AB. (Pasi struktura e AB varet vetëm nga Kryetari). Kjo strukturë dhe mënyra e funksionimit të saj dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të parashikohet në kuadrin e brendshëm rregullator për të garantuar pavarësinë e	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 1.2 Objektivi 3.2

[10]Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

			njësisë.		
3.3	Risqet e mundshme në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të funksionit të AB: 1. "Karta e Auditimit" nuk është miratuar.	Prioritet i lartë	Vlerësimi i kartës së Auditimit me kriteret kryesore të standardeve ndërkombëtare (ref. IIA Global IA Charter). Miratimi i kësaj karte nga titullari.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2
3.4	Risqet e mundshme në proceset e njësisë së auditimit që lidhen me veprimtari kryesore të bashkisë: 1. Seti i procedurave që garantojnë gjurmën e auditimit nuk është miratuar.	Prioritet i lartë	Miratimi i setit të procedurave dhe mekanizmave që garantojnë gjurmën e auditimit, bazuar në praktikat e mira të Njësisë së Harmonizimit dhe atyre botërore.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2
3.5	Risqet e mundshme që cenojnë proceset e ngritjes dhe funksionimin e njësisë përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuar korrupsioni të tilla si: 1. Stafi i bashkisë nuk ka informacion të mjaftueshëm për ngritjen dhe funksionimin e njësisë përgjegjëse në bashki për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve dhe praktikave korruptive. 2. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla për procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni. 3. Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla dhe procedura për njoftimin,	Prioritet i lartë	1. Hartimi dhe përshtatja e rregullores së sinjalizuesit për bashkinë. 2. Përcaktimi në rregulloren e përgjithshme i proceseve nën administrim të strukturës përgjegjëse për hetimit administrativ, sinjalizimin dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit. 3. Miratimi në bazën e brendshme rregullatore i dispozitave në rregulloren e brendshme të bashkisë për procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni. 4. Miratimi në bazën e brendshme rregullatore i dispozitave për rregulla dhe procedura për njoftimin, shqyrtimin zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. 5. Miratimi i mekanizmave praktikë	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.3 Objektivi 3.1 Objektivi 3.2

	shqyrtimin zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. 4. Regjistri i sinjalizuesit nuk funksionin në bashki.		nëpërmjet të cilave duhet të ushtrohet ky funksion. 6. Përcaktimi i intervalit periodik të raportimit pranë komiteteve të nxjerra nga këshilli bashkiak. 7. Informimi i vazhdueshëm i stafit të bashkisë mbi këto rregulla.		
3.6	Risqe të mundshme në hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave të brendshme për mënyrat e ndarjes informacionit dhe komunikimit mes aktorëve të bashkisë dhe niveleve të ndryshme të administratës: 1. Raportet e të kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm nuk publikohen dhe nuk i vihen në dispozicion publikut.	Prioritet i lartë	1. Formalizimi në rregulloren e brendshme të elementit të transparencës dhe bërja publike e raporteve të Auditimit të Brendshëm (në funksion të shkallës së rritjes së transparencës me publikun).	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 2.1 Objektivi 3.2

3.4 Fusha e Shërbimeve Publike

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e shërbimeve publike					
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[11]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përputhshmërinë e masave me objektivat e përcaktuara
4.1	Risqe të mundshme në procesin e planifikimit dhe financimit të shërbimit: 1. Burimet njerëzore ekzistuese nuk kanë përvojë të mjaftueshme në analizën kosto-përfitim për këtë proces.	Prioritet i lartë	1. Vlerësimi i njohurive mbi shërbimet financiare dhe organizimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve në analizat financiare.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.3 Objektivi 3.2.
4.2	1. Standardet për cilësinë e shërbimit në proceset e hartimit dhe përzgjedhjes së instrumentit për administrimin e shërbimit publik nuk janë miratuar.	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi një listë kontrollesh që bazohet në praktikat më të mira për matjen e cilësisë së shërbimit. 2. Miratimi i standardeve për llojin dhe cilësinë e shërbimit proceset e hartimit dhe përzgjedhjes së instrumentit për administrimin e shërbimit publik si pjesë përbërëse e rregullores së përgjithshme në bashki.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2

[11] Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

4.3	Risqe të mundshme në procesin e hartimit dhe vendosjes së një sistemi administrimi të performancës së shërbimit: 1. Standardet dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të administrimit të performancës së shërbimit nuk janë miratuar.	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi i një liste kontrollesh që bazohet në praktikat më të mira për matjen e cilësisë së shërbimit. 2. Hartimi dhe miratimi i standardeve dhe procedurave për ngritje e një sistemi të administrimit të shërbimit mbështetur në listën e mësipërme dhe përvojat në këtë drejtim. 3. Ngritja (hartimi dhe miratim) e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, si pjesë përbërëse e rregullores së përgjithshme.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 3.2
4.4	Risqet e mundshme në proceset e ngritjes dhe funksionimit të strukturës përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit të tilla si: 1. Burime njerëzorë të pamjaftueshme dhe me aftësi teknike të kufizuara për të bërë monitorime, në kuadër të këtij sistemi.	Prioritet i lartë	1. Projektimi i proceseve vlerësuese të kapaciteteve për personel, vlerësimi i numrit të nevojshëm të personelit dhe trajnimi i strukturave aktuale.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 1.3 Objektivi 3.2
4.5	Risqe të mundshme në proceset për përgatitjen e termave të referencës për hartimin, miratimin, nënshkrimin dhe monitorimin e kontratave publike të tilla si: 1. Burimet njerëzore nuk kanë aftësi mjaftueshëm teknik për hartimin e temave të referencës dhe monitorimin e kontratave publike.	Prioritet i lartë	1. Zhvillimi i trajnimeve me qëllim aftësimin e burimeve njerëzore të përfshirë në këto procese. 2. Përcaktimi i një procesi bazuar në praktika të ngjashme të pushtetit lokal i cili bën të qartë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësish për përgatitjen e termave të referencës për hartimin, miratimin, nënshkrimin dhe monitorimin e kontratave publike. 3. Vendosja e një numri jeshil ku të regjistrohen të gjitha llojet e ankesave dhe ndjekja e tyre të raportohet organeve drejtuese dhe përfaqësuese të bashkisë.	Gjashtë mujori II 2021	Objektivi 3.2 Objektivi 3.1

3.5 Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin te pronave					
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[12]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përputhshmërinë e masave me objektivat e përcaktuara
5.1	Risqet në procesin e ngritjes dhe funksionimit të njësisë së administrimit të pronave bashkiake si më poshtë listuar: 1. Burimet njerëzore të pamjaftueshme në pozicionet teknike në drejtorinë përkatëse në bashki (p.sh., pozicioni i topografit në Drejtorinë e Pronave, Aseteve dhe Strehimit etj.); 2. Pronat e bashkisë nuk janë inventarizuar ne format elektronik të pronave të bashkisë (fletët e inventarit të pronave janë vetëm në letër sipas 12 NJA të bashkisë); 3. Buxhet i kufizuar për hipotekimin e pronave të bashkisë. 4. Harta dhe vlerësime të	Prioritet i lartë	1. Identifikimi i pozicioneve vakante me natyrë teknike dhe adresimi nga njësia e burimeve njerëzore për pozicionet brenda një afati të dakordësuar nga Titullari. 2. Caktimi i një grupi pune në përpilimin elektronik të inventarit të provave të bashkisë; 3. Përcaktimi i buxheteve në fillim viti për hipotekimin e pronave të Bashkisë bazuar në prioritetet e investimit që në panin vjetor të institucionit. 4. Inventarizimi i zonave që janë subjekt hipotekimi dhe vlerësimi i tyre sipas kategorive për të qenë në kohë me vlerësimet përpara hipotekimit të pronës.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2

[12] Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

	përshtatshme për pronat e bashkisë, bazuar në kategoritë që i përkasin (truall, tokë bujqësore etj.) me pasojë vonesën e procesit të hipotekimit për këto prona.				
5.2	Mungesa e sistemit të informacionit për administrimin dhe përdorimin e pronave bashkiake nëpërmjet të cilit të garantohet transparenca dhe informimi i palëve me të gjitha fazat e procesit.	Prioritet i lartë	1. Pajisja me një sistem informacioni për administrimin dhe përdorimin e pronave të bashkisë, i cili garanton transparencën dhe informon të gjitha palët mbi fazat e procesit. 2. Të ngrihet një sistem monitorimi mbi procesin e regjistrimit të pronave, i cili të përfshijë kontrollet periodike të regjistrit dhe të informacionit të hedhur për çdo pronë.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 2.1 Objektivi 3.2
5.3	Risqet e mundshme në hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin i strategjisë së administrimit të pronave bashkiake të tilla si: 1. Strategjia e administrimit të pronave nuk është miratuar, me pasojë menaxhim jo-efektiv i pronave publike në afatgjatë dhe afatmesëm.	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi i kritereve kryesore mbi të cilën do të zhvillohet strategjia e administrimit të pronave. 2. Hartimi dhe miratimi i një strategjie institucionale për administrimin e pronave të bashkisë duke konsideruar buxhetet dhe ndikimin social. 3. Prioritizimi dhe rishikimi periodik i investimeve të përcaktuara në strategji, duke konsideruar buxhetet edhe ndikimin social.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2
5.4	Risqet e mundshme në krijimin dhe administrimin e regjistrit të kontratave për pronat në pronësi ose administrim të bashkisë të tilla si: 1. Regjistri i kontratave për pronat në bashki nuk përmban informacionin për të gjitha kontrata ekzistuese. 2. Publikimi i informacionit mbi kontrata ekzistuese për pronat e	Prioritet i lartë	1. Ngritja e një regjistri në bashki të kontratave ekzistuese për pronat në pronësi apo administrim të bashkisë. 2. Përcaktimi i kritereve që do të duhet të përmbajë një sistem i thjeshtë i menaxhimit të pronave dhe garantimi i transparencës së të dhënave ndaj publikut.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 2.1 Objektivi 3.2

	bashkisë.				
5.5	Risqet e mundshme në proceset e këshillimit me bashkësinë dhe miratimin e tjetërsimit ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve si rrjedhojë e: 1. KQTBP (Komisioni i qiradhënies së tokave bujqësore të pandara) nuk është i ngritur.	Prioritet i moderuar	1. Përcaktimi i përputhshmërisë i pronës së transferuar me pronën në terren në mënyrë që të ngrihet KQTBP.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2

3.6 Fusha e Planifikimit të Territorit

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit te territorit					
	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[13]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përputhshmërinë e masave me objektivat e përcaktuara
6.1	Kuadri i brendshëm rregullator nuk parashikon rregulla të detajuara procesit të hartimit të miratimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së planifikimit, administrimit dhe zhvillimit te territorit, me qëllim sigurimin e transparencës dhe rritjen e aksesit publik.	Prioritet i lartë	1. Formalizmi në rregulloren e brendshëm të procesit të hartimit të miratimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së planifikimit, administrimit dhe zhvillimit te territorit, i detajuar, që do të trajtonte në mënyrë sa më shteruese një planifikim të gjithë nevojat e bashkisë në planin e përgjithshëm vendor. 2. Rregulla për procesin e dhënieve të lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe dhënien e certifikatës së përdorimit të jenë pjesë integrale e rregullores së përgjithshme të bashkisë.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2 Objektivi 2.1
6.2	Risqe të mundshme në proceset e publikimit dhe këshillimit me publikun të dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit: 1. Burime njerëzore të	Prioritet i lartë	1. Të bëhen analiza të nevojave të stafit staf duke përdorur kriterin e fluksit të kërkesave nga publiku gjatë 2 viteve të fundit.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 1.3 Objektivi 3.2

[13]Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

	pamjaftueshme dhe ato ekzistuese me mbingarkesë pune për trajtimin e kërkesave për leje ndërtimi.		2. Të përcaktohet numri i personelit të nevojshëm bazuar në volumin mesatar të këtyre kërkesave.		
6.3	Risqet në procesin e dhënieve të lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe dhënien e certifikatës së përdorimit: 1. Afatet ligjore të parashikuara për këto procese në disa raste shtyhen në zbatim.	Prioritet i lartë	1. Të konsiderohen kritere, të cilat ligjërisht mund të krijojnë fleksibilitet për shtyrjen e afateve kur ato janë të domosdoshme dhe të jenë pjesë integrale e rregullores së përgjithshme të bashkisë (të jenë të parashikuara në rregullore rastet e shtyrjeve të afateve dhe koha e shtyrjes) 2. Vendosja e një numri jeshil që mbledh ankesat e raportuara nga terreni.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2

DRAFT

3.7 Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik

Përgjegjës: Grupi i punës përgjegjës për aktivitetin e arkivit

	Është e nevojshme të theksohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme[14]	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson përputhshmërinë e masave me objektivat e përcaktuara
7.1	Risqe të mundshme në proceset e menaxhimit/administrimit të fondit arkivor bashkiak kryesisht në: 1. Koordinim i pamjaftueshëm për të siguruar ambiente e mundshme që nuk shfrytëzohen në bashki për fondin arkivor bashkiak (ambientet e pashfrytëzueshme).	Prioritet i lartë	1. Realizimi i inventarit të ambienteve të mundshme që mund të garantojnë vijueshmërinë bazuar në volumit e prurjeve dhe prodhimit të dokumentacionit. 2. Shqyrtimi i mundësive me institucionet pranë që sigurojnë kushtet dhe formalizimi i këtyre marrëdhënieve për kohën e parashikuar.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2
7.2	Risqet e mundshme në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike në ngritjen e shërbimit "One stop Shop".	Prioritet i lartë	1. Përcaktimi i ndarjes së detyrave dhe niveleve të autoritetit në rregullore dhe në manualet e përdorimit të sistemeve elektronike.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2
7.3	Risqet në procesin e funksionimit të njësisë për informacionin, komunikimin dhe sigurisë së informacionit e të dokumenteve	Prioritet i lartë	1. Zbatimi i sistemeve dixhitale/elektronike të ofrimit të shërbimit. 2. Përcaktimi i intervaleve kohorë për secilën	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 3.2

[14] Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

	elektronike si dhe proceseve të mirëmbajtjes së sistemeve të informacionit (asetet e informacionit, programet, asetet fizike, shërbimet): 1. Vonesa prej proceseve manuale; 2. Përgjigjet nuk kthehen në afat.		strukturë përgjegjëse. 3. Shqyrtimi i vonesave apo kthimit në kohë në vlerësimin e performancës periodike.		
7.4	Risqet në proceset e zbatimit të manualeve të punës për procedurat e përcaktuara në shërbimin "one stop shop" dhe procesit të trajtimit të e-maileve, të tilla si: 1. Përgjigjet nuk kthehen në afat; 2. Mbingarkesë e procesit, duke e duplikuar atë edhe me përgjigjen në formë shkresore.	Prioritet i lartë	1. Analiza e monitorimit të cilësisë me qëllim të identifikimin e hapësirave për të përmirësuar në rrjedhën e procesit të "One stop shop". 2. Të rishikohet praktika institucionale për shmangien e mbivendosjes/duplikimit të punës për një praktikë edhe në formë shkresore edhe në formë elektronike.	Gjashtë mujori II 2020	Objektivi 2.1 Objektivi 3.2
7.5	Risqet e mundshme në proceset e menaxhimit të riskut për sistemit e informacionit të cilat mund të jenë: 1. Kuadri i brendshëm rregullator i pamjaftueshëm në parashikimin e rregullave për sistemin e informacionit në bashki. 2. Instrumente për raportimin e incidenteve në lidhje me sistemet janë të pamjaftueshëm.	Prioritet i moderuar	1. Përcaktimi i instrumenteve periodike të raportimit të incidenteve në lidhje me sistemet apo ndërprerjet e shërbimeve. 2. Raportimi i tyre periodik pranë titullarit apo edhe këshillit bashkiak.	Gjashtë mujori I 2021	Objektivi 3.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10964/3 **Prot.** **Elbasan, më** 12.12.2019

VENDIM

Nr. 185 **datë** 04.12.2019

"Për miratimin e Kodit të Sjelljes Administrative të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 04.12.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë Kodin e Sjelljes Administrative të Bashkisë Elbasan, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Në mungesë dhe me porosi

ZV/KRYETARI

Ard Muça

Konceptoi:
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Drejtoria e Përgjithshme e SHO: *B. Çabiri*
Drejtoria e Përgjithshme e PAABF: *Q. Tusha*
Drejtoria e Përgjithshme e PAPTKTS: *K. Krasniqi*
Drejtoria e Përgjithshme e SHO: *E. Kënuti*
Drejtoria e Përgjithshme e SHI: *S. Mehmeti*
Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

BASHKIA ELBASAN

KODI I SJELLJES

Nëntor 2019

Miratuar me Vendimin Nr. __, datë __/__/___, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë _____

Preambula

Duke qenë të bindur se ndërtimi i standardeve etike të zyrtarëve të bashkisë është kusht për rritjen e besimit të qytetarëve ndaj vendimmarrësve vendorë;

Duke besuar se lufta ndaj korrupsionit dhe sjelljes jo-etike është domosdoshmëri për administratën e qeverisjes vendore;

Duke marrë parasysh faktin se organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore;

Duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit, institucionet vendore duhet të jenë sa më afër qytetarëve për të mundësuar shërbimet publike ndaj tyre;

Duke theksuar se përmirësimi i integritetit të qeverisjes vendore është thelbësor për cilësinë e mirëqeverisjes vendore, por edhe për proceset integruese të vendit, të cilat kërkojnë një administratë publike në përputhje me standardet evropiane;

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrat e organeve të vetëqeverisjes vendore që u ngarkojnë Kushtetuta dhe Ligji për Vetëqeverisjen Vendore;

KREU I

OBJEKTI DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza Ligjore

Kodi i Sjelljes është hartuar në zbatim të neneve 2/9, 54/a dhe 64/j të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij Kodi.

Neni 2
Objekti

1. Kodi i Sjelljes ka për qëllim të përcaktojë rregullat e sjelljes për zyrtarët e bashkisë,[1] sipas standardeve të vendosura, në ushtrimin e detyrës, në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të bashkisë.
2. Kodi synon zhvillimin e kulturës brenda institucionit për të forcuar dhe promovuar parimet bazë dhe standardet më të larta etike në bashki që priten të zbatohen nga zyrtarët e bashkisë.
3. Ky Kod informon të gjitha palët e interesuara për rregullat e sjelljes në bashki, orienton zyrtarët për të përmbushur këto rregulla si dhe ndihmon në identifikimin e rasteve, që janë të papajtueshme me këto rregulla.

Neni 3
Fusha e veprimit

Dispozitat e Kodit të Sjelljes zbatohen nga të gjithë zyrtarët e bashkisë dhe, për aq sa është e mundur, zbatohen edhe ndaj personave fizikë ose juridikë privatë, të cilëve u është dhënë e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 4
Përparësia e interesit publik ndaj interesit privat

Zyrtari i bashkisë duhet të ushtrojë detyrën e tij në përputhje me ligjin duke u udhëhequr nga interesi publik dhe jo interesa personale, partiake, apo private. Ai duhet të shmangë përdorimin e detyrës për qëllime të cilat nuk kanë bazë ligjore apo që nuk janë të motivuara nga interesi publik.

---

[1] Zyrtar i bashkisë është çdo zyrtar i zgjedhur si kryetar bashkie apo anëtar i këshillit bashkiak, çdo punonjës i administratës i emëruar apo i caktuar në administratë (që gëzon statusin e nëpunësit civil apo marrëdhëniet e të cilit rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë), që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në bashki, apo në njësitë ose institucionet buxhetore të saj.

Neni 5
Respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve

1. Zyrtari i zgjedhur[2] i bashkisë duhet të kryejë detyrat e tij në përputhje me mandatin e dhënë nga elektorati dhe t'i përgjigjet të gjithë nevojave të popullatës së bashkisë.
2. Në respekt të vullnetit të votuesve, zyrtari i zgjedhur gjatë mandatit të tij në detyrë duhet të shmangë ndryshimin e përkatësisë politike së cilës i përket.

Neni 6
Proporcionaliteti dhe objektiviteti

1. Zyrtari i bashkisë duhet të kryejë funksionin e tij publik me përkushtim, arsyetim, integritet, drejtësi, dhe pavarësi.
2. Zyrtari i bashkisë gjatë ushtrimit të detyrës së tij duhet të sigurojë që veprimet dhe masat e marra të jenë proporcionale për arritjen e qëllimit të ligjshëm administrativ. Ai duhet të shmangë çdo paragjykim, favorizim, apo ndikime të tjera, që mund të vënë në rrezik objektivitetin e tij.

Neni 7
Marrëdhënia me zyrtarët e tjerë të bashkisë dhe publikun

Zyrtari i bashkisë në kryerjen e detyrave duhet të respektojë të drejtat e të gjithë zyrtarëve të tjerë të bashkisë. Ai duhet të trajtojë me mirësjellje, respekt dhe pa diskriminim publikun dhe kolegët. Gjatë ushtrimit të detyrave të tij ai nuk duhet të inkurajojë apo ndihmojë asnjë zyrtar të bashkisë në shkeljen e parimeve të parashikuara nga ky Kod.

KREU II
STANDARDET E SJELLJES NË USHTRIMIN E DETYRËS

Pjesa e parë
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 8
Parimi i ligjshmërisë në punë

Çdo zyrtar i bashkisë është i detyruar të punojë dhe të veprojë në përputhje me ligjet përkatëse, aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullatore të bashkisë.

---

[2] Është zyrtari i zgjedhur për organin ekzekutiv (kryetari i bashkisë) dhe personat e zgjedhur për anëtarë të organit përfaqësues të bashkisë (këshillit bashkiak).

Neni 9
Integriteti

Zyrtari i bashkisë është i detyruar të veprojë më ndershmëri dhe në të mirën dhe interesin e anëtarëve të tjerë të bashkisë dhe publikut të gjerë.

Neni 10
Mosdiskriminimi

Zyrtari i bashkisë duhet të shmangë çdo sjellje dhe veprim diskriminues brenda dhe jashtë bashkisë.

Neni 11
Parimi i shmangies së konfliktit të interesave

Zyrtari i bashkisë nuk duhet të lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me postin e tij publike, të shmangë çdo lloj forme veprimi apo sjelljeje që mund të duket apo të perceptohet si konflikt interesi me detyrën që ushtron dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat.

Neni 12
Deklarimi i pasurisë dhe konfliktit të interesit

Zyrtari i bashkisë duhet të zbatojë parashikimet ligjore në fuqi në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit.

Neni 13
Parimi i luftës kundër nepotizmit

Zyrtari i bashkisë duhet, në çdo rast dhe me çdo kusht, të shmangë ose të kundërshtojë ndërhyrje, veprime, ose propozime që favorizojnë nepotizmin.

Pjesa e dytë

STANDARDET E SJELLJES PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR OSE KËSHILLTAR BASHKIAK GJATË FUSHATËS ELEKTORALE

Neni 14
Fushata zgjedhore

Fushata zgjedhore e kandidatit për kryetar bashkie apo këshilltar bashkiak duhet të organizohet dhe drejtohet me vërtetësi dhe ndershmëri. Kandidati nuk duhet të tentojë të sigurojë vota përmes shpifjes ndaj kandidatëve të tjerë, përmes dhunës, kërcënimit, ofrimit të parave, si dhe këmbimit të votës me premtime të paligjshme punësimi apo interesash të tjera.

Neni 15
Shpenzimet gjatë fushatës zgjedhore

1. Kandidati për kryetar bashkie apo kandidati për këshilltar bashkiak duhet të bëjë publike shpenzimet financiare gjatë fushatës elektorale në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin "Për Partitë Politike".
2. Kandidati për kryetar bashkie apo kandidati për këshilltar bashkiak në asnjë rrethanë nuk mund të përdorë fonde apo asete publike për qëllim të fushatës së tij zgjedhore.

Pjesa e tretë

STANDARDET E SJELLJES GJATË KRYERJES SË FUNKSIONIT

Neni 16
Detyrimet e zyrtarit të bashkisë

Zyrtari i bashkisë, gjatë kryerjes së detyrës, në zbatim të parimeve të përcaktuara në Kreun II të këtij Kodi, duhet:

1. Të promovojë interesat më të mira të bashkisë;
2. Të kontribuojë në përmbushjen e misionit dhe realizimit të vlerave të bashkisë;
3. Të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj bashkisë dhe integritetit të saj;
4. Të shfaqë integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjitha veprimet e tij;
5. Të sigurojë një mjedis të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe bashkëpunimit;
6. Të ruajë fshehtësinë e të gjitha çështjeve që konsiderohen konfidenciale;
7. Të sigurojë pavarësinë e gjykimit të lartë nga interesat kontradiktorë;
8. Të demonstrojë përkujdesje ndaj pronës dhe burimeve të bashkisë;
9. Të respektojë orarin e punës;
10. Të ruajë një paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, dhe të përdorë një fjalor të zgjedhur brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare;
11. Të zbatojë me korrektësi detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi;
12. Të shmangë rastet ku ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato pranë zyrës së Burimeve Njerëzore sapo të jenë shfaqur. Kur ekzistojnë konflikte të tilla, zyrtari është i detyruar të tërhiqet nga proceset vendimmarrëse ose aktivitete e ngjashme;
13. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin marrëdhëniet profesionale;
14. Të mos kërkojë dhe të mos pranojë asnjë formë privilegji, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese të pamerituara prej tyre apo favore e përfitime të tjera, të cilat zyrtari i bashkisë mund t'i ketë për shkak të detyrës;
15. Të mos bëjë dallime mes vartësve apo kolegëve për shkak të njohjeve apo preferencave personale;
16. Të mos bëjë dhe të mos bëhet pre i ngacmimeve të të gjitha formave nga persona të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me normat morale;
17. Me veprimet e tij të mos sjellë cenime të dinjitetit, personalitetit dhe të figurës profesionale, mendimeve profesionaleve të kolegëve dhe titullarëve të bashkisë;
18. Të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në mjediset e bashkisë;

Neni 17
Vendimmarrja

1. Zyrtari i bashkisë, në procesin e vendimmarrjes, duhet të marrë në konsideratë sa më shumë të jetë e mundur qëndrimin e komunitetit të bashkisë të shprehur në debatet publike.
2. Zyrtari i bashkisë në marrjen e një vendimi nuk duhet t'i shërbejë interesave të tij private, të personave të tjerë apo grupeve të ndryshme me qëllimin përfitimin personal të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Neni 18
Konflikti i Interesit

1. Kur një zyrtar i bashkisë gjatë procesit vendimmarrës është subjekt i një interesi privat dhe mund të ndikohet nga çështja në shqyrtim, ai bën deklaratë me shkrim dhe e dorëzon pranë njësisë përkatëse/Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.
2. Njësia përkatëse për konfliktin e interesit/ Drejtoria e Burimeve Njerëzore mban një regjistër të veçantë për rastet e deklarimit të konfliktit të interesit rast pas rasti.
3. Zyrtari i bashkisë nuk ka të drejtë të votojë për një vendim ose dokument tjetër politik kur ka konflikt interesi dhe as të promovojë vendime ose interesa për shpërblim/pagesë apo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta.
4. Deklarata me shkrim e zyrtarit të bashkisë për konfliktin e interesit në çdo rast publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë.
5. Rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për të zgjedhurit e bashkisë përcaktohen në legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 19
Deklarimi i mospasjes të konfliktit të interesit me detyrën e këshilltarit

1. Këshilltari bashkiak me marrjen e mandatit plotëson një deklaratë të mospasjes së konfliktit të interesit me detyrën e këshilltarit, sipas formularit bashkëlidhur Udhëzuesit të këtij Kodi.
2. Deklarata e plotësuar është dokument zyrtar dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë, me të dhënat konfidenciale personale të redaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 20
Deklarimi i Pasurisë

1. Kryetari i bashkisë deklaron pasurinë e tij dhe legjitimitetin e burimeve të saj, detyrimet financiare të tij apo familjarëve të tij dhe personave të lidhur me të sipas rregullave dhe formës së përcaktuar në legjislacionit përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare.
2. Deklarata e interesave private është dokument zyrtar dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë, me të dhënat konfidenciale personale të redaktuara, në përputhje me

legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare.

Neni 21
Ndalimi i korrupsionit

1. Në kryerjen e detyrave të tij, zyrtari i bashkisë duhet të shmanget nga çdo sjellje, që kualifikohet sipas legjislacionit penal në fuqi, si ryshfet aktiv ose pasiv.
2. Zyrtari i bashkisë merr pjesë aktive në ekspozimin dhe luftimin e korrupsionit në çfarëdo forme në komunitetin e bashkisë.
3. Zyrtari i bashkisë që sinjalizon veprimet ose praktikat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës, i garantohet mbrojtja sipas Ligjit "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve". Zyrtari i bashkisë mbështet masat për nxitjen sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit në bashki.

Neni 22
Ndalimi i marrjes së dhuratave, privilegjeve, favore

1. Zyrtari i bashkisë nuk mund të kërkojë, të marrë apo të lejojë një person të tretë të kërkojë apo të marrë dhurata mbi vlerën e parashikuar nga ligji, ose favore, premtime, trajtime preferenciale për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik apo juridik privat, përveç atyre simbolike me vlerë të papërfillshme.
2. Dhuratat që kanë vlera artistike, muzeale ose historike administrohen në bashki dhe ekspozohen.
3. Dhuratat dhe përfitimet e ngjashme, sipas këtij neni, deklarohen brenda 5 ditëve dhe regjistrohen në një regjistër të posaçëm, pranë zyrës së burimeve njerëzore.

Neni 23
Mbikëqyrja e disiplinës buxhetore dhe financiare

Zyrtari i bashkisë duhet të veprojë me kujdesin e duhur në menaxhimin dhe vënien në përdorim të fondeve publike. Ai duhet të respektojë disiplinën buxhetore dhe financiare, që kërkon administrimin e duhur të fondeve publike, siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 24
Ndalimi i ngacmimit seksual

1. Zyrtarit të bashkisë i ndalohet çdo sjellje me natyrë seksuale që prek dinjitetin e cilitdo dhe që konsiderohet e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe ofenduese për personin tjetër, si dhe që krijon një mjedis pune shqetësues, të paqëndrueshëm, armiqësor dhe frikësues. Për qëllim të këtij neni, sjellja e zyrtarit përfshin dhe nuk kufizohet në veprime fizike, fjalë, gjeste ose çdo lloj komunikimi virtual.
2. Zyrtari i bashkisë reagon menjëherë, raporton, kërkon evidentimin dhe hetimin e rastit, kur merr dijeni të ndonjë pretendimi për ngacmim seksual, duke mundësuar që viktima e ngacmimit seksual të mos frikësohet, të mos denigrohet dhe të mos injorohet pretendimi i tij/ i saj.

Neni 25
Përdorimi i burimeve dhe stafit

1. Zyrtari i bashkisë përdor kohën e punës, burimet, stafin dhe pronën e bashkisë vetëm për të kryer detyrën që i është ngarkuar.
2. Zyrtari i zgjedhur në bashki nuk duhet ta vendosë stafin e bashkisë, që paguhet nga fondet publike, në pozita që bien ndesh me paanësinë politike të stafit, ose ta përdorë atë për qëllime politike.

Neni 26
Marrëdhënia me median

Zyrtari i bashkisë i përgjigjet kërkesave të medias, me transparencë dhe vërtetësi, por duke respektuar kufizimet në lidhje me dhënien e informacionit sipas ligjit.

Pjesa e katërt
STANDARDET E SJELLJES PAS MBARIMIT TË DETYRËS

Neni 27
Kufizimet pas largimit nga detyra

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, zyrtari i bashkisë kryen detyrat e tij pa u ndikuar nga mundësia e përftimit në karrierën e tij të ardhshme në sektorin privat ose pa u ndikuar nga ish-kolegët.
2. Për një periudhë 2-vjeçare pas largimit nga detyra, ish zyrtari i bashkisë nuk duhet të përfaqësojë asnjë person apo organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me Bashkinë për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj.
3. Zyrtari i bashkisë, pas largimit nga detyra, nuk duhet të ofrojë informacione ose të dhëna konfidenciale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, të përfituara gjatë ushtrimit të funksionit.

Pjesa e pestë
STANDARDET E SJELLJES SË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË[3]

Neni 28
Të drejtat politike e sindikale

1. Punonjësi i administratës së bashkisë ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar të punës, por nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet politike.
2. Punonjësi i administratës së bashkisë ka të drejtë të bëhet anëtar i sindikatave dhe shoqatave profesionale, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tyre në

[3] Punonjës të administratës së bashkisë janë punonjësit e bashkisë, njësive dhe institucioneve buxhetore në varësi të saj, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil si dhe ata që marrëdhëniet e punës i kanë të rregulluar me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

shërbimin civil. Ai/ajo mund të zgjidhet në organet drejtuese të sindikatave dhe të marrë pjesë në veprimtarinë e tyre, jashtë orarit zyrtar të punës.

Neni 29
Veprimtari të dyta

1. Punësimi ose kryerja e veprimtarive private nga punonjësi i administratës së bashkisë, jashtë orarit zyrtar të punës, lejohet me miratim të titullarit të Bashkisë, sipas formularit bashkëlidhur Udhëzuesit të këtij Kodi.
2. Punonjësi i administratës së bashkisë lejohet të kryejë mësimdhënie edhe gjatë orarit zyrtar të punës në bashki, me miratimin me shkrim të drejtuesit të tij.

Pjesa e gjashtë
MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN

Neni 30
Transparenca

1. Zyrtari i bashkisë duhet të promovojë çdo masë që nxit transparencën në lidhje me kompetencat dhe detyrat e tij dhe funksionimin e shërbimeve dhe njësive nën përgjegjësinë e tij.
2. Zyrtari i bashkisë i përgjigjet çdo kërkese nga publiku në lidhje me kryerjen e detyrave të tij, arsyet për veprimet e tij, ose funksionimin e shërbimeve dhe departamenteve që i nënshtrohen përgjegjësisë së tij, duke respektuar kufizimet ligjore në lidhje me dhënien e informacionit.

Neni 31
Marrëdhënia me median

1. Zyrtari i bashkisë duhet t'i përgjigjet me transparencë dhe vërtetësi çdo kërkese nga media për informacion lidhur me kryerjen e detyrave të tij, por nuk duhet të ofrojë informacione ose të dhëna konfidenciale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Zyrtari i bashkisë duhet të promovojë çdo masë që nxit mbulimin mediatik të kryerjes së detyrave të tij dhe funksionimin e shërbimeve dhe njësive nën përgjegjësinë e tij.

Neni 32
Njohja me Kodin e Sjelljes

Zyrtari i bashkisë në fillim të marrëdhënieve të punës duhet të plotësojë një deklaratë, ku të shprehet se i njeh dhe do t'i zbatojë dispozitat e këtij Kodi, si pjesë e kushteve të tij/saj të punësimit.

KREU III
MONITORIMI DHE SANKSIONET PËR SHKELJET E NORMAVE ETIKE

Neni 33
Sjelljet e ndaluara

Sjelljet e ndaluara përbëjnë shkelje të Kodit të Sjelljes dhe përfshijnë:

a) Veprimet e çfarëdo lloji të çdo zyrtari të bashkisë që dëmtojnë misionin dhe imazhin e bashkisë;
b) Sjellje e dhunshme, ose kërcënimi, ushtrimi i dhunës fizike, sharjet, shpifjet apo veprimet keqdashëse të çfarëdo lloji ndaj çdo zyrtari të bashkisë nga vetë zyrtarët e tjerë të bashkisë apo nga persona të lidhur me ta;
c) Ofrimi ose dhënia e ryshfetit zyrtarëve të bashkisë;
d) Përvetësimi i paautorizuar i aseteve dhe shërbimeve brenda bashkisë;
e) Përdorimi i paautorizuar ose dhunimi i pajisjeve kompjuterike, pajisjeve të tjera dhe/ose mjediseve fizike të bashkisë;
f) Përdorimi i alkoolit, duhanit, dhe/ose substancave të ndaluara brenda ambienteve të bashkisë;
g) Çdo lloj veprimtarie apo sjellje që përbën vepër penale dhe/ose që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 34
Organi përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes
Komisioni i Etikës dhe ankimi për shkelje të etikës

1. Organi përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes është Komisioni i Etikës, i cili ngrihet nga Këshilli Bashkiak. Përbërja dhe funksioni tij bëhet sipas përcaktimeve në Shtojcën 1, bashkëlidhur Udhëzuesit të Detajuar të Kodit.
2. Komisioni i Etikës analizon e diskuton probleme të etikës së veprimtarisë së bashkisë. Komisioni i Etikës shqyrton sjellje të ndryshme të zyrtarit të bashkisë dhe vlerëson nëse ato përbëjnë shkelje të këtij Kodi.
3. Komisioni i Etikës ka për detyrë:
   a) të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij Kodi dhe të propozojë të bëjë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese, që kanë të bëjnë me etikën dhe sjelljen në bashki.
   b) në rast të shkeljeve të parashikuara nga ky Kod, ka të drejtë t'i propozojë organit kompetent dhënien e masës disiplinore të parashikuar në legjislacionin përkatës për zyrtarët e bashkisë.

Neni 35
Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja nga raportimet

1. Zyrtarët e bashkisë duhet të raportojnë çdo shkelje të këtij kodi pranë Komisionit të Etikës. Të drejtën për të raportuar shkeljet e mësipërme e kanë dhe anëtarët e Këshillit bashkiak dhe qytetarët.
2. Zyrtari i bashkisë nuk duhet të përdorë apo të kërcënojë se do të përdorë autoritet zyrtar apo influencë për të dekurajuar, kufizuar, apo ndërhyrë tek ndonjë person tjetër me qëllim ndalimin e këtij personi për të vepruar në mënyrë të drejtë për të raportuar në Komisionin e Etikës çfarëdo lloj informacioni i cili nëse do të ishte i vërtetë do të konsistonte në shkelje të dispozitave të këtij kodi.

3. Çdo person që beson se është bërë subjekt i ndonjë veprimi të ndaluar, mund të bëjë një ankesë konfidenciale në Komisionin e Etikës. Ky i fundit duhet që të kryejë verifikimin e kësaj ankese. Pas konkluzioneve të verifikimit komisioni duhet të ndërmarrë veprimet e përshtatshme siç parashikohet nga ligjet në fuqi.

Neni 36
Procedura për trajtimin e shkeljeve

1. Komisioni i Etikës mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese me shkrim.
2. Shkeljet e raportuara duhet trajtuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Kjo do të thotë që procedura e shqyrtimit duhet realizuar në mënyrë të tillë që të lejojë opsione zgjedhjeje në faza të ndryshme, bazuar në seriozitetin dhe rëndësinë e çështjes, apo fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.
3. Cilido zyrtar i bashkisë që vëren apo dyshon për shkelje të dispozitave të këtij Kodi inkurajohet ta raportojë shkeljen te cilido anëtar i komisionit, te kryetari i bashkisë apo te sekretarit të përgjithshëm, këshilli bashkiak, të cilët duhet t'ia përcjellin problemin Komisionit të Etikës.
4. Kur Komisioni merr njoftim për shkelje, kryetari i komisionit cakton një nga anëtarët, si raportues dhe relator, i cili ngarkohet me rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo të nxjerrë në dritë faktet dhe rrethanat përkatëse.
5. Kur shqyrtimi është i plotë, personi i ngarkuar harton një përmbledhje me shkrim të çështjes dhe ia paraqet për miratim atë Komisionit të Etikës.
6. Pas shqyrtimit, Komisioni i Etikës merr vendim për masën disiplinore përkatëse, të cilën ia përcjell për miratim organit kompetent.
7. Komisioni i Etikës merr vendimet me shumicë të thjeshtë.

Neni 37
Masat disiplinore

1. Përveç shkeljeve që ndëshkohen nga Ligji "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe atyre që përbëjnë vepra penale që trajtohen nga dispozitat e Kodit Penal, shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë Kod nga ana zyrtarëve së bashkisë përbën shkelje disiplinore administrative.
2. Komisioni i Etikës vepron bazuar në parimin e proporcionalitetit, duke konsideruar llojin e shkeljes, pasojat e ardhura dhe qëndrimin e zyrtarit ndaj shkeljes.
3. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve bashkiakë.

KREU IV
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 38
Publikimi dhe hyrja në fuqi e Kodit

1. Ky Kod hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.
2. Kodi dhe Udhëzuesi bashkëlidhur, botohen në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë.

Neni 39
Shtojcat e Kodit

Pjesë integrale e Kodit janë dhe Udhëzuesi, i nevojshëm për sqarime dhe orientim të zbatimit të normave etike dhe dilemave etike, të parashikuar në këtë Kod, si dhe model formularët përkatës:

SHTOJCA 1: Për modalitetet e krijimit dhe funksionimit të Komisionit të Etikës, sipas Kodit Standard të Etikës për Bashkitë
SHTOJCA 2: Për zgjidhjen e dilemave lidhur me zbatimin e Kodit Standard të Sjelljes
SHTOJCA 3: Modeli i regjistrit të dhuratave të pranuara nga zyrtarët e bashkive, që përfaqësojnë zyrtarisht bashkinë në aktivitete të ndryshme
SHTOJCA 4: Deklaratë për mospasjen konflikt interesi me funksionin, ose deklaratë për gjendjen e konfliktit rast pas rasti
SHTOJCA 5: Formular për dhënin e pëlqimit/lejes nga Kryetari i Bashkisë për dypunësimin e nëpunësve të bashkisë
SHTOJCA 6: Deklaratë para fillimit të marrëdhënieve të punës për njohjen me dispozitat e Kodit Standard të Sjelljes.

[SHTOJCA 1]

PËR MODALITETET E KRIJIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ETIKËS

(Në mbështetje të nenit 32-34të Kodit të Sjelljes dhe pikës 17 të Udhëzuesit të Detajuar të këtij Kodi)

1. Qëllimi

Komisioni i Etikës në çdo bashki krijohet si trupë këshilluese dhe gjykimore e çështjeve të etikës, sipas standardeve të përcaktuara nga Kodi i Sjelljes.

2. Autoriteti dhe kompetencat

1. Komisioni i Etikës vjen si nevojë e organizimit dhe e funksionimit të brendshëm të bashkive me standardet më të larta etike. Çdo bashki ngre Komisionin e Etikës me vendim të Këshillit Bashkiak në mbështetje të neneve 2/9, 54/a dhe neni 64/j të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
2. Komisioni i Etikës analizon e diskuton probleme të etikës së veprimtarisë së bashkisë. Komisioni i Etikës shqyrton sjellje të ndryshme të zyrtarit të bashkisë dhe vlerëson nëse ato përbëjnë shkelje të këtij kodi.
3. Komisioni i Etikës ka për detyrë:
   a) të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij kodi dhe të propozoje të bëjë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese që kanë të bëjnë me etikën në bashki.
   b) në rast të shkeljeve të parashikuara nga ky kod ka të drejtë t'i propozojë organit kompetent për dhënien e masës disiplinore të parashikuara në kod për zyrtarët e bashkisë.
4. Komisioni i Etikës trajton, verifikon, këshillon dhe u jep zgjidhje ankesave apo çështjeve, dilemave apo ankesave që kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave etike, të përcaktuara nga Kodi i Sjelljes.

3. Përbërja

Komisioni i Etikës përbëhet nga 3 ose 5 anëtarë, në varësi të madhësisë së bashkisë përkatëse. Anëtarë të komisionit të etikës janë punonjës të administratës së bashkisë dhe të këshillit bashkiak. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë punonjës me integritet dhe me njohuritë e mjaftueshme lidhur me zgjidhjen e problemeve dhe dilemave etike në marrëdhëniet e punës. Është e rëndësishme që të gjitha palët të kenë besim në neutralitetin e anëtarëve për shqyrtimin e çështjes. Në trajtimin e ankesave të veçanta merret në konsideratë konflikti i interesit të anëtarëve të komisionit, nëse është rasti, dhe zëvendësohet nga një anëtar tjetër.

4. Procedura për trajtimin e shkeljeve

1. Në rast shkeljesh të dispozitave të këtij kodi, Komisioni i Etikës vë në dispozicion anëtarë për të analizuar, ndërmjetësuar dhe, nëse është e domosdoshme, për të ngritur një grup dëgjimor.
2. Komisioni i Etikës mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese me shkrim.

3. Mënyra e trajtimit të shkeljeve të raportuara është përgjithësisht progresive. Kjo do të thotë që procedura është e hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë opsione zgjedhjeje në faza të ndryshme, bazuar në seriozitetin e problemit apo fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.
4. Çdo zyrtar i bashkisë që vëren apo dyshon për një shkelje të dispozitave të këtij kodi inkurajohet ta raportojë shkeljen te cilido anëtar i komisionit, apo të titullarit të institucionit apo sekretarit të përgjithshëm, të cilët ia përcjellin problemin Komisionit të Etikës.
5. Rastet e pretenduara për shkelje të etikës, sipas detyrimeve të Kodit të Sjelljes, paraqiten në Komisionin e Etikës brenda 5 ditëve nga konstatimi i tyre.
6. Kur Komisioni merr njoftim për shkelje, kryetari i komisionit mund të caktojë një nga anëtarët të ndërmarrë rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo të nxjerrë në dritë faktet.
7. Kur shqyrtimi është i plotë, personi i ngarkuar harton një përmbledhje me shkrim të çështjes dhe ia paraqet për miratim atë Komisionit të Etikës.
8. Pas shqyrtimit, Komisioni i Etikës merr vendimet për masën disiplinore përkatëse, të cilën ia përcjell për miratim organit kompetent. Në rastin e shkeljeve të kryera nga punonjësit e administratës, propozimin për masën disiplinore të miratuar nga Komisioni ia paraqet titullarit të institucionit. Në rastin e shkeljeve të kryera nga këshilltarët bashkiakë, propozimin për masën disiplinore të miratuar Komisioni i paraqitet këshillit bashkiak.
9. Komisioni i Etikës merr vendimet me shumicë të thjeshtë.
10. Komisioni i Etikës, pasi del në përfundimin se kemi të bëjmë me një thyerje të Kodit të Sjelljes, ia bën atë me dije Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.
11. Vendimet e propozuara nga Komisioni i Etikës janë subjekt i vlerësimit nga auditimi i brendshëm i bashkisë për zbatimin e tyre.

5. Masat disiplinore

1. Caktimi i masave disiplinore në parim do të ketë karakter progresiv dhe do të bëhet në bazë të llojit të shkeljes, intensitetit, përsëritshmërisë dhe pasojave të ardhura.
2. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.
   a. Masat disiplinore për zyrtarët e zgjedhur jepen sipas masave të parashikuar në rregulloren përkatëse të këshillit bashkiak.
   b. Masat përkatëse për punonjësit e administratës jepen sipas parashikimeve të Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil dhe të Kodit të Punës.

6. Kohëzgjatja dhe mbledhjet e komisionit

Komisioni i Etikës është organ këshillimor dhe mblidhet sa herë të jetë e nevojshme për trajtimin e çdo lloj problematike apo ankese etike.

[SHTOJCA 2]

PËR ZGJIDHJEN E DILEMAVE SIPAS KODIT TË SJELLJES

(Në mbështetje të nenit 9 të Kodit të Sjelljes dhe pikës 3 të Udhëzuesit të Detajuar të këtij Kodi)

Veprimtaria administrative është veprimtari e institucioneve, por dhe e nëpunësve publikë, që në fund të fundit janë njerëz dhe si të tillë mund të gabojnë. Tundimet, dilemat morale, dobësitë, kultura përreth nesh, struktura organizative e institucioneve, stilet drejtuese dhe menaxheriale të titullarëve dhe udhëheqjes së institucionit nuk e bëjnë të lehtë të vepruarit me etikë dhe integritet të nëpunësve publikë edhe në qoftë se e dëshirojnë këtë gjë. Ndër të tjera, etika kërkon strukturë dhe organizim. Ajo kërkon hapësirë për mendimet e nëpunësve civilë dhe diskutimin se çfarë dilemash ka dhe si t'i japë zgjidhje situatave të vështira.

Gjatë aplikimit të parimeve të përcaktuara në Kodin e Etikës, nëpunësit e bashkisë mund të hasin me probleme në përcaktimin e sjelljeve jo-etike, ose me zgjidhjen e konflikteve jo-etike. Nëpunësit vetë ose përmes ndihmës së kolegëve apo këshillës institucionale të Komisionit të Etikës duhet të përpiqen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

1. A është sjellja, veprimi apo vendimi im në përputhje me Ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin "Për rregullat e etikës në administratën publike" për etikën dhe me Kodin Etik Standard të Bashkive?
2. Çfarë efekti do të ketë vendimi ose sjellja ime për mua, bashkinë, apo për publikun?
3. A mund të çojnë në konflikte interesi veprime të caktuara që bëj unë edhe pse në pamje të parë nuk duken si të tilla?
4. A mund të justifikohet sjellja apo vendimi im me interesin publik dhe të vlerësohet pozitivisht nga opinioni publik?
5. A po përpiqem të shpërfill parregullsi apo paligjshmëri që sipas kulturës organizative të Bashkisë konsiderohen normale?
3. A duhet të shmang ngarkesën e punonjësve vartës me detyra, me justifikimin që kjo gjë u takon atyre, ndërkohë që e bëj që të mos ngarkoj veten?
4. A mund të shmang keqpërdorimin e autoritetit tim duke përfituar nga frika e punonjësve vartës?
5. A mund të shmang ndërhyrje apo ndikime nga jashtë ose brenda me qëllim që të marr një vendim të ndikuar miqësisht, politikisht ose financiarisht?
6. Nëse Kryetari i Bashkisë dëshiron të punësojë njerëz jashtë procedurës ligjore a mund ta kundërshtoj unë si Drejtor i Burimeve Njerëzore?
7. Ju si anëtar komisioni i prokurimeve publike, dhe njëkohësisht punonjës i një bashkie të vogël ku njerëzit njihen me njëri - tjetrin, a duhet të drekoni apo darkoni me subjekte private, shpesh pjesëmarrës dhe përfitues të tenderëve publikë?
8. Nëse gjatë një takimi elektoral, ju kërkohet të flisni publikisht për një forcë politike të caktuar dhe ndërkohë jeni me status nëpunësi civil, a duhet ta bëni një gjë të tillë?

Dilema kyçe për zyrtarët politikë të zgjedhur

Karrierë politike	Karrierë personale
Besnikëri ndaj partisë	Arsyetim i shëndoshë, vetëkritikë
Konfidencialitet partiak	Transparencë dhe ndershmëri
Vetëzhvillim personal	Në shërbim të publikut e shoqërisë
Varësi	Pavarësi
Pasurim i shpejtë	Modesti, të ardhura normale
Qasje penalizuese prej partiaku ndaj kritikëve	Autonomi mendimi dhe sjelljeje
Këndvështrim i ngushtë partie	Këndvështrim i gjerë sipas shoqërisë
Imazh i partisë dhe anëtarëve	Imazh i qytetarëve dhe shoqërisë
Mendje mbyllur dhe bunkerizim vetëm brenda partisë dhe jetës së saj organizative	Bashkëpunim me opozitën dhe hapje ndaj prurjeve të reja apo mendimeve ndryshe
Sens gjykimi partiak	Sens drejtësie, mbi baza ligjore, profesionale dhe morale

[SHTOJCA 3]

MODELI I REGJISTRIT TË DHURATAVE TË PRANUARA NGA ZYRTARËT E BASHKISË QË PËRFAQËSOJNË ZYRTARISHT BASHKINË NË AKTIVITETE TË NDRYSHME

(Në mbështetje të nenit 22/3 të Kodit të Sjelljes dhe pikës 7 dhe 8 të Udhëzuesit të Detajuar të këtij Kodi në lidhje me dhuratat dhe përfitimet e tjera të ngjashme)

Nr. Regj.	Punonjësi/ këshilltari bashkiak Emër mbiemër	Zyrtari për shkak të së cilësi është dhënë dhurata	Dhuruesi Emër mbiemër	Përshkrimi i dhuratës	Vlera e përafërt (> 10.000 lekë) (< 10.000 lekë)	Foto	Data e pranimit	Data e deklarimit	Struktura përgjegjëse Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve

[SHTOJCA 4]

DEKLARATË PËR MOSPASJEN KONFLIKT INTERESI ME FUNKSIONIN, OSE DEKLARATË PËR GJENDJEN E KONFLIKTIT RAST PAS RASTI

(Në mbështetje të nenit 18-19 të Kodit të Sjelljes dhe pikës 6 Udhëzuesit të Detajuar të këtij Kodi në lidhje me deklarimin rast pas rasti të gjendjes së konfliktit të interesit)

Emër: _____

Mbiemër: _____

Unë i/e nënshkruari/a, me vullnet të plotë në mbështetje të Kodit të Sjelljes në lidhje me deklarimet rast pas rasti të gjendjes së konfliktit të interesit, në cilësinë e _____ _____, deklaroj nën përgjegjësinë time, rastin e konfliktit të interesit të shfaqur.

Lloji i konfliktit të interesit	Rast pas rasti / I vazhdueshëm ☐ ☐
Çështja në shqyrtim nga Bashkia me të cilën zyrtari i bashkisë ndodhet në një situatë konflikti interesi	*(për plotësim)*
Thelbi i konfliktit të interesit	*(për plotësim)*

Të dhënat e deklaruara janë plotësisht nën përgjegjësinë personale.

Data e deklarimit: __/__/____ Nënshkrimi: _____
(emër mbiemër dhe firmë)

Shënim: Kjo deklaratë bëhet në dy kopje. Një kopje depozitohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të bashkisë dhe një e mban deklaruesi.

[SHTOJCA 5]

FORMULAR PËR DHËNIN E PËLQIMIT/LEJES NGA KRYETARI I BASHKISË PËR DYPUNËSIMIN E NËNPUNËSVE TË BASHKISË

(Në mbështetje të nenit 25 të Kodit të Sjelljes dhe pikës 11 të Udhëzuesit të Detajuar të këtij Kodi)

Unë i nënshkruari/ e nënshkruara_____, në pozicionin e _____

_____ jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Nenin ____ të Kodit të Sjelljes. Në përputhje me to, kërkoj leje për angazhim të dytë profesional, që ka lidhje me këtë natyrë aktiviteti dhe specifika:

_____

_____

_____

_____

_____

Të dhënat e deklaruara më sipër janë plotësisht nën përgjegjësinë personale.

Data e deklarimit: __/__/____ Kryetari i Bashkisë: _____

(emër mbiemër, firmë dhe vulë)

Shënim: Ky miratim i lejes nga Kryetari i Bashkisë bëhet në dy kopje. Një kopje depozitohet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të Bashkisë dhe një kopje e mban deklaruesi.

10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10965 Prot. Elbasan, më 12.12.2019.

VENDIM

Nr. 186, datë 04.12.2019

"Mbi Detyrën e Projektimin për objektin Bashkia E Re – Elbasan si dhe projekt-idenë arkitektonike të propozuar.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 7850 , datë 29.07.1994, Ligjit Nr.107/2014 " Për planifikim dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë:
   - Detyrën e Projektimit për objekt "Bashkia Qëndrore –Elbasan"
   - Projekt – Ide Arkitektonike për objektin "Bashkia Qëndrore –Elbasan"

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

Zv.KRYETARI
Ana Muça

Kordinator i Zhvillimit Urban G. Tabaku

Drejtoria Juridike O. Deliallisi

Avokati Qytetit A. Hoxha

Zv.Kryetari I. Sina

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.11083 Prot. **Elbasan, më 12.12.2019**

V E N D I M

Nr.184 Datë:04.12.2019

"Miratim për marrje me qira (rinovim kontrate) të një ambjenti për t'u përdorur për shkollë për Njësinë Administrative Gracen të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 04.12.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave), *"Miratim për marrje me qira (rinovim kontrate) të një ambjenti për t'u përdorur për shkolla për Njësinë Administrative Gracen të Bashkisë Elbasan"* bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, në ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*, Udhëzim i MAS nr. 348 datë 18.10.1994.

V E N D O S I :

1. Miraton marrjen me qira të ambjentit për t'u përdorur si klasë shkolle si në vijim:

Nr	Njësia Adminis.	Subjekti qiramarrës Shkolla	Qëllimi qiramarrjes	Vend ndodhja	Klasa Nr	Vlera kontratës Lekë/muaj	Subjekti qiradhënës
1	GRACEN	Shkolla Gjormë-Gracen	Shkollë	Gjormë	1(një)	2000	Behar Bunga

2. Afati i kontratës është 01.09.2019-30.06.2020.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori Pronave) dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

ZV/KRYETARE
Ana Muça

Sektori Pronave : *R. Thanasi*
Drejtoria A. P. S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Finances: *A. Merkja*
Drejtoria P.P.A.A.B.F.: *Q. Tusha*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11037/1 **Prot.** **Elbasan më,** 12.12.2019

VENDIM

Nr. 188 **datë:** 04.12.2019

"Për miratimin në parim të projekteve të investimit për përmirësimin e rrjetit ujësjellës, në Bashkinë Elbasan, si dhe të vlerës financiare, që do të kërkohet nga organet e Qeverisë Qendrore apo institucionet e tjera financuese"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 04.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sh.a. *"Për miratimin në parim të projekteve të investimit për përmirësimin e rrjetit ujësjellës, në Bashkinë Elbasan, si dhe të vlerës financiare, që do të kërkohet nga organet e Qeverisë Qendrore apo institucionet e tjera financuese"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në VKM nr.351 datë 04.6.2014 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit ujësjellës - kanalizime, në përdorim të shoqërisë "Elber" sh.p.k. Elbasan, të cilat kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasan", në VKM nr.63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizmit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", si dhe në Statutin e Shoqërisë "Ujësjellës - kanalizime Elbasan" sh.a.;

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim projektet e investimit për përmirësimin e rrjetit ujësjellës, në Bashkinë Elbasan, si dhe të vlerës financiare prej 299.241.350 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e dyqind e dyzetë e njëmijë e treqind e pesëdhjetë) lekë, që do të kërkohet nga organet e Qeverisë Qendrore apo institucionet e tjera financuese, sipas preventiva bashkëlidhur.

2. Të dërgojë dosjen e plotë me projektet e investimit, bashkëlidhur preventivat përkatës, pranë organeve të Qeverisjes Qendrore apo institucioneve të tjera financuese, për aplikimin e këtij financimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Ndërmarrja "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sh.a.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Në mungesë dhe me porosi

ZV/KRYETARI

Ana Muça

Konceptoi:

Ndërmarrja "UKE" sh.a.: *J. Doçi* *A. Memetaj* *L. Dervishi*

Pranoi:

Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Miratoi:

Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 11336 df-12-12-2019

V E N D I M

Nr 189 datë 04.12.2019

"Për Trasferimin e 1 (nje) mjeti zjarrfikes nga inventari i Agjencise se Sherbimeve Publike prane Bashkise Elbasan ne Drejtorine e SHMZSH –se Bashkise Peqin"

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dates 04.12.2019 , pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Agjencia e Sherbimeve Publike " Për Trasferimin e 1 (nje) mjeti zjarrfikes nga inventari i Agjencise se Sherbimeve Publike prane Bashkise Elbasan ne Drejtorine e SHMZSH –se Bashkise Peqin", bazuar ne Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, date 26.06.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise " ,i ndryshuar ,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

VENDOSI:

1. Trasferimin e nje mjeti zjarrfikes nga inventari i Agjencise se Sherbimeve Publike prane Bashkise Elbasan ne Drejtorine e SHMZSH Bashkise Peqin .

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera	Vlera e amortizimit
1	Automjet zjarrfikes MAN Targa WM 450 H (7 T I modifikuar)	Cope	1	850,000	850,000	430,835

Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes se tij .

KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

SEKRETAR
Klajdi GRIPSHI

Zv. KRYETAR
Ana Muça

KonceptoiDr. Degës Ekon.L.Tutulaku

DR. i ASHP N.Sinani

1841
30.12.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11500/1 **Prot.** **Elbasan, më** 30 **.12.2019**

VENDIM

Nr. 197 **datë** 24 **.12.2019**

"Për miratimin e nivelit të masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor, për sportistët profesionistë të Klubit Shumësportesh, si dhe shpërblimi i trajnerëve joefektivë dhe i gjyqtarëve, që financon Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.12.2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e nivelit të masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor, për sportistët profesionistë të Klubit Shumësportesh, si dhe shpërblimi i trajnerëve joefektivë dhe i gjyqtarëve, që financon Bashkia Elbasan"*, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) Ligjin nr.79/2017 "Për sportin";
c) Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
d) VKM nr.354 datë 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë së veprimtarisë sportive për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime të tjera për veprimtaritë sportive" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor, për sportistët profesionistë të Klubit Shumësportësh, që financon Bashkia Elbasan, si më poshtë:
   - *Sportisti profesionist (sportisti bazë, që merr pjesë në veprimtaritë kombëtare të kategorisë së parë dhe superiore)* - ***1.000 lekë / ditë për 25 ditë / muaj.***

2. Të miratojë pagesën deri në ***200 lekë / orë stërvitore*** për trajnerët joefektivë, sipas kategorisë së tyre, si më poshtë:

- *Për trajnerët e zv/trajnerët e ekipeve të para,* ***deri në 60 orë / muaj;***
- *Për trajnerët e ekipeve zinxhir (të rinjtë, para të rinjtë),* ***deri në 40 orë / muaj;***

3. Të miratojë pagesën për gjyqtarët, për çdo herë që marrin pjesë në aktivitetet sportive, si më poshtë:
   - *Për gjyqtarët dhe vëzhguesit e futbollit dhe të basketbollit jo më pak se* ***2.000 lekë;***
   - *Për gjyqtarët dhe vëzhguesit e sporteve të tjera jo më pak se* ***1.500 lekë;***

4. VKB nr.07 datë 24.01.2011 "Për nivelet e masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor, që financon Bashkia e Elbasanit, për sportistët e kategorisë së parë të Klubit Shumësportesh", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Klubi Shumësportesh në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETARI
Ana Muça

Konceptoi:
Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*
Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*
Miratoi:
Zv/Kryetari: *I. Sina*
Zv/Kryetari: *A. Kovaçi*

1842
30-12-2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1301 **Prot.** **Elbasan, më** 30 **.12.2019**

VENDIM
Nr. 188 **datë** 24 **.12.2019**

"Për miratimin e dhënies së bursave nxënësve të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2019 - 2020"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Qendra Ekonomike e Arsimit, pranë Bashkisë Elbasan, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) VKM nr.666 datë 10/10/2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2019 - 2020";
c) Urdhërin e brendshëm nr.1243, datë 19/12/2019;

V E N D O S I:

1. Të miratojë *"Dhënien e bursave nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2019 - 2020"*, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETARI
Ana Muça

Konceptoi:

Q. E. A.: *Miranda Haxhiymeri*
Drejtori D.P.A. *Denada Cela*
Drejtore e DPPAPTKTS: *K. Krasniqi*
Drejtoria Juridike: *O. Deltallisi*

APLIKIMET E SHKOLLAVE TE MESME PROFESIONALE

KLASA X SHKOLLA PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI", CERRIK

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Mehmet	Agim	Ruçi	Elbasan	Mihal Shahini	X	Veterinari	e plotë
2	Kostandin	Spiro	Ndini	Elbasan	Mihal Shahini	X	Veterinari	e plotë
3	Luis	Albert	Hasa	Elbasan	Mihal Shahini	X	Veterinari	e plotë
4	Luis	Albert	Hasa	Paper	Mihal Shahini	X	Bujqesi	e plotë

KLASA XI SHKOLLA PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI", CERRIK

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Andri	Artur	Salla	Shushice	Mihal Shahini	XI	Veterinari	e plotë

KLASA XI SHKOLLA PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI", CERRIK

	Fitues nga VKB per bursa 2018-2019							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Alban	Luan	Debrova	Elbasan	Mihal Shahini	XI	Veterinari	e plotë

KLASA X SHKOLLA PROFESIONALE " HYSEN ÇELA", DURRES

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Mani	Perparim	Qosja	Shirgjan	Hysen Çela, Durres	X	Tek- ushqimore	e plotë

KLASA XI SHKOLLA PROFESIONALE " HOTELERI-TURIZEM",TIRANE

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Orgito	Luan	Gjeli	Gracen	Hoteleri-Turizem/Tir	XI	T.Ushqimore	e plotë

KLASA XI SHKOLLA PROFESIONALE " GJERGJ CANCO ",TIRANE

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Gyri	Asllan	Qoku	L.Mai	Gjergj Canco/Tirane	XII	Elektroteknik	e plotë

KLASA X SHKOLLA PROFESIONALE " ONUFRI",ELBASAN

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Klejdi	Gezim	Toçi	Shushice	Onufri	X	Pikture	e plotë

KLASA XI SHKOLLA PROFESIONALE " ONUFRI",ELBASAN

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Fatjon	Besim	Debrova	Tregan	Onufri	XI	Arte Figurative	e plotë

KLASA XII SHKOLLA PROFESIONALE " ONUFRI",ELBASAN

	Fitues nga VKB per bursa 2018-2019							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Pelivan	Alfred	Hysa	Rajce	Onufri	XII	Muzike	e plotë
2	Endri	Xhevair	Hysa	Rajce	Onufri	XII	Muzike	e plotë

KLASA X SHKOLLA PROFESIONALE "ALI MYFTIU"

	Aplikimet për herë të parë për bursa 2019-2020							
	Aplikanti				**Arsimi**			
Nr	Emer	Atësi	Mbiemer	Bashkia/ Njësia Administrative	Shkolla	Klasa	Dega	Bursa
1	Dhimiter	Ferdinand	Shqau	Elbasan	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
2	Ardius	Nexhmi	Xhelo	Elbasan	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
3	Orgito	Gezim	Muça	Shirgjan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
4	Eduard	Fadil	Sllami	L.Mal	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
5	Leo	Ferdinand	Yzeiri	Shirgjan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
6	Rigers	Aleksander	Sallaku	Elbasan	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë

7	Denis	Dhimitri	Çela	Paper	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
8	Albion	Azbi	Cani	Elbasan	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
9	Ismail	Petrit	Meta	Godolesh/L.Fushe	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
10	Floedjo	Florenc	Tashi	Tregan	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
11	Arbi	Albert	Curri	Bradashesh	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
12	Sokol	Rrapush	Hanoli	Funarë	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
13	Ersi	Luan	Pema	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
14	Ledjon	Fadil	Tashi	Tregan	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
15	Adrian	Agim	Himçi	Paper	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
16	Marsi	Bashkim	Shabani	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
17	Orgito	Shpetim	Sina	Funarë	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
18	Dannjel	Ergis	Gjevori	Paper	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
19	Leonard	Ardian	Kaçi	Shirgjan	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
20	Leonis	Besnik	Alija	Gjergjan	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
21	Redon	Sefedin	Hasa	Elbasan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
22	Orges	Islam	Korra	Elbasan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
23	Ergist	Bashkim	Dybeli	Paper	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
24	Amarildo	Gazmir	Idrizi	Gjergjan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
25	Riza	Mikel	Goga	Elbasan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
26	Bloan	Ardian	Budani	Elbasan	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
27	Kastriot	Kujtim	Vodha	Funarë	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
28	Antonio	Arjan	Balla	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
29	Isjan	Durim	Halili	Elbasan	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
30	Kristi	Nderim	Kumrija	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
31	Kristi	Flamur	Alushi	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
32	Mikel	Orget	Ruçi	Shirgjan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
33	Inertdo	Qemal	Sinani	Funarë	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
34	Gazmir	Agim	Hyka	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
35	Leandro	Mejtim	Blloshmi	Elbasan	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
36	Serxhio	Bujar	Bahja	Paper	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
37	Eriglon	Flamur	Cakani	Shushice	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë

38	Artan	Qemal	Duka	L.Fushe	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
39	Oltjan	Nazmi	Balla	Elbasan	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
40	Orges	Agron	Halili	Bradashesh	Ali Myftiu	X	Mekanike	e plotë
41	Ibrahim	Toni	Haka	L.Fushe	Ali Myftiu	X	SHMT	e plotë
42	Valsmir	Sokol	Dedja	Elbasan	Ali Myftiu	X	Ndertim	e plotë
43	Florenc	Agron	Panxhi	Gjinar	Ali Myftiu	X	Elektroteknik	e plotë
